

LIGJ Nr. 102/2015

PËR SEKTORIN E GAZIT NATYROR¹

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me gaz natyror të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu konkurrues dhe të integruar me tregjet rajonale e europiane, për një shërbim me cilësi të lartë, kosto të arsyeshme, si dhe duke respektuar kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Neni 2

Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton rregullat për organizimin e funksionimin e tregut të gazit natyror, aksesin në treg, kriteret dhe procedurat që zbatohen për dhënien e miratimit për transmetimin, shpërndarjen, furnizimin dhe depozitimin e gazit natyror, si dhe funksionimin e sistemeve.

¹Ky ligj është përafshuar plotësisht me direktivën 2009/73/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009, "Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror, e cila shfuqizon direktivën 2003/55/KE", Numri CELEX 32009L0073, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L nr. 211, datë 14.8.2009, fq. 94–136".

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për veprimtarinë në fushën e transmetimit, shpërndarjes, tregtimit, depozitimit, furnizimit, si dhe për ndërtimin e operimin e infrastrukturës së gazit natyror, papërfshirë veprimtarinë e kërkimit dhe prodhimit të gazit natyror.
2. Rregullat e përcaktuara në këtë ligj për gazin natyror, përfshirë GNL-në, do të zbatohen në mënyrë jodiskriminuese edhe për biogazin dhe gazin nga biomasa ose llojet e tjera të gazit, nëmasën në të cilën këto lloje gazrash është teknikisht e mundur dhe e sigurt të injektohen dhe të transportohen me anë të sistemit të gazit natyror.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akses i palës së tretë” është e drejta e të gjithë përdoruesve të sistemit për përdorimin e sistemit të transmetimit, shpërndarjes dhe depozitimit të gazit natyror, bazuar në kushte të përcaktuara e të publikuara, në përputhje me parimet e transparencës e të mosdiskriminimit, kundrejt tarifave të miratuara nga ERE.
 2. “Akses në hapësirat e depozitimit” është e drejta e një prodhuesi, furnizuesi, transportuesi, klienti të përdorë hapësirat e depozitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë.
 3. “Akses në sistemin e transmetimit/shpërndarjes” është e drejta e një prodhuesi, furnizuesi ose klienti të lidhet në sistemin e transmetimit/shpërndarjes.
 4. “Certifikim” është procedura, e cila përcakton përputhshmërinë me kushtet që sigurojnë pavarësinë dhe ndarjen e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, si një parakusht për licencimin, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.
 5. “Depozitim” është injektimi i gazit natyror në hapësirat depozituese, depozitimi dhe marrja e tij nga këto hapësira.
 6. “Derivativ i gazit natyror” është një instrument financiar që mund të përdoret nga pjesëmarrësit e tregut të gazit natyror si mjet sigurie ndaj luhatjeve të mundshme të çmimit të gazit në treg.
 7. “Detyrim i shërbimit publik” është detyrimi që vendoset ndaj një të licencuari për kryerjen e një shërbimi publik, që lidhet me sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, çmimet e rregulluara në sektorin e gazit natyror, efikasitetin e energjisë, mbrojtjen e mjedisit, përmbushja e të cilit nuk cenon konkurrencën, përveç kur është e domosdoshme për të siguruar shërbimin publik në fjalë.
 8. “Enti Rregullator i Energjisë” ose “ERE” është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për sektorin e energjisë elektrike.
 9. “ENTSO-G” është Rrjeti Europian i Sistemit të Operatorëve të Transmetimit të Gazit.
 10. “Forcë madhore” është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.
 11. “Furnizim” është shitja dhe rishitja e gazit natyror, përfshirë GNL-në, te klientët.
 12. “Furnizues i mundësisës së fundit” është një furnizues i caktuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili ofron për një periudhë të kufizuar kohe shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara ndaj klientëve, të cilët nuk kanë mundur të kontraktojnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre.
 13. “Gaz natyror” është gazi metan, përfshirë gazin shoqëruar, si dhe të gjitha hidrokarburet që janë në gjendje të gaztë, në kushte atmosferike normale, i cili, përfshin edhe GNL-në, biogazin ose lloje të tjera gazi, që transmetohen dhe shpërndahen në sistemin e tubacioneve.
- “13/1. “Gaz Natyror i Lëngëzuar” (GNL) është gazi metan CH₄, i cili kthehet në lëng në presionin 1 atm dhe temperaturë minus 161 gradë celsius.**
- 13/2. “Gaz Natyror i Komprimuar” (GNK) është gazi metan CH₄, i cili komprimohet në presionin 200 atm.”.**
14. “Hapësirë” është sasia ose volumi i gazit që i lejohet përdoruesit të depozitojë në impiantin e depozitës.
 15. “Hapësirë depozitimi” është hapësira e përdorur për depozitimin e gazit natyror, që zotërohet dhe/ose operohet nga një shoqëri e gazit natyror, përfshirë pjesën e impianteve të GNL-së, të përdorura për depozitim, duke përjashtuar ato impiante GNL-je që përdoren për veprimtarinë e prodhimit dhe hapësirat e rezervuara ekskluzivisht për Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) në kryerjen e funksioneve të tij.
 16. “Hidrokarbur” është nafta bruto dhe/ose gazi natyror.
 17. “Impiant GNL-je” është terminali që përdoret për lëngëzimin e gazit natyror ose importin, eksportin, shkarkimin

apo rigazifikimin e GNL-së, përfshirë shërbimet ndihmëse dhe depozitat e përkohshme, të nevojshme për procesin e rigazifikimit dhe lëvrimin e mëtejshëm në sistemin e transmetimit, pa përfshirë pjesët e terminaleve të GNL-së, që përdoren për depozitim.

“17/1. “Impiant me përmasa të vogla” është njësi lëvizëse që përdoret për prodhimin/depozitimin, transportimin dhe/ose shpërndarjen e sasive të vogla të GNL-së dhe/ose GNK-së.”.

18. “Infrastrukturë e re” është infrastruktura që nuk ka përfunduar deri më 1 gusht 2008.

19. “Inspektorat përgjegjës” është inspektorati shtetëror përgjegjës për inspektimin në sektorin e gazit natyror, në varësi të ministrit përgjegjës për hidrokarburet.

20. “Injektueshmëri” është raporti në sasinë e gazit që lejohet të injektohet në depozitë nga ana e përdoruesit të impiantit të depozitës.

21. “Instalim matës” është çdo matës dhe pajisje e instalim i lidhur me të, përfshirë tubin lidhës, filtrin, valvulën, pajisjen që rregullon presionin, vulën, kutinë, montimin, pajisjet telemetrike, kompjuterin e gazkromatografit dhe të fluksit.

22. “Ishull gazi” është një sistem i gazit natyror, i izoluar, i cili nuk ka lidhje interkoneksioni mesistemet fqinje.

23. “Kapacitete depozituese” është çdo kombinim i hapësirës, injektimit dhe furnizimit.

24. “Kapacitet i disponueshëm” është kapaciteti, i cili mund t’u sigurohet përdoruesve të sistemit ose rrjetit nga operatori i sistemit.

25. “Kapacitet i garantuar” është kapaciteti i rrjetit të transmetimit ose i sasisë së GNL-së të depozituar në impiant, e kontraktuar për të garantuar furnizim të pandërprerë, respektivisht nga OST-ja ose nga operatori i depozitës së GNL-së.

26. “Kapacitet i impiantit të gazit natyror të lëngëzuar (GNL)” është kapaciteti i terminalit të GNL-së, në të cilin bëhen lëngëzimi i gazit natyror, importimi, shkarkimi, shërbime ndihmëse, depozitimi i përkohshëm dhe rigazifikimi i GNL-së.

27. “Kapacitet” është sasia maksimale e rrjedhës së gazit, e shprehur në metër kub për njësi normale ose në njësi energjie për çdo njësi kohe, që i është dhënë çdo përdoruesi të rrjetit, sipas kontratës së transportit të lidhur me OST-në apo kontratat e tjera të lidhura me Operatorin e Sistemit të Depozitimit apo GNL-së.

28. “Kapacitet i kontraktuar” është kapaciteti i depozitës ose kapaciteti që OST-ja apo operatorii sistemit të GNL-së ka përcaktuar për çdo përdorues të rrjetit, nëpërmjet kontratës së transportit të lidhur me OST-në apo çdolloj kontrate tjetër të lidhur respektivisht me Operatorin e Sistemit të Depozitimit apo të GNL-së.

29. “Kapacitet i kufizuar” është situata, në të cilën një linjëinterkoneksioni nuk mund të sigurojëtransmetimin e të gjithë rrjedhës fizike të gazit natyror, që rezulton nga kërkesa e pjesëmarrësve të tregut, për shkak të mungesës apo reduktimit të kapaciteteve të linjave tëinterkoneksionit dhe/ose të sistemit kombëtar të transmetimit.

30. “Kapacitete të ndërprishme” është kapaciteti, i cili mund të ndërpritet nga OST-ja apo Operatori i Sistemit të Depozitimitose i sistemit të GNL-së, sipas kushteve për të cilat është rënë dakord në kontratën e transportit të lidhur me OST-në apo respektivisht me Operatorin e Sistemit të Depozitimit ose të GNL-së.

31. “Klient” është një subjekt që blen me shumicë ose klienti fundor i gazit natyror, si dhe çdo subjekt tjetër i gazit natyror që blen gaz natyror.

32. “Klient me shumicë” është personi fizik ose juridik, i ndryshëm nga OST-ja ose OSSH-ja, i cili blen gaz natyror, me qëllim rishitjen brenda ose jashtë sistemit ku është i lidhur.

33. “Klient fundor” është klienti që e blen gazin natyror për përdorim vetjak.

34. “Klient në nevojë” është një klient familjar, i cili, për shkak të gjendjes sociale, gëzon disa të drejta të veçanta, lidhur me furnizimin me gaz, të siguruara në raste përjashtimore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

35. “Klient familjar” është klienti, që blen gaz për konsum familjar dhe jo për veprimtari tregtare ose profesionale.

36. “Klient jofamiljar” janë personat fizikë ose juridikë që blejnë gaz natyror, i cili nuk shkon për përdorim familjar, prodhuesit dhe klientët e shumicës.

37. “Klient i vogël jofamiljar” është shoqëria, e cila ka të punësuar 6 deri në 20 punonjës, ka xhiro ekonomike vjetore, e cila nuk kalon shumë në 150 milionë lekë dhe që blen gaz për përdorim vetjak dhe jo për qëllim rishitjeje.

38. “Klient i mbrojtur” janë klientët familjarë e klientët e vegjël jofamiljarë të lidhur me rrjetin eshpërndarjes së gazit, shërbimet kryesore sociale të lidhura me rrjetin e shpërndarjes e të transmetimit, si dhe ngrohja me gaz në bllok e godinave, për aq kohë sa furnizojnë klientët e sipërpërmendur, që mjafton të provojë se këto impiante nuk mund të operojnë me lëndë të tjera djegëse dhe se janë të lidhura me një rrjet gazi transmetimi apo shpërndarjeje.

“38/1. “Klient i mbrojtur në kuadrin e solidaritetit” është klienti familjar i cili është i lidhur me një rrjet shpërndarjeje të gazit dhe gjithashtu përfshin një ose të dyja rastet e mëposhtme:

a) instalimi i ngrohjes qendrore nëse është një “klient i mbrojtur” në vend dhe vetëm në atë masë që u shërben klientëve familjarë ose shërbimeve themelore sociale, përveç arsimit dhe shërbimeve të administratës publike;

b) një shërbim thelbësor shoqëror nëse është një “klient i mbrojtur” në vend, përveç arsimit dhe shërbimeve të administratës publike.”.

39. “Kodi i matjes” është tërësia e normave minimale të detyrueshme për matjen dhe regjistrimin e gazit natyror. “Kodet e rrjetit” janë Kodi i Transmetimit dhe Kodi i Shpërndarjes
40. “Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes” është tërësia e rregullave teknike, nëpërmjet të cilave rregullohet funksionimi i rrjetit të shpërndarjes, si dhe vendosen kushtet e shërbimit që ofrohet nga operatorët e sistemit të shpërndarjes për përdoruesit e këtij sistemi.
41. “Kodi i Rrjetit të Transmetimit” është tërësia e rregullave teknike, nëpërmjet të cilave rregullohet operimi i sistemit të transmetimit, si dhe përcaktohen kushtet e shërbimit që ofrohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për përdoruesit e sistemit të transmetimit, në përputhje me rregullat e ENTSO-G-së.
42. “Kontratë furnizimi afatgjatë” është kontrata e furnizimit me gaz natyror me kohëzgjatje më të madhe se 10 vjet.
43. “Kontratë furnizimi me gaz” është një kontratë për furnizim me gaz natyror, por që nuk përfshin derivativët e gazit natyror.
44. “Kontratë “merr ose paguaj”” është kontratë blerjeje ose shitjeje gazi, sipas së cilës blerësi e paguan sasinë e kontraktuar të gazit, pavarësisht nëse kjo sasi është konsumuar ose jo nga ana e tij.
45. “Kontratë transporti” është kontrata e lidhur ndërmjet OST-së me përdoruesin e rrjetit, me objekt transmetimin e gazit natyror.
46. “Kontroll” janë të drejtat, kontratat ose çdo mënyrë tjetër, që, veç e veç apo në mënyrë të kombinuar, duke u bazuar në një rrethanë apo në një ligj, i japin një subjekti mundësinë e ushtrimit të një ndikimi përcaktues mbi një shoqëri të caktuar në veçanti nëpërmjet:
- a) pronësisë ose së drejtës për të përdorur të gjitha ose pjesë të aseteve të kësaj shoqërie;
 - b) të drejtave apo kontratave, të cilat japin një ndikim vendimtar në përbërjen, votimin apo vendimmarrjen e organeve të kësaj shoqërie.
47. “Korridor tregtimi” është një nyje ku gërshetohen shumë hyrje dhe dalje, në të cilat mund të vijë dhe të dalë gazi nga drejtime të ndryshme me qëllim tregtimi.
48. “Lëngëzim i gazit natyror” është procesi i ftohjes së gazit natyror në kushte normale, deri në temperaturën -163° C, derisa ai të shndërrohet në gaz natyror të lëngëzuar (GNL).
49. “Licencë” është një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e gazit natyror, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.
50. “Linepack” është një sasi gazi natyror, e ruajtur në gjendje të ngjeshur në sistemet e transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror, pa përfshirë instalimet e rezervuara për OST-të, në ushtrim të veprimtarisë së tyre.
51. “Linjë direkte” është një tubacion i gazit natyror, mbështetës i sistemit të ndërlidhur, që lidh një burim të gazit me një klient.
52. “Linjë interkoneksioni” është një linjë transmetimi, e cila lidh sistemet e transmetimit të gazit ndërmjet dy shteteve.
53. “Matës inteligjent” është një pajisje elektronike që regjistron në kohë reale të dhënat e konsumit të gazit natyror dhe komunikon këtë informacion, të paktën çdo ditë, tek operatori i sistemit, për qëllime të monitorimit e të faturimit.
54. “Metodologji e tarifave” është akti që përcakton kushtet dhe mënyrën e llogaritjes së tarifave të veprimtarive të rregulluara të gazit natyror.
55. “Ministër” është ministri përgjegjës për sektorin e energjisë.
56. “Ministria” është ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë.
57. “Modeli i tregut të gazit natyror” është një dokument i përgatitur dhe i miratuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili përcakton marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm të tregut të gazit natyror.
58. “Operim” është vënia në veprim dhe shfrytëzim, në kuptimin tregtar, të infrastrukturës së sistemit të gazit natyror, në përputhje me kushtet e përcaktuara në licencën përkatëse, të lëshuar nga ERE.
59. “Operim i tregut” është veprimtaria që kryen operatori i tregut, lidhur me menaxhimin e tregut të gazit natyror dhe përgatitjen e raporteve financiare për pjesëmarrësit e tregut, pa përfshirë blerjen apo shitjen e gazit natyror, në përputhje me parashikimet e rregullave të tregut.
60. “Operator” është personi që përdor apo kontrollon funksionet teknike të instalimeve të gazit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
61. “Operator i rrjetit” është Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe/ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.
62. “Operator i Sistemit të Depozitimit” është subjekti, i cili kryen veprimtarinë e depozitimit dhe është përgjegjës për operimin e hapësirave të depozitimit.
63. “Operator i sistemit të GNL-së” është subjekti, i cili kryen veprimtarinë e lëngëzimit të gazit natyror ose importin, eksportin, shkarkimin e rigazifikimin e GNL-së dhe është përgjegjës për operimin e impiantit të GNL-së.
64. “Operator i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)” është personi juridik, i cili kryen funksionin e shpërndarjes dhe është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar dhe, ku është e zbatueshme, ndërlidhjen me sisteme të tjera, si edhe për garantimin e mundësive afatgjata

të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e gazit;

65. “Operator i Sistemit të Transmetimit (OST)” është personi juridik, që kryen veprimtarinë e transmetimit dhe është përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e sistemit të transmetimit në një zonë të caktuar dhe, ku është e zbatueshme, ndërlihdjen e tij me sistemet e tjera, si dhe për garantimin e mundësive afatgjata të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për transportin e gazit.

66. “Operatori i tregut” është struktura përgjegjëse e licencuar për operimin, organizimin dhe menaxhimin e tregut të gazit natyror.

67. “Pagesa e licencës” është pagesa e përcaktuar nga ERE për dhënien e licencave për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e gazit natyror.

68. “Pagesa rregullatore” është pagesa vjetore që shoqëritë e licencuara në sektorin e gazit natyror paguajnë në ERE për të mbuluar kostot e veprimtarisë rregullatore të tij, në bazë të një metodologjie të miratuar nga ERE.

69. “Palë e Komunitetit të Energjisë” është çdo palë kontraktore e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

70. “Person” është çdo person fizik ose juridik.

71. “Periudha e balancimit” është koha, brenda së cilës marrja e një sasive gazi natyror, e shprehur kjo në njësi energjie, duhet të balancohet nga çdo përdorues i rrjetit nëpërmjet injektimit të së njëjtës sasi gazi në rrjetin e transmetimit në depozitë apo impiantet e GNL-së, sipas kushteve të kontratës së transportit të lidhur me Operatorin e Sistemit të Transmetimit, kontratave të lidhura për depozitimin apo operatorin e sistemit të GNL-së, kodin e rrjetit dhe/ose rregullat e tjera në fuqi.

72. “Përdorim” është vënia në funksionim dhe mirëmbajtja në aspektin teknologjik të infrastrukturës së sistemit të gazit natyror (tubacione gazsjellësish, impiante GNL-je apo hapësira depozitimi të gazit natyror).

73. “Përdorues i sistemit” është personi që furnizon ose furnizohet nga sistemi, si edhe vetë një operator i sistemit, i cili, sipas nevojave, i kryen vetë funksionet respektive.

74. “Përgjegjësi e balancimit në tregun e gazit natyror” është detyrimi i pjesëmarrësve të tregut për të balancuar sasinë e gazit natyror që hyn në sistem dhe që del nga sistemi në periudhën që llogaritet dhe që përgjigjet financiarisht për çdo shmangie.

75. “Përpunim i gazit natyror” është procesi industrial kompleks, i realizuar për pastrimin e gazit natyror, në gjendje natyrale, nëpërmjet ndarjes së papastërtive, si edhe veçimit të komponentëve gazorë dhe të lëngët me përmbajtje jometanore, për të prodhuar gazin natyror të thatë, të transportueshëm në sistemin gazsjellës.

76. “Pikë virtuale e tregtimit” është vendi i tregtimit të gazit pas hyrjes së tij në sistemin e transmetimit, por përpara daljes së tij nga sistemi i transmetimit, duke përfshirë në të sistemin e depozitimit të gazit.

77. “Pjesëmarrës” janë subjektet që operojnë në sektorin e gazit natyror.

78. “Planifikim afatgjatë” është planifikimi i furnizimit dhe i kapacitetit transmetues e shpërndarës të shoqërive të gazit natyror mbi baza afatgjata për përmbushjen e kërkesës për gaz natyror të sistemit, diversifikimin e burimeve dhe garantimin e furnizimeve të klientëve.

79. “Prodhuar” është personi, i cili ushtron veprimtarinë për prodhimin e gazit natyror.

80. “Rigazifikim” është procesi i ngrohjes së GNL-së deri në kthimin e tij në gjendje të gaztë.

81. “Rregulla të praktikës dhe të procedurave” janë rregullat e miratuara nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s, ku përcaktohen procedurat dhe afatet që zbaton ERE.

82. “Rregulla teknike dhe të sigurisë” janë rregullat teknike dhe kriteret e sigurisë, ku përcaktohen kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit, të linjave direkte, si dhe të çdo impianti, pajisjeje ose instalimi tjetër që përfshihet në sektorin e gazit natyror.

83. “Rregulla të tregut” janë rregullat që përcaktojnë mënyrën e operimit dhe menaxhimit të tregut, regjistrimin e pjesëmarrësve, përgjegjësinë e balancimit prej pjesëmarrësve të tregut të gazit natyror, rregullat për balancimin e sistemit të gazit natyror, rregullat për llogaritjen e disbalancës për palët përgjegjëse të balancimit, rregullat për përgjegjësitë financiare të palëve përgjegjëse të balancimit në rast të disbalancimit, si dhe çështje të tjera lidhur me funksionimin e tregut.

84. “Rrjedha virtuale” është rrjedhje e gazit të blerë, në të cilën gazi nuk lëviz realisht në drejtimin nga vendi i blerjes për te klienti, por sasia e gazit të blerë është zëvendësuar nga gazi që rrjedh në drejtimin nga vendi i klientit për te vendi i blerjes.

85. “Rrjet” është një sistem i ndërlidhur tubacionesh.

86. “Rrjet tubacioni në sektorin e kërkim-prodhimit” është çdo tubacion ose rrjet tubacionesh, që operojnë dhe/ose janë ndërtuar si pjesë e një projekti për nxjerrje naftë apo gazi ose që përdoret për të transportuar gaz natyror nga një apo më shumë projekte të tilla të një impiant përpunimi, terminali ose terminali fundor detar.

87. “Sekretariati i Komunitetit të Energjisë” është institucioni i Komunitetit të Energjisë që funksionon në bazë të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

88. “Siguri” është siguria e furnizimit me gaz natyror dhe siguria teknike.
89. “Sistem” është çdo rrjet transmetimi, shpërndarjeje, impianti GNL-je ose hapësire depozitimi, zotëruar ose operuar nga një shoqëri e gazit natyror, përfshirë *linepack*-un, instalimet e tij, që sigurojnë shërbimet ndihmëse, si dhe ato që janë të nevojshme për hyrjen në transmetim, shpërndarjen dhe impiantet e GNL-së.
90. “Sisteme të ndërlidhura” janë një numër sistemesh të lidhura me njëra-tjetrën.
91. “Shërbime ndihmëse” janë të gjitha shërbimet e nevojshme për aksesin dhe operimin e rrjeteve të transmetimit dhe/ose shpërndarjes, instalimet e GNL-së dhe/ose hapësirat e depozitimit, përfshirë balancimin dhe kombinimin e ngarkesës, përjashtuar instalimet e rezervuara ekskluzivisht për operatorët e sistemeve të transmetimit.
92. “Shërbim publik” është shërbimi që sigurohet nga një i licencuar që operon në sektorin e gazit natyror, që lidhet me sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, çmimet e rregulluara në sektorin e gazit natyror, efikasitetin e gazit natyror, energjinë nga burimet e rinovueshme, mbrojtjen e mjedisit, përmbushja e të cilit nuk cenon konkurrencën, përveç kur është e domosdoshme për të siguruar shërbimin publik në fjalë.
93. “Shërbime të qëndrueshme” janë shërbimet e ofruara nga OST-ja, operatori i depozitimit ose ai i sistemit të GNL-së në lidhje me “kapacitetet e garantuara”.
94. “Shoqëri furnizimi” është personi që kryen veprimtarinë e furnizimit me gaz natyror.
95. “Shoqëri e gazit natyror” është personi që kryen të paktën njërin prej veprimtarive, si: prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin, blerjen ose depozitimin e gazit natyror, përfshirë GNL-në, dhe që është përgjegjës për detyrat tregtare e teknike dhe/ose mirëmbajtjen, që lidhen me këto funksione, pa përfshirë klientët fundorë.
96. “Shoqëri e integruar e gazit natyror” është një shoqëri, vertikalisht ose horizontalisht e integruar.
97. “Shoqëri e integruar horizontalisht” është një shoqëri e gazit natyror, që kryen të paktën njërin prej veprimtarive, si të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, depozitimit ose furnizimit të gazit natyror dhe të një veprimtarie tjetër, jashtë sektorit të gazit natyror.
98. “Shoqëri të lidhura” janë shoqëritë e lidhura dhe/ose të bashkuara, sipas parashikimeve të legjislationit për mbrojtjen e konkurrencës.
99. “Shoqëri e integruar vertikalisht” është një shoqëri ose grup shoqëri të licencuara në sektorin e gazit natyror, ku i njëjti person ose persona ushtrojnë kontroll mbi këto shoqëri në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe ku shoqëria ose grupi i shoqërive kryejnë të paktën njërin prej veprimtarive të transmetimit, shpërndarjes, operimit të impiantit të GNL-së ose depozitimit dhe të paktën njërin prej veprimtarive të prodhimit apo furnizimit të gazit natyror.
100. “Shpërndarje” është transporti i gazit natyror nëpërmjet rrjeteve të tubacioneve, për lëvrimin e tij te klientët, pa përfshirë furnizimin.
101. “Tarifë” është çmimi i shërbimit të ofruar nga subjektet që kryejnë veprimtari të rregulluaranë transmetimin dhe shpërndarjen e gazit natyror, si edhe për aksesin në hapësirat e depozitimit dhe impiantet e GNL-së, i vendosur në bazë të metodologjisë së llogaritjes së tarifave.
102. “Të dhëna të matjes” janë të dhënat e mbledhura dhe të transferuara nga një instalim matës, duke përfshirë leximin e matësit (kontaktorit), numrin e identifikimit të instalimit matës, periudhën përkatëse balancuese, konsumin e energjisë, vëllimin dhe cilësinë e gazit natyror të konsumuar.
103. “Transmetim” është transporti i gazit natyror, nëpërmjet një rrjeti tubacionesh të presionit të lartë, i ndryshëm nga rrjeti i tubacionit në sektorin e kërkim-prodhimit, si edhe i ndryshëm nganjë pjesë e tubacioneve të presionit të lartë, të përdorura paraprakisht për shpërndarjen e gazit, ku synohet lëvrimi e tij te klientët, pa përfshirë furnizimin.
104. “Tregtar i gazit” është një shoqëri që kryen veprimtari të tregtisë së gazit, si një veprimtari tregu, e pajisur me licencë për ta ushtruar këtë veprimtari.
105. “Tregtia e gazit” është shitblerja e gazit natyror, duke përjashtuar shitjen e tij te klienti fundor.
106. “Tregtim” është blerja ose shitja me shumicë e gazit natyror.
107. “Treg i çastit” është tregu financiar, në të cilin tregtohen instrumente financiare dhe produkte primare për dorëzim të menjëhershëm.
108. “Tregu primar” është tregu i shitblerjes së kapaciteteve drejtpërdrejt nga OST-ja ose Operatori i Sistemit të Depozitimit të GNL-së.
109. “Treg sekondar” është tregu ku tregtohen kapacitetet, përveç kapaciteteve të tregtueshmenë tregun primar.
110. “Vende të treta” është çdo vend, i cili nuk është palë e Komunitetit të Energjisë ose anëtare e Hapësirës Ekonomike Europiane.
111. “Veprim balancues” është një veprim i ndërmarrë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për të ndryshuar rrjedhat hyrëse ose dalëse të gazit në rrjetin e transmetimit, me përjashtim të atyre veprimeve që lidhen me sasinë e pallogaritit të gazit, e cila është marrë nga sistemi, si dhe gazin e përdorur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për funksionimin e sistemit.
112. “Veprimtari” është veprimtaria prodhuese ose përdorimi i instalimeve dhe impianteve të tyre, si edhe shërbimet e lidhura me to.

113. “Veprimtari studimore-projektuese” është veprimtaria që lidhet me studimin, projektimin, mbikëqyrjen, monitorimin, kolaudimin, konsulencën dhe drejtimin teknik në kërkim-zbulim, prodhim, përpunim, transportim, depozitim, tregtim dhe përdorim të hidrokarbureve.

114. “Programi i përputhshmërisë” është program i hartuar nga operatorët e sistemit dhe i miratuar nga ERE, në të cilin përcaktohen masat e nevojshme që do të ndërmarrë operatori për garantimin e sjelljes jodiskriminuese, si dhe metodat që do të zbatohen për monitorimin e zbatimit të tij.

115. “Zyrtari i përputhshmërisë” është një person fizik ose juridik, i pavarur, i përcaktuar nga operatori i sistemit, me miratimin paraprak të ERE-s, i ngarkuar me monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e programit të përputhshmërisë.

KREU II

POLITIKAT E SEKTORIT TË GAZIT NATYROR

Neni 5

Politikat e sektorit të gazit natyror

1. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për politikat e përgjithshme të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Republikën e Shqipërisë, si dhe për përcaktimin e stimujve që aplikohen ndaj operatorëve të sektorit të gazit natyror, në përputhje me politikat e zhvillimit ekonomik dhe sektorë të tjerë të vendit.

2. Ministria përgjegjëse për energjinë:

a) është institucioni përgjegjës për hartimin e politikave të zhvillimit të sektorit të gazit natyror;

b) harton dhe përditëson Strategjinë Kombëtare të Energjisë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave;

c) grumbullon dhe përpunon të dhënat dhe informacionet mbi bilancin e energjisë në nivel kombëtar, përfshirë edhe sektorin e gazit.

3. Në kryerjen e përgjegjësiave, sipas këtij ligji, ministria këshillohet me autoritetet e tjera shtetërore të sektorit të energjisë, ERE-n, pjesëmarrësit në sektorin e gazit natyror, si dhe me grupet e interesit.

4. Ministria zhvillon politika dhe programe për:

a) zbatimin e objektivave dhe të politikave energjetike në sektorin e gazit natyror;

b) nxitjen e investimeve në sektorin e gazit natyror, përfshirë edhe lehtësitë e mundshme fiskale;

c) marrjen e masave të mbrojtjes së mjedisit në sektorin e gazit natyror;

ç) garantimin e zhvillimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve e të instalimeve të tjera të infrastrukturës së gazit natyror;

d) harmonizimin me standardet dhe rregulloret e Bashkimit Europian në këtë sektor dhe sigurimin e ndërveprimit të sistemeve të gazit natyror të Republikës së Shqipërisë me sistemet rajonale dhe ato europiane;

dh) zhvillimin e programeve për mbrojtjen e klientëve në nevojë, në bashkëpunim me autoritetet dhe institucionet e tjera shtetërore;

e) sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm e të sigurt të sektorit të gazit natyror.

5. Ministri, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, jep certifikatat profesionale për specialistët që kryejnë veprimtari studimore-projektuese dhe zbatuese në fushat e përcaktuara me këtë ligj, si dhe në fushat e kërkimit, të prodhimit, të përpunimit, të transportimit, të depozitimit e të tregimit të hidrokarbureve në tërësi. [Për të ushtruar veprimtarinë studimore-projektuese, personat fizikë ose juridikë, duhet të pajisen me licencë në kategorinë IV.4.B, sipas ligjit nr. 10/081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.](#) “Për të ushtruar veprimtarinë studimore-projektuese, personat fizikë ose juridikë duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie, kryerjen e kësaj veprimtarie dhe duhet të kenë të punësuar specialistë të pajisur me certifikatë profesionale.”.

Neni 6

Siguria e furnizimit me gaz natyror

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton planin e emergjencës, në të cilin përcaktohen standardet minimale të sigurisë së furnizimit me gaz natyror, si dhe rregullat për të garantuar furnizim të sigurt dhe të efektshëm. **Plani i emergjencës, ndër të tjera, përmban:**

a) instrumentet dhe masat që garantojnë në mënyrë të saktë e të qartë furnizimin e klientëve të mbrojtur, në rastet:

i) e një ndërprerjeje të pjesëshme të furnizimit;

- ii) e kushteve atmosferike ekstremisht të ftohta në periudhën e ngarkesës maksimale;
 - iii) kur ka kërkesë shumë të lartë për gaz gjatë periudhës më të ftohtë të dimrit;
 - b) programin për reduktimin ose ndërprerjen e furnizimit me gaz natyror të kategorive të veçanta të klientëve në rast krize;
 - e) rolin dhe përgjegjësitë e shoqërive të gazit natyror e të klientëve jofamiljarë, duke mbajtur parasysh shkallën, në të cilën ata mund të jenë dëmtuar nga një krizë e mundshme në sektorin e gazit natyror;
 - e) kërkesat për impiantet e depozitimit, me qëllim realizimin e standardeve të sigurisë së furnizimit, si dhe kontributin e mundshëm të depozitës, kur kjo e fundit është në Shqipëri apo në ndonjë vend anëtar të Komunitetit të Energjisë;
 - d) masa dhe veprime të tjera, të cilat ndërmerren në mënyrë që të heqin ose të pakësojnë pasojat e ndërprerjes së furnizimit me gaz natyror, në varësi të shkallës së krizës.
2. Pjesëmarrësit në tregun e gazit natyror planifikojnë dhe marrin masat për një furnizim të sigurt me gaz natyror, në përputhje me standardet, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të këtij neni, si dhe janë përgjegjës për furnizimin me gaz natyror, brenda qëllimit të veprimtarisë.
3. ERE është autoriteti përgjegjës për monitorimin e sigurisë së furnizimit.
4. Plani i emergjencës nuk duhet të jetë diskriminues apo të parashikojë detyrime të paarsyeshme ndaj pjesëmarrësve ekzistues apo të rinj të tregut.
5. Plani i emergjencës i vihet në dispozicion Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
6. Kur vendi ka një nivel të përshtatshëm të interkonexionit, ministria ose shoqëria përgjegjëse e gazit natyror mund të marrë masat e duhura në mënyrë që të arrihen standardet e sigurisë së furnizimit, duke përdorur impiantet e depozitimit të vendosura në territorin e palës tjetërkontraktuese. Për këtë qëllim, mund të bashkëpunohet me autoritetet dhe/ose shoqëritë e gazit natyror të një vendi të BE-së ose të një pale tjetër të Komunitetit të Energjisë, përfshirë këtu lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe. Aplikimi i këtyre masave nuk duhet të pengojë funksionimin normal të tregut vendas.

Neni 6

Siguria e furnizimit me gaz natyror

1. Ministria përgjegjëse për energjinë, pasi konsultohet me shoqëritë e gazit natyror, organizatat përkatëse që përfaqësojnë interesat e klientëve të gazit, familjarë dhe industrialë, përfshirë prodhuesit e energjisë elektrike, operatorët e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, në rastet e deklarimit të një gjendjeje krize në furnizimin me gaz natyror sipas përcaktimeve të nenit 6/1 të ligjit, harton:
- a) një plan veprimi parandalues, që përmban masat e nevojshme për të eliminuar ose zbutur rreziqet e identifikuara, duke përfshirë efektet nga zbatimi i efijencës së energjisë dhe masat e nxitjes së kërkesës në vlerësimet e rrezikut të zakonshëm dhe kombëtar dhe në përputhje me përcaktimet e pikave 3 dhe 4 të këtij neni;
 - b) një plan emergjence që përmban masat që duhen marrë për të eliminuar ose zbutur ndikimin e një ndërprerjeje të furnizimit me gaz në përputhje me përcaktimet e pikave 3 dhe 5 të këtij neni.
2. Masat për të garantuar sigurinë e furnizimit me gaz që përmban një plan veprimi parandalues dhe një plan emergjence duhet të përcaktohen qartë, në mënyrë transparente, proporcionale, jodiskriminuese, të verifikueshme, të mos shtrembërojnë padrejtësisht konkurrencën ose funksionimin efektiv të tregut të brendshëm të gazit dhe të mos rrezikojnë sigurinë e furnizimit me gaz të vendeve që janë palë e Komunitetit të Energjisë ose të shteteve të tjera anëtare të Bashkimit Europian.
3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton:
- a) planin e emergjencës të hartuar sipas pikës 1 të këtij neni, në të cilin përcaktohen standardet minimale të sigurisë së furnizimit me gaz natyror, si dhe rregullat për të garantuar furnizim të sigurt dhe të efektshëm;
 - b) planin e veprimit parandalues, të hartuar sipas pikës 1 të këtij neni, në të cilin përcaktohen masat e nevojshme për të eliminuar ose zbutur rreziqet e identifikuara në sigurinë e furnizimit me gaz natyror, por edhe standardet minimale të sigurisë së furnizimit me gaz natyror, si dhe rregullat për të garantuar furnizim të sigurt dhe të efektshëm.
4. Plani i veprimit parandalues përmban:
- a) një përshkrim të efekteve të masave të përfshira në plan për funksionimin e tregut të brendshëm të energjisë, përfshirë detyrimet e përmendura në shkronjën “c” të kësaj pike;
 - b) detyrimet e ndërmarrjeve të gazit natyror dhe organeve të tjera përkatëse, që mund të ndikojnë në sigurinë e furnizimit me gaz;
 - c) informacion mbi të gjitha detyrimet e shërbimit publik në lidhje me sigurinë e furnizimit me gaz;
 - ç) masat, vëllimet dhe kapacitetet e nevojshme për të përmbushur standardin e infrastrukturës dhe standardin e furnizimit me gaz;
 - d) masa të tjera parandaluese të programuara për të adresuar rreziqet e identifikuara në vlerësimin e rrezikut, siç janë ato që lidhen me nevojën:
 - i. për të forcuar ndërlidhjet midis vendeve palë të Komunitetit të Energjisë;

ii. për të përmirësuar më tej efikasitetin e energjisë dhe për të zvogëluar kërkesën për gaz;
iii. për të diversifikuar rrugët e gazit, burimet e furnizimit me gaz dhe përdorimin rajonal të kapaciteteve ekzistuese të depozitimit dhe të GNL-së, si dhe për të ruajtur sa më shumë furnizim me gaz sa të jetë e mundur për të gjithë klientët.

5. Plani i emergjencës përmban:

a) instrumentet dhe masat që garantojnë në mënyrë të saktë e të qartë furnizimin e klientëve të mbrojtur në rastet:

i. e një ndërprerjeje të pjesshme të furnizimit;

ii. e kushteve atmosferike ekstremisht të ftohta në periudhën e ngarkesës maksimale;

iii. kur ka kërkesë shumë të lartë për gaz gjatë periudhës më të ftohtë të dimrit.

b) programin për reduktimin ose ndërprerjen e furnizimit me gaz natyror të kategorive të veçanta të klientëve në rast krize;

c) rolin dhe përgjegjësitë e shoqërive të gazit natyror e të klientëve jofamiljarë, duke mbajtur parasysh shkallën në të cilën ata mund të jenë dëmtuar nga një krizë e mundshme në sektorin e gazit natyror;

ç) kërkesat për impiantet e depozitimit, me qëllim realizimin e standardeve të sigurisë së furnizimit, si dhe kontributin e mundshëm të depozitës, kur kjo e fundit është në Shqipëri apo në ndonjë vend anëtar të Komunitetit të Energjisë;

d) masa dhe veprime të tjera, të cilat ndërmerren në mënyrë që të heqin ose të pakësojnë pasojat e ndërprerjes së furnizimit me gaz natyror, në varësi të shkallës së krizës.

6. Pjesëmarrësit në tregun e gazit natyror planifikojnë dhe marrin masat për një furnizim të sigurt me gaz natyror, në përputhje me standardet, ashtu siç parashikohet në pikën 3 të këtij neni, si dhe janë përgjegjës për furnizimin me gaz natyror brenda qëllimit të veprimtarisë.

7. ERE është autoriteti përgjegjës për monitorimin e sigurisë së furnizimit.

8. Plani i veprimit parandalues dhe plani i emergjencës i vihen në dispozicion Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

9. Kur vendi ka një nivel të përshtatshëm të interkonjeksionit, ministria ose shoqëria përgjegjëse e gazit natyror mund të marrë masat e duhura në mënyrë që të arrihen standardet e sigurisë së furnizimit, duke përdorur impiantet e depozitimit të vendosura në territorin e palës tjetër kontraktuese. Për këtë qëllim mund të bashkëpunohet me autoritetet dhe/ose shoqëritë e gazit natyror të një vendi të BE-së ose të një pale tjetër të Komunitetit të Energjisë, përfshirë këtu lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe. Aplikimi i këtyre masave nuk duhet të pengojë funksionimin normal të tregut vendas.

10. Plani i veprimit parandalues dhe plani i emergjencave përditësohen çdo katër vjet ose më shpesh në rastet kur siguria e furnizimit me gaz vendoset në rrezik ose me kërkesë të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.”

Neni 6/1

Deklarimi i një gjendjeje krize në furnizimin me gaz natyror

1. Tri nivelet e gjendjes së krizës janë si më poshtë:

a) niveli i paralajmërimit të hershëm (paralajmërimi i hershëm), kur ka informacion konkret, serioz dhe të besueshëm se mund të ndodhë një ngjarje që ka të ngjarë të rezultojë në përkeqësim të konsiderueshëm të situatës së furnizimit me gaz dhe ka të ngjarë të çojë në alarm ose të shkaktojë nivelin e emergjencës. Niveli i paralajmërimit të hershëm mund të aktivizohet

nga një mekanizëm i paralajmërimit të hershëm;

b) niveli i alarmit (alarmi), nëse ndodh një ndërprerje e furnizimit me gaz ose një kërkesë jashtëzakonisht e lartë për gaz, që përkeqëson seriozisht situatën e furnizimit me gaz, por tregu është ende në gjendje të menaxhojë atë ndërprerje ose kërkesë pa pasur nevojë të përdorë masa jo të bazuara në treg;

c) niveli i emergjencës (emergjenca), kur ka kërkesa jashtëzakonisht të larta për gaz, ndërprerje të konsiderueshme të furnizimit me gaz ose përkeqësim tjetër të rëndësishëm të situatës së furnizimit me gaz dhe të gjitha masat përkatëse të bazuara në treg janë zbatuar, por furnizimi me gaz nuk është i mjaftueshëm për të plotësuar kërkesën e mbetur, kështu që duhet të futen masat shtesë jo të bazuara në treg me qëllim, në veçanti, për të mbrojtur furnizimet e gazit për klientët e mbrojtur në përputhje me standardet e furnizimit me gaz.

2. Ministria, pas marrjes së miratimit me vendim nga Këshilli i Ministrave, deklaron një nga nivelet e krizave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, informon Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe autoritetet kompetente të vendeve palë të Komunitetit të Energjisë ose të shteteve anëtare të Bashkimit Europian, me të cilat është e lidhur drejtpërdrejt dhe u transmeton atyre të gjitha informacionet e domosdoshme, në veçanti, për veprimet që synon të ndërmarrë.

3. Nëse ministria ka deklaruar një “emergjencë” dhe ka treguar se veprimi ndërkufitar është i nevojshëm, çdo rritje në standardin e furnizimit me gaz ose detyrime shtesë të imponuar për ndërmarrjet e gazit natyror reduktohet përkohësisht në nivelin e përcaktuar në planin e emergjencës.

Detyrimet e përmendura në paragrafin e parë të kësaj pike pushojnë së zbatuari menjëherë pasi ministria pas njoftimit dhe marrjes edhe të miratimit nga Këshilli i Ministrave deklaron përfundimin e gjendjes së “emergjencës”, ose kur Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka dalë në konkluzionin se deklarimi i gjendjes së “emergjencës” nuk ekziston ose nuk është më e justifikuar.

4. Kur ministria pas njoftimit dhe marrjes së miratimit edhe nga Këshilli i Ministrave shpall një “emergjencë”, ajo

ndjek veprimet e paracaktuara në planin e emergjencës dhe menjëherë informon Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe autoritetet kompetente të shteteve anëtare me të cilat është e lidhur drejtpërdrejt, veçanërisht në lidhje me veprimet që ajo synon të ndërmarrë. Në rrethana të jashtëzakonshme e të justifikuar, ministria mund të ndërmarrë veprime që devijojnë nga plani i emergjencës të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Ministria informon menjëherë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe autoritetet kompetente të shteteve anëtare të Bashkimit Europian me të cilat është e lidhur drejtpërdrejt, për veprime të tilla dhe e justifikon atë devijim.

5. Nëse ministria pas njoftimit dhe marrjes edhe të miratimit nga Këshilli i Ministrave deklaron përfundimin e një prej niveleve të krizave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, ajo informon Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe autoritetet kompetente të shteteve anëtare të Bashkimit Europian me të cilat është e lidhur drejtpërdrejt.”.

Neni 7

Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e sigurisë së furnizimit

1. Ministria është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e sigurisë së furnizimit me gaz natyror dhe konkretisht për:

a) zbatimin e duhur të standardeve minimale të sigurisë së furnizimit, siç përcaktohet në nenin 6 të këtij ligji;

b) balancimin e kërkesës e të ofertës në tregun e gazit natyror të Shqipërisë;

c) kontratat afatgjata të furnizimit me gaz, të importuar nga vendet e treta;

ç) aftësinë paguese të mjaftueshme të furnizimit me gaz;

d) nivelin e gazit të përdorshëm dhe të kapacitetit të tërheqjes nga depozitat e gazit;

dh) nivelin e interkoneksioneve të sistemit të gazit natyror të Shqipërisë me sistemet fqinje të palëve të saj të Komunitetit të Energjisë;

e) nivelin e kërkesës në të ardhmen dhe nivelin e furnizimit të disponueshëm për situatën e parashikuar të furnizimit me gaz, në funksion të kërkesës, pavarësisht së ofertës dhe burimeve të furnizimit në dispozicion;

ë) kapacitetet shtesë të planifikuara ose në proces planifikimi;

f) cilësinë dhe nivelin e mirëmbajtjes së rrjeteve;

g) masat për të mbuluar kërkesën maksimale dhe mungesat e një ose më shumë furnizuesve.

2. Deri më 31 korrik të çdo viti, ministria, në bashkëpunim me ERE-n, përgatit dhe publikon një raport për rezultatet e monitorimit, në lidhje me çështjet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, si dhe masat e marra ose të parashikuara për trajtimin e tyre.

3. Raporti i përmendur në pikën 2, të këtij neni, përfshin çështjet e mëposhtme:

a) gjendja e konkurrencës në tregun e gazit natyror dhe ndikimi që krijon zbatimi i masave të marra në zbatim të nenit 6, të këtij ligji, për të gjithë pjesëmarrësit në tregun e gazit natyror;

b) nivelet e kapacitetit të depozitimit;

c) shtrirjen e kontratave afatgjata të furnizimit me gaz, të lidhura nga kompanitë e themeluara e të regjistruara në Shqipëri dhe, në veçanti, afatin e mbetur nga momenti i lidhjes së kontratave, bazuar në informacionin e siguruar nga kompanitë e përfshira, duke përjashtuar informacionin konfidencial, shkallën e likuiditetit të tregut të gazit;

ç) kuadrin ligjor për të nxitur investime të reja në kërkimin, prodhimin, depozitimin, GNL-në dhe transportin e gazit, duke marrë parasysh nenin 78 të këtij ligji.

4. Raporti i përgatitur dhe i publikuar nga ministria i njoftohet Këshillit të Ministrave, si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Neni 8

Masat mbrojtëse për sigurinë e furnizimit

1. Në rast të një krize të menjëhershme në tregun e energjisë ose kur siguria fizike e personave, pajisjeve a instalimeve apo e integritetit të sistemit kërcënohet, ministria, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse, merr masat mbrojtëse të përkohshme, të nevojshme. Këto masa duhet të jenë të kufizuara qartë dhe të jenë të aplikueshme për një periudhë të caktuar kohore, të nevojshme për të trajtuar situatën emergjente dhe për të zbutur pasojat që mund të vijnë prej saj.

2. Masat e marra në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, aplikohen dhe koordinohen me planin e emergjencës, siç parashikohet në nenin 6, të këtij ligji, në mënyrë që të sjellin efekte negative sa më të vogla të mundshme për funksionimin e tregut të brendshëm dhe merren vetëm kur janë të nevojshme për shmangien e vështirësive të menjëhershme, që mund të jenë krijuar. Këto masa duhet të aplikohen në mënyrë të barabartë, transparente dhe jodiskriminuese.

3. Ministri njofton menjëherë Këshillin e Ministrave dhe, kur e shih të nevojshme, edhe vendete tjera të Komunitetit të Energjisë, me të cilat ka marrëdhënie bashkëpunimi në sektorin e gazit natyror për masat mbrojtëse të marra sipas pikës

1 të këtij neni.

4. Ministri, pa vonesë, njofton Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në lidhje me masat mbrojtëse të marra në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

5. Në rastet kur kriza në sektorin e gazit natyror nuk mund të menaxhohet në mënyrë të përshtatshme nëpërmjet masave kombëtare, ministri njofton kryetarin e grupit koordinues të sigurisë së furnizimit të Komunitetit të Energjisë, i cili mbledh menjëherë grupin *ad hoc* të koordinimit të sigurisë së furnizimit për shqyrtimin e situatës dhe, kur gjykohet e arsyeshme, mund të ndihmojë Shqipërinë dhe/ose palët e tjera të Komunitetit të Energjisë, të përfshira në koordinimin masave të marra në nivel kombëtar, për të përballuar situatën e krizës në sektorin e gazit natyror.

Neni 9

Bashkëpunimi rajonal

~~Për të garantuar një furnizim të sigurt në tregun e brendshëm të gazit natyror, autoritetet përgjegjëse vendase bashkëpunojnë me autoritetet përgjegjëse të vendeve fqinje, anëtare të BE-së, si dhe të palëve të tjera të Komunitetit të Energjisë për të nxitur bashkëpunimin rajonal dhe dypalësh.~~

Neni 9

Bashkëpunimi rajonal dhe solidariteti

1. Për të garantuar një furnizim të sigurt në tregun e brendshëm të gazit natyror, ministria dhe autoritetet përgjegjëse vendase gjatë procesit të hartimit të vlerësimeve të rrezikut dhe planit të veprimit parandalues dhe planit të emergjencës bashkëpunojnë me autoritetet përgjegjëse të vendeve fqinje, anëtare të BE-së, si dhe të palëve të tjera të Komunitetit të Energjisë për të nxitur bashkëpunimin rajonal dhe dypalësh. Ky bashkëpunim mund të përfshijë, veçanërisht, identifikimin e bashkëveprimit e korrelacionit të rreziqeve dhe konsultimeve për të siguruar koherencën ndërkuftare të planeve të veprimit parandalues dhe planeve emergjente.

2. Nëse gjatë procesit të hartimit të vlerësimeve të rrezikut, të planit të veprimit parandalues dhe planit të emergjencës, për të garantuar një furnizim të sigurt në tregun e brendshëm të gazit natyror, kërkohet zbatimi i masës së solidaritetit me një vend që është palë e Komunitetit të Energjisë ose është shtet anëtar i Bashkimit Europian, me të cilin është vendosur lidhja direkte me rrjetin e gazit natyror, ministria ose Operatori i Sistemit të Transmetimit apo Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që furnizimi me gaz në të gjithë territorin e vendit për klientët, me përjashtim të “klientëve të mbrojtur në kuadër të solidaritetit”, të zvogëlohet ose të mos vazhdojë në masën e duhur për sa kohë që furnizimi me gaz për “klientët e mbrojtur në kuadër të solidaritetit” nuk është i kënaqshëm.

Ministria dhe autoritetet e tjera përgjegjëse në zbatim të planit të veprimit parandalues dhe planit të emergjencës do të sigurojnë që vëllimi përkatës i gazit të shpërndahet në mënyrë efektive për klientët e mbrojtur në kuadër të solidaritetit në të gjithë territorin e vendit.

3. Në funksion të garantimit të një furnizimi të sigurt me gaz natyror, përfshirë edhe bashkëpunimin dhe solidaritetin rajonal, Shqipëria si palë e Komunitetit të Energjisë do të bashkërendojë veprimtaritë me vendet e tjera palë të Komunitetit të Energjisë, si dhe do të informojë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për planin e veprimit parandalues dhe planin e emergjencës, si dhe për masën e solidaritetit, nëse një hap i tillë do të ndërmerret.”.

Neni 10

Rregullat teknike dhe të sigurisë në sektorin e gazit natyror

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat teknike dhe kriteret e sigurisë, ku përcaktohen kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit, të linjave direkte, si edhe çdo impianti ose instalimi tjetër që përfshihet në sektorin e gazit për operimin e sigurt të sistemeve.

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat teknike për kryerjen e operacioneve të depozitimit të gazit natyror në vendburimet hidrokarbure ose në hapësirat e tjera nëntokësore.

2. Deri në miratimin nga Këshilli i Ministrave të rregullave, sipas pikës 1, të këtij neni, ministri përcakton rregullat teknike, që do të zbatohen gjatë periudhës së ndërmjetme, të cilat duhet të jenë në përputhje me normativat e vendeve të Europës.

3. Kontrolli i zbatimit dhe mbikëqyrja e rregullave teknike, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, kryhen nga inspektorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Subjektet, që ushtrojnë veprimtari, sipas dispozitave të këtij ligji, janë përgjegjëse për kryerjen e veprimtarive përkatëse, në përputhje me rregullat teknike, standardet, si edhe kushtet për mbrojtjen e mjedisit, të përcaktuara në këtë ligj, si edhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Neni 11

Ndërtimi dhe përdorimi i tubacioneve dhe i infrastrukturës së gazit natyror

1. Ndërtimi dhe përdorimi i tubacioneve për transmetimin e shpërndarjen e gazit natyror, instalimeve të GNL-së, depozitave të gazit natyror, linjave direkte, lidhjes së sistemit shqiptar të gazit natyror me sistemet fqinje, si edhe çdo impianti, pajisjeje ose instalimi tjetër që përfshihet në sektorin e gazit natyror, bëhen me miratim nga Këshilli i Ministrave.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kushtet e procedurat për dhënien e miratimit për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së gazit natyror mbi baza transparente e jodiskriminuese. Marrëveshja e lidhur mes ministrisë dhe investitorit duhet të përfshijë të paktën kushtet si më poshtë:

- a) funksionimin e sigurt të sistemit të gazit;
- b) kushtet për përcaktimin e vendndodhjes dhe përdorimit të tokës;
- c) efikasitetin e energjisë;
- ç) kushtet për përdorimin e burimeve parësore të energjisë;
- d) mbrojtjen në punë dhe sigurinë e njerëzve e të pasurisë;
- dh) mbrojtjen e mjedisit;
- e) aftësinë financiare të aplikantit për të përballuar ndërtimin e objektit të gazit natyror, e vërtetuar nga dokumente bankare ose dokumente të ngjashme që vërtetojnë aftësinë financiare të aplikantit;
- ë) kontributin e kapaciteteve për transport ose depozitim të gazit natyror për të rritur sigurinë e furnizimit;
- f) kushtet e përgjithshme të marrëveshjes që arrihet ndërmjet ministrisë përgjegjëse dhe investitorit, që do të ndërtojë dhe do të përdorë infrastrukturën e gazit;
- g) kushtet mbi llojin e dokumentacionit që provon marrëdhënien e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, ku është planifikuar ndërtimi i objektit të gazit natyror;
- gj) listën e dokumenteve të kërkuara për marrjen e miratimit;
- h) tarifat e aplikueshme për dhënien e miratimit për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve dhe infrastrukturës së gazit natyror;
- i) kushtet për refuzimin e miratimit.

3. Miratimi jepet për një afat deri në 30 vjet, me të drejtë përsëritjeje. Në rastet kur miratimi nuk përsëritet pas përfundimit të afatit të tij, infrastruktura do të çmontohet në përputhje me standardet mjedisore, të parashikuara nga ligji ose të drejtat e pronësisë mbi infrastrukturën do t'i transferohen shtetit apo një investitori tjetër, sipas kriterëve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen e përcaktuar në pikën 2, shkronja "F", të këtij neni. Vendimi i refuzimit për përsëritjen e miratimit duhet të arsyetohet. Në rast të transferimit të të drejtave të pronësisë ndaj shtetit, marrëveshja ndërmjet palëve të përfshira duhet të përcaktojë afatet dhe kushtet për një transferim të tillë.

4. Këshilli i Ministrave, përveç rasteve të refuzimit, të përcaktuara në pikën 2, shkronja "i", të këtij neni, me qëllim shfrytëzimin efikas të infrastrukturës së gazit, ka të drejtë të refuzojë dhënien e miratimit për ndërtimin dhe përdorimin e sistemit të tubacionit të shpërndarjes në një zonë të caktuar, në rast se për të njëjtën zonë është paraqitur më parë një propozim për investim ose nëse kapaciteti i infrastrukturës ekzistuese të gazit në atë zonë mbulon kapacitetin e kërkuar.

5. Refuzimi për dhënien e një miratimi, si dhe për përsëritjen e miratimit, mund të ankimohet nga kërkuesi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Miratimi i dhënë, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk përjashton marrjen e autorizimeve lejeve, deklaratave, licencave apo autorizimeve të tjera, të cilat mund të kërkohen sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për ndërtimin e infrastrukturës së gazit, të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, si dhe mbrojtjen e mjedisit e respektimin e rregullave teknike e të sigurisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Modifikimi i miratimit të dhënë bëhet me kërkesë të mbajtësit të miratimit, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. Modifikimet e miratimit nuk duhet të ndryshojnë objektin për të cilin është dhënë ky miratim.

8. Miratimi i dhënë sipas këtij neni nuk transferohet.

Neni 12

Të drejtat e pronësisë

1. Për sigurinë e shërbimit të veprimtarive të tubacioneve të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, impianteve të GNL-së, impianteve të depozitimit nëntokësor, linjave direkte, ndërlidhësve të sistemit të gazit natyror shqiptar me sistemet fqinje, si dhe të çdo impianti apo instalimi që ka të bëjë me sektorin e gazit natyror, subjekti që pajiset me miratim, sipas nenit 11, të këtij ligji, mund të ushtrojë një ose disa prej të drejtave të mëposhtme mbi pronën:

- a) të drejtën e përdorimit;
- b) të drejtën e servitutit;
- c) të drejtën e shpronësimit;
- ç) të drejtën për vendosjen e instalimeve e sistemeve të gazit.

2. Kur ushtrohen të drejtat, sipas pikës 1, të këtij neni, dëmet e shkaktuara nga:

- a) vendosja e shenjave, matjeve apo testeve;
- b) instalimi i pajisjeve, aksesit apo kryerja e punës në to;
- c) pengimi ose kufizimi i përdorimit të pronës;

i rimburohen pronarit ose përdoruesit të pronës nga subjekti, në përputhje me Kodin Civil dhe legjislacionin për shpronësimet e marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik.

3. Në zonat natyrore të mbrojtura, të drejtat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, jepen me miratimin paraprak të autoritetit përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura dhe mbrojtjen e mjedisit.

Në zonat që janë në administrim të njësisive të qeverisjes vendore nevojitet miratimi paraprak injësisë përkatëse vendore.

4. Në rast të përfundimit të të drejtave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, subjekti merr masa për rehabilitimin e plotë të pronës së përdorur.

5. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes administrojnë rrjetet e marrin masa që gjatë ndërtimit dhe operimit të tyre të respektojnë të gjitha kërkesat e kushtet teknike të sigurisë, duke përfshirë edhe respektimin e distancave të sigurisë së rrjeteve në raport me objektet e tjera që u përkasin palëve të treta.

6. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes apo përdoruesite impianteve të GNL-së, impianteve të depozitimit, linjave direkte, ndërlidhësve të sistemit të gazit natyror shqiptar me sistemet fqinje, si dhe të çdo impianti apo instalimi që ka të bëjë me sektorin e gazit natyror, nuk kanë asnjë detyrim ndaj pretendimeve të personave fizikë ose juridikë, për dëme të shkaktuara, si rezultat i distancës së rrjeteve të transmetimit apo shpërndarjes në raport me çdo objekt apo strukturë, në pronësi apo posedim të tyre, në rast se objekti ose struktura apo pjesë të tij/të saj janë ndërtuar apo vendosur në këto distanca pas ndërtimit të rrjetit të shpërndarjes apo transmetimit.

7. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, si dhe operuesite impianteve të GNL-së, impianteve të depozitimit, linjave direkte, ndërlidhësve të sistemit të gazit natyror shqiptar me sistemet fqinje janë të përjashtuar nga aplikimi i çdo takse apo tarife të vendosur prej organeve të qeverisjes vendore mbi asetet, rrjetet dhe instalimet përkatëse që ipërkasin këtyre operatorëve.

KREU III

RREGULLIMI I SEKTORIT TË GAZIT NATYROR

SEKSIONI I

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Neni 13

Autoriteti rregullator

1. ERE është autoriteti rregullator i veprimtarive në sektorin e gazit natyror, me përjashtim të veprimtarisë së kërkimit dhe të prodhimit të gazit.

2. ERE ushtron kompetencat në mënyrë të pavarur dhe transparente, në përputhje me këtë ligji dhe ligjin për sektorin e energjisë elektrike.

3. Krijimi dhe funksionimi i ERE-s rregullohen në bazë të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

Neni 14

Pagesat rregullatore

ERE përcakton dhe miraton pagesat e aplikimit për licencë dhe pagesat rregullatore për të licencuarit në sektorin e gazit natyror, në përputhje me metodologjinë e miratuar prej saj.

Neni 15

Objektivat kryesorë të ERE-s

1. Objektivat e ERE-s në kryerjen e funksioneve rregullatore, të përcaktuara në këtë ligj, janë:

a) promovimi i krijimit të një tregu të brendshëm konkurrues, të sigurt dhe miqësor, ndaj mjedisit për të gjithë klientët dhe furnizuesit, duke siguruar kushtet e duhura për funksionimin e sigurt e të qëndrueshëm të rrjeteve të gazit natyror, në bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Energjisë dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera;

b) angazhimi në zhvillimin dhe funksionimin e një tregu rajonal konkurrues në Komunitetin e Energjisë;

c) eliminimi i kufizimeve në tregtimin e gazit natyror me vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë zhvillimin e kapaciteteve ndërkufitare të transmetimit;

ç) angazhimi në zhvillimin e një sistemi të sigurt, të qëndrueshëm, jodiskriminues dhe në mbrojtje të klientit, në përputhje me objektivat e zhvillimit të sektorit të gazit natyror, efikasiteti të energjisë, si dhe integrimi në shkallë të gjerë të prodhimit të energjisë nga burimet e energjisë së rinovueshme;

d) sigurimi i mbështetjes për zbatimin e stimujve të duhur për operatorët e përdoruesit e sistemit për të rritur efikasitetin në punën e sistemit dhe për të nxitur integrimin e tregut, si në planin afatshkurtër dhe atë afatgjatë;

dh) sigurimi i përfitimit të klientëve prej funksionimit të tregut të brendshëm, duke promovuar konkurrencën dhe mbrojtjen e klientëve;

e) garantimi i standardeve në përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik për gaz natyror, mbrojtja e klientëve në nevojë dhe sigurimi i përputhshmërisë gjatë procesit të shkëmbimit të të dhënave, lidhur me ndryshimin e furnizuesit.

2. Në përmbushjen e objektivave të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, ERE bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe me institucione të tjera të pavarura.

Neni 16

Përgjegjësitë e ERE-s

Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, ERE ka këto përgjegjësi:

1. Harton, miraton dhe publikon metodologjitë për:

a) caktimin e tarifave të lidhjes dhe tarifave, termat dhe kushtet për aksesin në rrjetet e gazit natyror, tarifave për aksesin në impiantet e GNL-së, duke bërë të mundur realizimin e investimeve të nevojshme në rrjete, të cilat do të lejojnë efikasitetin e rrjeteve dhe të impianteve të GNL-së;

b) caktimin e çmimeve të furnizimit me gaz natyror të klientëve familjarë, klientëve të vegjël jofamiljarë si dhe caktimin e tarifave për furnizimin e mundësisë së fundit;

c) caktimin e tarifave për aksesin në infrastrukturën ndërkufitare, duke marrë në konsideratë procedurat për shpërndarjen e kapacitetit dhe menaxhimin e kapacitetit të kufizuar.

2. Vendos tarifa sipas metodologjive të përmendura në pikën 1, të këtij neni, në përputhje me kushtet e përcaktuara nga ERE, si dhe monitoron zbatimin e tarifave dhe çmimeve.

3. Monitoron ndarjen e detyrimeve të operatorëve të sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

4. Monitoron zbatimin e detyrimit për garantimin e aksesit në sistemet e transmetimit dhe të shpërndarjes, përfshirë:

a) monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave për alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit;

b) monitorimin mbi zbatimin e detyrimit mbi publikimin e informacionit të mjaftueshëm nga OST-ja dhe OSSH-ja për interkoneksionet, përdorimin e rrjetit dhe alokimin e kapacitetit për palët e interesuara, përfshirë tarifave, duke pasur parasysh informacionin tregtar konfidencial;

c) monitorimin e çdo mekanizmi për kapacitetet e kufizuara, brenda sistemit kombëtar të gazit natyror;

ç) monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave për përjashtimet nga detyrimi i ofrimit të aksesit të palëve të treta, sipas angazhimeve “merr ose paguaj” dhe marrëveshjeve të tjera ndërmjet shoqërive të sistemit të gazit natyror dhe përdoruesve të sistemit.

5. Monitoron zbatimin e rregullave të menaxhimit të kapacitetit të kufizuar në rrjetet e transmetimit të gazit, përfshirë këtu edhe linjat e interkoneksionit, si dhe në raste të caktuara, kur është në interesin publik, merr vendim mbi mënyrën e menaxhimit të kapacitetit të kufizuar. Për këtë qëllim, operatorët e sistemit të transmetimit ose operatorët e tregut duhet të paraqesin rregullate tyre të menaxhimit të mbingarkesës, duke përfshirë shpërndarjen e kapaciteteve, për

autoritetet kombëtare rregullatore.

6. Monitoron dhe shqyrton kushtet e aksesit në lidhje me depozitën, *linepack*-undhe shërbimet e tjera ndihmëse, siç parashikohet në nenin 63, të këtij ligji, si dhe monitoron zbatimin e duhur të kriterëve që përcaktojnë nëse një impiant depozitimi përputhet me kriteret e pikës 5 ose 7, të nenit 63, të këtij ligji.

7. Mbikëqyr zbatimin e detyrimeve për shërbime publike, në përputhje me kërkesat e parashikuara në këtë ligj dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

8. Mbikëqyr zbatimin me efektivitet nga shoqëritë e gazit natyror të masave mbrojtëse ndaj klientëve fundorë.

9. Siguron që klientët të mund të zgjedhin furnizuesit e rinj, sipas kriterëve e kushteve të parashikuara në këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

10. Miraton kushtet e përgjithshme të furnizimit, duke përfshirë këtu edhe hartimin në mënyrë transparente të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të përgjithshme.

11. Kryen dhënien, ndryshimin, transferimin dhe heqjen e licencave për shoqëritë e gazit natyror, sipas parashikimit të nenit 22 të këtij ligji.

12. Miraton planet e investimeve të të licencuarve në sektorin e gazit natyror, si dhe kryen mbikëqyrjen e tyre.

13. Përcakton kërkesat minimale për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, përfshirë kapacitetin e interkoneksionit.

14. Miraton rregulloren për të siguruar ndarjen efektive të llogarive, me qëllim eliminimin e ndërsubvencionimeve ndërmjet veprimtarive në sektor, përfshirë rregullat për mbajtjen e auditimeve llogarive të shoqërive të gazit natyror.

15. Ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar të shoqërive të gazit natyror dhe të pjesëtarëve të tjerë të këtij sektori.

16. Përcakton procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet shoqërive të gazit natyror dhe ndërmjet tyre dhe klientëve fundorë.

17. Përcakton përjashtimet për infrastrukturën e re, sipas kushteve të parashikuara në nenin 81 të këtij ligji.

18. Vendos standardet dhe kërkesat minimale për cilësinë e shërbimit dhe furnizimit, veçanërisht për kohën që u duhet operatorëve të transmetimit e të shpërndarjes për të bërë lidhjet dhe riparimet, si dhe mbikëqyr zbatueshmërinë e tyre.

19. Monitoron shoqëritë e gazit natyror për përmbushjen e detyrimit të transparencës, si dhe mbikëqyr çmimet me shumicë të aplikueshme nga shoqëritë e gazit natyror.

20. Monitoron nivelin dhe efektivitetin e hapjes së tregut dhe konkurrencës në shitjet meshumicë e pakicë, përfshirë shkëmbimet e gazit natyror, çmimet për klientë familjarë, sistemet e parapagimit, rregullat e shkëputjes, pagesat për kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe ankesat nga klientët familjarë, si dhe çdo shtrembërim apo kufizim të konkurrencës, përfshirë çdo informacion të rëndësishëm, dhe dërgimin e rasteve përkatëse tek Autoritetit i Konkurrencës.

21. Përcakton mekanizma dhe masa për të shmangur çdo abuzim me pozitën dominuese në treg, e cila krijon pasoja negative për interesat e ligjshëm të klientëve.

22. Monitoron shfaqjen e praktikave kufizuese kontraktuale, përfshirë klauzolat e ekskluzivitetit, të cilat mund të parandalojnë klientët e mëdhenj të kontraktojnë në të njëjtën kohë më shumë se një furnizues ose të kufizojnë zgjedhjen e tyre për ta bërë këtë dhe informon Autoritetin e Konkurrencës për praktika të tilla.

23. Respekton lirinë kontraktuale për sa i përket ndërprerjes së kontratave të furnizimit, si dhe kontratave afatgjata, që ato të jenë në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

24. Miraton kërkesat e monitorimit e të raportimit të informacionit, për shoqëritë e gazit natyror, për të siguruar një administrim efektiv dhe eficient të këtij ligji.

25. Bashkëpunon me autoritetet rregullatore të vendeve të tjera fqinje, si dhe me Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për harmonizimin e kuadrit rregullator për zhvillimin e tregut rajonal të gazit natyror, përfshirë edhe shkëmbimet ndërkufitare të gazit natyror dhe rregullat për menaxhimin e kapaciteteve të interkoneksionit.

26. Garanton përmbushjen e detyrimit nga shoqëritë e gazit natyror, lidhur me aksesin e klientëve fundorë në të dhënat e matjes e konsumit, të cilat duhet t'u vihen në dispozicion në një format standard e të kuptueshëm.

27. Miraton metodologjinë për llogaritjen e çmimit për shërbimet ndihmëse dhe balancimin, me propozimin e operatorit përgjegjës.

28. Të gjitha vendimet e ERE-s publikohen në Fletoren Zyrtare, përveç vendimeve me karakter individual.

Të drejtat e ERE-s

1. ERE ka të drejtat e mëposhtme:

a) të kërkojë çdo informacion të nevojshëm për zbatimin e plotë të kompetencave të saj, në përputhje me këtë ligj, legjislacionin në fuqi, i zbatueshëm nga çdo autoritet, organ shtetëror, shoqëri ose person, i cili zotëron një informacion të tillë;

b) të kryejë konsultime publike, në përputhje me nenet 18 dhe 19, të këtij ligji, për mbledhjen e informacionit për harmonizimin e praktikave rregullatore, arsyetimin e vendimeve të marra ose vlerësimin e propozimeve ligjore dhe/ose zgjidhjeve me karakter rregullator;

c) të mbledhë të dhëna lidhje me funksionimin e tregut të gazit natyror dhe të vendosë masat e nevojshme dhe në proporcion të drejtë për nxitjen e konkurrencës efektive dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut të gazit natyror;

ç) të marrë vendime, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë të licencuarit që veprojnë në sektorin e gazit natyror;

d) të vendosë masa administrative efektive, proporcionale dhe parandaluese ndaj të licencuarve;

dh) të kërkojë nga OST-ja dhe OSSH-ja, si dhe nga operatorët e depozitës dhe sistemit të GNL-së, nëse është e nevojshme, për të ndryshuar kriteret dhe kushtet, përfshirë tarifën e aplikuar nga këta operatorë, për të siguruar që ato të jenë proporcionale dhe të zbatohen në mënyrë jodiskriminuese;

e) të miratojë tarifën e përkohshme transmetimi ose shpërndarjeje, në rastet kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave. Në këtë rast, kur tarifën e miratuar rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme, ERE vendos masat e përshtatshme kompensuese;

ë) të zgjidhë mosmarrëveshjet sipas parashikimeve të nenit 98 të këtij ligji.

2. ERE ushtron të drejtat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, pavarësisht se çështje të caktuara përfshihen edhe në fushën e përgjegjësisë së organeve të tjera.

3. Vendimet e ERE-s mund të ankimohen në Gjykatën Administrative, Tiranë, brenda 45 ditëve nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

4. Vendimet e ERE-s duhet të jenë të arsyetuara. Këto vendime vihen në dispozicion të publikut, duke ruajtur konfidencialitetin rreth informacionit tregtar.

Bashkëpunimi dhe konsultimi me publikun

1. ERE publikon projektaktet e iniciuara, me përjashtim të akteve individuale apo vendimeve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në mënyrë që t'u sigurojë palëve të interesuara të drejtën për të paraqitur, brenda një afati kohor të arsyeshëm, komente, vërejtje apo propozime.

2. ERE miraton rregulloren për konsultimet publike, ku për aq sa është e mundur merr në konsideratë procedurat dhe afatet e legjislacionit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik, ku, ndër të tjera, parashikohen kushtet dhe procedurat, paraqitja e kërkesës formale dhe shpallja publike e informacionit. ERE publikon rezultatet e konsultimeve publike, me përjashtim të çdo informacioni konfidencial me natyrë tregtare.

3. Duke ruajtur pavarësinë e saj dhe në funksion të parimit të rregullimit më të mirë, ERE konsultohet me OST-në dhe/ose shoqëritë e tjera të gazit natyror, si dhe bashkëpunon ngushtë me autoritetet e tjera përgjegjëse për çështje të caktuara.

Bashkëpunimi me autoritetet e tjera

1. Në funksion të realizimit të përgjegjësisë dhe kompetencave që përcaktohen në këtë ligj, ERE konsultohet dhe bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për energjinë.

2. ERE bashkëpunon me Autoritetin e Konkurrencës, përfshirë, por pa kufizuar edhe detyrimin për të informuar Autoritetin e Konkurrencës për çdo rast të shkeljes së ligjit që cenon hapjen e tregut të gazit natyror dhe të konkurrencës.

3. ERE bashkëpunon me autoritetet e tjera rregullatore në Shqipëri, përfshirë, por pa u kufizuar në informimin e tyre, në lidhje me shkeljet e ligjit, të cilat janë evidentuar gjatë monitorimit të efektivitetit, hapjes së tregut të gazit natyror dhe të konkurrencës në treg.

4. ERE konsultohet dhe bashkëpunon me autoritetet rregullatore të palëve të Komunitetit të Energjisë dhe u jep informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave nga ana e tyre, si edhe gëzon të drejtën të kërkojë një informacion

të tillë nga palët anëtare. Në lidhje me informacionin e shkëmbyer, ERE do të sigurojë të njëjtin nivel konfidencialiteti sikundër është përcaktuar nga autoriteti që e ka lëshuar atë dokument.

5. ERE bashkëpunon në nivel ndërkombëtar, sipas përcaktimit të pikës 4, të këtij neni, me qëllim që:

a) të nxisë lidhjen e marrëveshjeve operative në mënyrë që të mundësojë një menaxhim optimal të rrjetit, të nxisë shkëmbimet e përbashkëta të gazit dhe alokimin e kapacitetit ndërkufitar, të mundësojë një nivel të përshtatshëm të kapaciteteve të interkoneksionit, duke përfshirë ndërlidhjet ertre, në rajon dhe jashtë tij, në mënyrë që të lejojë zhvillimin e konkurrencës efektive dhe përmirësimin e sigurisë së furnizimit, pa diskriminim ndërmjet shoqërive të furnizimit të palëve të ndryshme të Komunitetit të Energjisë;

b) të koordinojë zhvillimin e të gjitha kodeve të rrjetit të OST-së dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut të gazit natyror;

c) të koordinojë zhvillimin e rregullave, në lidhje me menaxhimin e situatës së kapacitetit të kufizuar.

6. ERE ka të drejtë të hyjë në marrëveshje bashkëpunimi me çdo autoritet tjetër kompetent rregullator për të nxitur bashkëpunimin rregullator.

7. ERE siguron zbatimin e plotë të çdo marrëveshjeje rregulluese të miratuar në kuadrin e bashkëpunimit për projekte të mëdha ndërkufitare të përjashtuara, të lidhura sipas nenit 78 të këtij ligji. ERE nuk duhet që, gjatë ushtrimit të kompetencave të saj, sipas neneve 33 deri 49, të këtijligji, të veprojë në kundërshtim me marrëveshjet rregulluese të pranuar sipas procedurave të bashkëpunimit, të përcaktuara sipas pikës 6 të këtij neni.

8. ERE ka detyrimin të veprojë në përputhje dhe të zbatojë të gjitha vendimet e institucioneve kompetente të Komunitetit të Energjisë, të nxjerra në respektim të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Neni 20

Rregullat e praktikës dhe procedurës së ERE-s

ERE miraton rregullat e praktikës dhe të procedurës, që rregullojnë procedimet e saj përveprimtaritë në sektorin e gazit natyror, përfshirë trajtimin e informacionit konfidencial.

Neni 21

Raportimi

1. ERE, brenda datës 31 mars të çdo viti, paraqet në Kuvend një raport vjetor mbi situatën e sektorit të gazit natyror dhe veprimtaritë e ERE-s për vitin paraardhës. Pas paraqitjes dhe miratimit në Kuvend, ky raport i dorëzohet Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

2. Ky raport përfshin një vlerësim për nivelin e transparencës dhe të konkurrencës në treg si dhe një analizë të veprimtarive të ERE-s dhe përmbushjen e detyrave të saj, duke justifikuar hapat e marrë dhe rezultatet e arritura në lidhje me secilën prej kompetencave dhe përgjegjësisive në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

SEKSIONI II

LICENCIMI NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR

Neni 22

Licencat dhe procedura e licencimit

1. Çdo person juridik, që kryen një veprimtari në sektorin e gazit natyror, sipas pikës 2, të këtij neni, duhet të pajiset me licencën përkatëse, të lëshuar nga ERE, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

2. ERE lëshon licenca për veprimtaritë e mëposhtme:

a) transmetim të gazit natyror;

b) shpërndarje të gazit natyror;

c) furnizim të gazit natyror; ç)

tregtim të gazit natyror;

d) operim në hapësirat e depozitimit të gazit natyror; dh) operim

në impiantet e GNL-së;

e) funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror.

- “ë) operimin në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla;
- f) operimin në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla.”

3. Kryerja e veprimtarive të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pa licencë të miratuar nga ERE, është e paligjshme.

4. Njësitë e qeverisjes vendore mund t'i ushtrojnë veprimtaritë e përmendura në pikën 2, të këtij neni, kur ato kanë marrë licencë nga ERE, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

5. Për operimin e një linje direkte, nuk është e nevojshme marrja e licencës nga ERE.

Neni 23

Kushtet e licencimit

1. ERE përcakton kushtet që duhet të përmbushen për marrjen e një licence, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera:

a) afatin e vlefshmërisë së licencës, i cili, për veprimtaritë e transmetimit, tëshpërndarjes, tëdepozitimit dhe të GNL-së, nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet dhe për veprimtaritë e tjera nuk mund të jetë më shumë se 10 vjet, me të drejtë përsëritjeje;

b) vendndodhjet dhe zonat, në të cilat do të kryhen veprimtaritë e licencuara të gazit natyror;

c) sigurinë operative dhe qëndrueshmërinë e objekteve, pajisjeve apo rrjetit, në përputhje me rregullat teknike të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji;

ç) kërkesat për natyrën e burimeve parësore të energjisë;

d) kërkesat lidhur me sigurinë kombëtare, mbrojtjen e jetës, pasurisë, shëndetit të qytetarëve, si dhe rendin publik;

dh) kërkesat financiare;

e) mbrojtjen e mjedisit;

ë) nxitjen e efijencës së energjisë në sektorin e gazit natyror;

f) detyrimet e shërbimit publik, siç parashikohet në këtë ligj;

g) nxitjen e një tregu konkurrues të gazit natyror;

gj) nëse aplikuesi është i organizuar, në përputhje me parimin e ndarjes së veprimtarive dhe ndarjes strukturore, të përcaktuara në këtë ligj;

h) elemente të efikasitetit ekonomik të aktivitetit që do të kryhet, zhvillimin e rrjetit të gazit e të tregut në vend dhe ndërveprimin midis sistemeve përbërëse me ato të vendit e të rajonit.

2. ERE i jep licencë për transmetimin e gazit natyror vetëm një personi juridik, për një territor tëcaktuar. Përfashtim bëhet vetëm për rastet kur në një territor të caktuar është e domosdoshme të shtrihen dhe të kryejnë veprimtari edhe infrastruktura të transmetimit të gazit me rëndësi strategjike dhe kombëtare, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Dhënia e licencës bëhet mbi bazën e kriterëve të efijencës dhe balancës ekonomike për operatorin e sistemit dhe duke siguruar që veprimtaria e të licencuarit të kryhet në përputhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në seksionin I, të kreut IV, të këtij ligji.

3. ERE i jep licencë për shpërndarjen vetëm një personi, për një territor të caktuar shërbimi. Përfashtim bëhet vetëm për rastet kur në këtë territor është e domosdoshme të shtrihen dhe të kryejnë veprimtari edhe infrastruktura të tjera të shpërndarjes me rëndësi strategjike dhe kombëtare, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Dhënia e licencës bëhet mbi bazën e kriterëve të efijencës dhe balancës ekonomike për operatorin e sistemit dhe duke siguruar që veprimtaria e të licencuarit të kryhet në përputhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në seksionin II, të kreut IV, të këtij ligji.

4. Ministri, nëpërmjet një udhëzimi, cakton zonat e transmetimit e të shpërndarjes, bazuar në kriteret teknike e ekonomike, si dhe duke marrë opinionin e ERE-s.

5. Në përcaktimin e zonave të transmetimit e të shpërndarjes, ministri merr në konsideratë edhe elemente të efikasitetit ekonomik të aktivitetit që do të kryhet, zhvillimin e rrjetit të gazit dhe tregut në vend, si dhe ndërveprimin midis sistemeve përbërëse me ato të vendit e të rajonit.

Neni 24

Procedurat e licencimit

1. ERE miraton rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënen, modifikimin, transferimin oseheqjen e licencave, pagesat e aplikimeve për licencë, si dhe informacionin që duhet paraqitur në kërkesën për aplikim për çdo licencë.

2. ERE mund të japë licencë me kusht, kur gjykon se ndonjë nga kushtet e paplotësuara nuk është thelbësore dhe i licencuari merr përsipër ta përmbushë atë brenda një periudhe të caktuar kohore, të përcaktuar në vendim, por jo më shumë se 12 muaj.

Publikimi për aplikimet për licencë

1. ERE publikon, brenda 14 ditëve nga data e kryerjes së aplikimit për marrjen e një licence, njoftimin për aplikimin e bërë, në përputhje me procedurën e përcaktuar në rregulloren për procedurat e licencimit.

2. Gjatë marrjes së vendimit, ERE duhet të marrë në shqyrtim dhe të vlerësojë vërejtjet ose kundërshtimet e arsyeshme e të bazuara, të paraqitura nga institucionet publike apo palët e tjera të interesuara, në lidhje me kërkesën për licencë, duke arsyetuar në vendim pranimin ose jo të tyre.

Refuzimi i një licence

1. ERE refuzon dhënien e një licence nëse:

- a) aplikuesi nuk përmbush ndonjë nga kushtet e përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji;
- b) aplikuesi është në proces falimentimi ose likuidimi, siç parashikohet në legjislacionin në fuqi;
- c) aplikuesit i është revokuar ose hequr licenca dhe nuk ka përfunduar periudha, brenda së cilës është i ndaluar riaplikimi për licencë, siç është përcaktuar në vendimin përkatës të ERE-s për heqjen e licencës.

2. Në vendimin e ERE-s arsyetohen shkaqet për refuzimin e licencës.

Heqja e licencës

1. ERE heq një licencë kur i licencuari:

- a) nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës së dhënë sipas këtij ligji;
- b) shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
- c) rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve;
- ç) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 14 i këtijligji;
- d) bëhet financiarisht i paafhtë ose kërkon shpalljen e falimentimit;dh) paraqet vetë kërkesë për heqje licence;
- e) ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara sipas licencës.

2. Në rastet e heqjes së licencës, sipas shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 1, të këtijneni, ERE:

a) njofton me shkrim të licencuarin për fillimin e procedurave për heqjen e licencës. Në njoftim duhet të shprehen qartësisht arsyet për heqjen e licencës;

b) respekton të drejtën e të licencuarin për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës;

c) kur është në interesin publik, mund t’i japë të licencuarit 30 ditë kohë, pas përgjigjes së tij meshkrim, që të veprojë në përputhje me kushtet e licencës dhe të shmangë shkakun për heqjen e saj.

3. Në rastet kur ERE merr vendim për heqjen e një licence të licencuarit që ushtron veprimtarinë transmetimit, shpërndarjes, operimit të GNL-së ose të operimit të sistemit të depozitimit, ndaj të cilit është vendosur detyrimi i shërbimit publik, në mënyrë që asetet, pronë e të licencuarit, të vazhdojnë të shfrytëzohen për sigurinë e furnizimit të gazit natyror ndaj klientëve, ERE, bazuar në rregulloren përkatëse të procedurave të heqjes së licencës, vendos një nga masat e përkohshme, të përcaktuara më poshtë:

a) merr vendim për të vendosur nën administrim të kufizuar, për një periudhë të caktuar kohore, shoqërinë së cilës i është hequr licenca, në mënyrë që të sigurohen ushtrimi i veprimtarisë dhe operimi i aseteve të saj deri në marrjen e masave, sipas pikës 8 të këtij neni;

b) cakton një shoqëri tjetër për kryerjen e veprimtarisë së shoqërisë, së cilës i është hequr licenca, e cila duhet të përmbushë kushtet përkatëse të licencimit;

c) merr vendim, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë, për të emëruar një administrator të përkohshëm të shoqërisë, së cilës i është hequr licenca, në mënyrë që të sigurohet ushtrimi i veprimtarisë së operimit të aseteve të saj deri në marrjen e masave, sipas pikës 8 të këtij neni.

4. Për rastet e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, ERE përcakton kushtet dhe detyrimet që duhet të zbatohen nga shoqëria, së cilës i është hequr licenca, gjatë periudhës së zbatimit të masave të përkohshme.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton procedurën dhe kriteret për emërimin e administratorit, i cili do të jetë përgjegjës për administrimin e përkohshëm të shoqërisë, sipas shkronjës “c”,

të pikës 3, të këtij neni.

6. Derisa licenca të transferohet te një shoqëri tjetër ose t'i rijepet së njëjtës shoqëri, do të aplikohen masat e përkohshme, të përcaktuara në pikën 3, të këtij neni, për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj nga data e heqjes së licencës, zbatimimi i të cilave monitorohet nga ERE.

7. Rregullat, procedurat dhe kriteret për zbatimin e kërkesave, sipas pikave 1, 2 dhe 3, të këtij neni, përcaktohen nga ERE në rregulloren përkatëse të procedurave të heqjes së licencës.

8. Kur ERE heq licencën e transmetimit, shpërndarjes, operimit të GNL-së ose të operimit të depozitave, për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 3, të këtij neni, Këshilli i Ministrave, brenda 12 muajve nga data e heqjes së licencës, kryen procedurën e shpronësimit, në bazë të një kompensimi të drejtë të aseteve të të licencuarit, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 28

Modifikimi i kushteve të një licence

1. ERE mund të modifikojë licencën, me iniciativën e vet, në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, kur ndryshojnë kushtet, për të cilat është dhënë licenca, ose me kërkesën e të licencuarit. ERE merr në konsideratë ndikimet e pritshme që modifikimet e iniciuara apo të propozuara sjellin ndaj detyrimeve që i licencuari ka në përputhje me këtë ligj dhe kushtet e licencës së tij.

2. Përpara miratimit të modifikimit të një licence, ERE publikon modifikimet e propozuara dhe shqyrton vërejtjet ose ankesat e mundshme, të paraqitura nga palët e interesuara lidhur me këtë proces.

Neni 29

Transferimi i licencës ose aseteve

1. Transferimi i licencës ose aseteve të të licencuarit, që shërbejnë për kryerjen e veprimtarive të licencuara, bëhet me miratimin paraprak të ERE-s, bazuar në rregulloret e miratuara prej tij. Miratimi i ERE-s nuk është i nevojshëm në rastet e transferimit të aseteve me vlerë minimale apo aseteve që nuk lidhen ngushtësisht me veprimtarinë e licencuar, sipas rregullores së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

2. ERE miraton rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nëpërmjet shitjes, dhënies me qira, hipotekimit, barrës ose çfarëdolloj disponimi tjetër të pajisjeve ose aseteve fikse të të licencuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së transmetimit, shpërndarjes, operimit të GNL-së ose të operimit të depozitave, ku përfshihen edhe rastet kur transferimi i aseteve me vlerë minimale përjashtohet nga procedura e miratimit.

Neni 30

Mbajtja e bilanceve të të licencuarve

1. Shoqëritë e gazit natyror, pavarësisht marrëdhënieve të pronësisë, formës ligjore e organizimit, hartojnë, paraqesin për auditim dhe publikojnë bilancete tyre vjetore sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në ligjet në fuqi dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

2. Shoqëritë e gazit natyror, të cilat nuk kanë detyrim ligjor të publikojnë pasqyrat financiare vjetore, mbajnë një kopje të tyre në dispozicion të publikut në zyrën e tyre kryesore.

3. Çdo i licencuar mban llogari të veçanta për secilën nga veprimtaritë e licencuara që ushtron, si dhe për çdo veprimtari tjetër që nuk lidhet me sektorin e gazit natyror, me qëllim shmangien e ndërsuvencionimit dhe cenimit të konkurrencës. Këto llogari mund të paraqiten të konsoliduara, përveç rastit kur veprimtaritë e kryera lidhen me shpërndarjen apo transmetimin e gazit natyror.

4. Të gjitha shoqëritë e gazit natyror mbajnë llogari të veçanta financiare për veprimtari të tjera të gazit, të cilat mund të jenë të konsoliduara, duke mbajtur të ndara edhe llogaritë që nuk lidhen me veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj.

5. Llogaritë e brendshme financiare të shoqërive të gazit natyror do të përfshijnë bilancin e gjendjes dhe llogaritë e fitimit e të humbjes për secilën veprimtari. Të ardhurat nga pronësia e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes do të specifikohen në llogari.

6. Auditimi i përmendur në pikën 1, të këtij neni, në mënyrë të veçantë, verifikon nëse është respektuar detyrimi për të shmangur diskriminimin dhe subvencionet e tërthorta, sipas pikës 3 të këtij neni.

7. Shoqëritë duhet të specifikojnë rregullat e tyre të brendshme të kontabilitetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Llogaritë vjetore pasqyrojnë nëpërmjet shpjegimeve plotësuese, çdo veprim financiar, të kryer me shoqëritë e tjera të lidhura.

Neni 31

E drejta e aksesit në llogari

1. ERE, në kryerjen e funksioneve të saj, ka të drejtën e aksesit në të dhënat dhe dokumentacionin financiar të shoqërive të gazit natyror, sipas përcaktimeve të nenit 30 të këtij ligji.

2. ERE ruan konfidencialitetin rreth informacionit të ndjeshëm me karakter tregtar që merret ngashoqëritë e gazit natyror, në përputhje me pikën 1 të këtij neni. Ky informacion mund vihet në dispozicion të organeve kompetente vetëm në rastet e parashikuara sipas legjislacionit në fuqi.

SEKSIONI III

TARIFAT E SEKTORIT TË GAZIT NATYROR

Neni 32

Veprimtaritë me tarifa të rregulluara

1. ERE miraton metodologjinë dhe përcakton tarifat për aksesin në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, tarifat e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, tarifat për aksesin në hapësirat e depozitimit dhe impiantet e GNL-së dhe tarifat e furnizimit për klientët fundorë që furnizohen në bazë të detyrimit të shërbimit publik.

2. Çmimet e veprimtarive të shitjes me shumicë të gazit ndërmjet furnizuesve dhe shitjes me pakicë ndërmjet furnizuesve e klientëve përcaktohen bazuar në ofertën dhe kërkesën.

3. Nëse ERE vlerëson se hapësira e depozitimit, shërbimet balancuese ose shërbimet ndihmëse operojnë në një treg mjaftueshëm konkurrues, mund të lejojë përcaktimin e çmimeve në bazë të tregut.

4. Ky nen do të zbatohet pa rënë ndesh me lejimin për të aplikuar çmime të negociuara, sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 33

Vendosja e tarifave

1. Tarifat dhe mënyrat e llogaritjes së tyre duhet të jenë jodiskriminuese, transparente dhe të marrin parasysh nevojën e integritetit të sistemit, të reflektojnë kostot reale, me qëllim kthimin e duhur të investimeve.

2. Tarifat duhet të lehtësojnë tregtimin dhe konkurrencën efiçente të gazit, ndërsa, në të njëjtën kohë, të shmangin ndërsbvencionimet ndërmjet përdoruesve të sistemit dhe të sigurojnë incentiva për investime.

3. Tarifat nuk duhet të kufizojnë likuiditetin e tregut apo të shtrembërojnë tregtinë ndërkufitare të sistemeve të ndryshme të transmetimit. Tarifa e rrjetit nuk llogaritet në bazë të kontratës së ndërshtëmbimit.

4. ERE miraton tarifa që mbulojnë në mënyrë efiçente kostot e realizuara për veprimtaritë e rregulluara, duke siguruar një normë kthimi të arsyeshme të kapitalit të investuar në këto veprimtari dhe duke stimuluar zhvillimin e kapaciteteve të transmetimit, depozitimit dhe shpërndarjes.

5. OST-së dhe OSSH-së u jepen stimuj të mjaftueshëm në planin afatgjatë dhe afatshkurtër përtë rritur efiçencën, për të nxitur integrimin e tregut dhe sigurinë e furnizimit, si dhe për të ofruar mbështetje për veprimtaritë kërkimore.

6. Tarifat caktohen veçmas për çdo pikë hyrëse-dalëse jashtë sistemit të transmetimit, bazuar në mekanizmin e shpërndarjes së kostos dhe metodologjinë e përcaktimit të tarifave në pikat e hyrjes e të daljes, të miratuara nga ERE.

7. Në rastet kur ndryshimet në strukturat tarifore apo mekanizmat balancues mund të pengojnë tregtinë ndërshtetërore, operatorët e sistemit të transmetimit janë të detyruar, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente, të synojnë përputhshmërinë e strukturave tarifore, parimet e caktimit të çmimeve dhe balancimin.

8. Shoqëritë e gazit natyror i shpallin tarifat e tyre të paktën 15 ditë përpara hyrjes së tyre në fuqi, në përputhje me rregullat e ERE-s, sipas parashikimeve të nenit 17 të këtij ligji.

Tarifat dhe rregullat e balancimit

1. Rregullat e balancimit hartohen në mënyrë të drejtë, jodiskriminuese e transparente dhe janë të bazuara në kritere objektive. Këto rregulla duhet të pasqyrojnë nevojat reale të sistemit, duke marrë parasysh burimet në dispozicion të OST-së. Rregullat e balancimit do të jenë të bazuara në kriteret e tregut.

2. Tarifat e balancimit duhet të reflektojnë kostot, duke siguruar stimujt e duhur për të balancuar injektimin dhe marrjen e gazit natyror, si dhe të shmangin ndërsubvencionet mes përdoruesve të rrjetit dhe pengesat e hyrjes për përdoruesit e rinj në rrjet.

3. OST-ja publikon informacion për gjendjen e balancimit të përdoruesve të rrjetit për t'u mundësuar përdoruesve të sistemit marrjen në kohë të veprimeve korrigjuese. Informacioni i dhënë reflekton nivelin e informacionit të disponueshëm nga OST-ja. Për dhënien e këtij informacioni nuk aplikohet tarifë.

4. OST-ja publikon të gjitha kriteret dhe kushtet, përfshirë rregullat dhe tarifat për sigurimin e shërbimeve të balancimit.

KREU IV

VEPRIMTARITË NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR SEKSIONI I

TRANSMETIMI I GAZIT NATYROR

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)

1. Transmetimi i gazit natyror është veprimtari me interes publik dhe kryhet nga operatorë të sistemit të transmetimit, të cilët janë persona juridikë, të licencuar nga ERE, sipas dispozitave të këtij ligji, për ushtrimin e veprimtarisë në një territor të caktuar.

2. OST-ja është një shoqëri e specializuar dhe e pavarur e gazit natyror, e krijuar, e organizuar dhe që funksionon sipas ligjeve në fuqi e që nuk është pjesë e një shoqërie të integruar vertikalisht.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga veprimtaritë e tjera në sektorin e gazit natyror.

4. Pavarësia e OST-së zbatohet dhe garantohet përmes ndarjes së OST-së, sipas nenit 36 të këtijligji.

5. OST-ja ushtron veprimtarinë në përputhje me licencën për transmetimin e gazit natyror, të dhënë nga ERE, sipas të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Licenca për transmetimin e gazit natyror mund të jepet vetëm për OST-në, e certifikuar në mënyrë të rregullt, sipas kërkesave të nenit 37 të këtij ligji.

6. Licenca për transmetimin e gazit natyror, e dhënë para miratimit të këtij ligji, që lejon shoqërinë e gazit natyror të kryejë dhe të përmbushë detyrat që lidhen me transmetimin e gazit natyror, konsiderohet si licencë e përkohshme, që autorizon ushtrimin e veprimtarisë së transmetimit, por në çdo rast nuk mund të zgjasë më vonë se 1 qershori 2016.

Ndarja e OST-së

1. Shoqëria e gazit natyror, e cila ka në pronësi sistemin e transmetimit, do të veprojë si OST. OST-ja pajiset me licencë për transmetimin e gazit natyror, siç është përcaktuar në pikën 5, të nenit 35, të këtij ligji.

2. Për të siguruar pavarësinë e OST-së, i njëjti person ose të njëjtët persona nuk kanë të drejtën që njëkohësisht:

a) të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një të licencuar, që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror e të energjisë elektrike, dhe të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen ose ndonjë të drejtë tjetër ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit apo rrjetit të transmetimit;

b) të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen apo të ushtrojnë ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror dhe të energjisë elektrike;

c) të emërojnë anëtarët e këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht Operatorin e Sistemit të Transmetimit apo rrjetin e transmetimit dhe, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen apo ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror dhe të energjisë elektrike;

ç) të jenë anëtarë të këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose furnizimit të energjisë elektrike e të gazit natyror dhe veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit.

3. Ndalimet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2, të këtij neni, zbatohen në mënyrë të veçantë për:

a) kompetencën për të ushtruar të drejtën e votës;

b) kompetencën për të emëruar anëtarët e këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë të licencuarin;

c) të drejtën e mbajtjes së një pjese të shumicës së aksioneve.

4. Detyrimi i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, konsiderohet se është përmbushur nëse dy ose më shumë shoqëri, të cilat kanë rrjetet e tyre të transmetimit, kanë krijuar një sipërmarrje të përbashkët, e cila vepron si një operator i sistemit të transmetimit në dy ose më shumë shtete. Asnjë shoqëri tjetër nuk mund të jetë pjesë e kësaj sipërmarrjeje të përbashkët, përveç rastit kur shoqëria është përcaktuar si operator i pavarur i sistemit të transmetimit dhe është certifikuar sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

5. Kur personi i përmendur në pikën 2, të këtij neni, është një organ publik që kontrollohet nga shteti, atëherë dy organe të veçanta publike që ushtrojnë kontroll, njëri mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe tjetri mbi të licencuarin që kryen funksionin e prodhimit ose të furnizimit të gazit natyror e të energjisë elektrike, do të konsiderohen sikur nuk janë i njëjti person.

6. Operatori i Sistemit të Transmetimit, i cili ka qenë pjesë e një shoqërie të integruar vertikalisht, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, merr masat që të mos përhapë apo të mos transferojë informacione të ndjeshme tregtare te njësitë e tjera të shoqërisë së mëparshme të integruar vertikalisht, që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror dhe të energjisë elektrike.

Neni 37

Certifikimi i OST-së

1. Para se të licencohet për kryerjen e veprimtarisë së operimit të sistemit të transmetimit, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të certifikohet sipas procedurës së përcaktuar në këtë ligj.

2. Shoqëria, pas plotësimit të kërkesave për ndarjen e OST-së, sipas nenit 36, të këtij ligji, njofton ERE-n me shkrim dhe dorëzon dokumentacionin e kërkuar, të dhënat dhe informacione që provojnë dhe justifikojnë pajtueshmërinë me ligjin. ERE përcakton kërkesat për aplikim për certifikim të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, përfshirë dokumentacionin e nevojshëm që provon përmbushjen e kushteve, sipas këtij ligji.

3. ERE merr një vendim lidhur me certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit brenda 4 muajve nga data e aplikimit dhe dorëzimit të të gjithë dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar nga OST-ja. Mbas mbarimit të kësaj periudhe, certifikimi do të konsiderohet se jepet i miratuar në heshtje.

4. ERE njofton Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për fillimin e procedurave për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe merr vendim brenda 2 muajve nga data e njoftimit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, duke marrë në konsideratë rekomandimet e tij.

5. Nëse vendimi i ERE-s është i ndryshëm nga rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ERE duhet të publikojë dhe të arsyetojë shkaqet e mospranimit të tyre, duke informuar sekretariatit për këtë vendim.

6. Në çdo kohë gjatë procedurës së certifikimit, ERE dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë mund të kërkojnë nga OST-ja dhe/ose shoqëritë e gazit natyror që ushtrojnë funksionet e prodhimit apo të furnizimit ndonjë informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre në bazë të këtij neni. ERE ruan konfidencialitetin e informacionit tregtar.

7. Vendimi përfundimtar i ERE-s për certifikimin e OST-së dhe materialet e lidhura me të, të parashikuara në këtë nen, publikohen në faqen e internetit të ERE-s.

8. Me kërkesë të veçantë të OST-së ose me iniciativën e ERE-s, procedura e certifikimit mund të pasohet me lëshimin e një licence të re për transmetimin e gazit natyror ose modifikimin e licencës ekzistuese, ashtu siç mund të kërkohej.

Neni 38

Certifikimi i OST-së së përjashtuar

1. Në rastet kur një infrastrukturë e re për transmetimin e gazit natyror është e përjashtuar nga fusha e zbatimit të nenit 36, të këtij ligji, në lidhje me ndarjen e pronësisë së OST-së, sipas parashikimeve të nenit 78, të këtij ligji, OST-ja e ngarkuar për operimin e infrastrukturës së re caktohet dhe certifikohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në vendimin përkatës për përjashtimin, duke përfshirë dhe modelin e treguar për ndarjen e OST-së.

2. ERE, pa rënë ndesh me nenin 37, të këtij ligji, miraton kriteret dhe kushtet për certifikimin e OST-së në rastet e

përmendura në pikën 1, të këtij neni, duke përfshirë kërkesat që duhen ndjekur në zbatimin e ndarjes së OST-së. Kriteret dhe kushtet e tilla do të përgatiten dhe do të miratohen rast pas rasti, duke marrë parasysh vendimin përkatës mbi përjashtimin për infrastrukturën e re.

Neni 39

Monitorimi i ndarjes së OST-së

1. ERE monitoron në mënyrë të vazhdueshme përputhshmërinë e OST-së në lidhje me kërkesat për pavarësinë e saj dhe ndarjen e pronësisë, të parashikuara në këtë ligj. ERE fillon procedurat e rivlerësimit të certifikimit për të garantuar përputhjen në rastet e mëposhtme:

a) pas njoftimit nga OST-ja, në përputhje me pikën 2 të këtij neni;

b) me nismën e tij, kur ka një dyshim të arsyeshëm se një ndryshim i planifikuar ndikon në të drejtat ose në kontrollin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe mund të çojë në shkelje të dispozitave mbi ndarjen dhe pavarësinë ose në rastet kur një shkelje e tillë mund të ketë ndodhur;

c) ka një kërkesë të arsyeshme nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

2. OST-ja njofton ERE-n kur planifikon të ndër marrë veprime që mund të kërkojnë një rivlerësim të përputhshmërisë së tij me kërkesat për pavarësi dhe ndarjen e OST-së.

3. ERE merr vendimin për respektimin nga OST-ja të kërkesave për pavarësinë dhe ndarjen, jo më vonë se katër muaj nga data e njoftimit përkatës nga ana e OST-së, apo marrjes së një kërkesë nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ose fillimit të një hetimi të bërë me iniciativën e vet.

4. Në rast se ERE konstaton se kërkesat për pavarësi dhe/ose ndarjen e OST-së janë shkelur, merr vendim që OST-ja të eliminojë këto shkelje brenda një periudhe të përcaktuar nga ERE, brenda së cilës OST-ja duhet të paraqesë dokumente ose informacione, ku provohet eliminimi i shkeljeve të konstatuara nga ERE.

5. Në përfundim të periudhës së përcaktuar për eliminimin e shkeljeve, ERE merr vendim përfundimtar për vlerësimin e përmbushjes së detyrimit, sipas pikës 4 të këtij neni. Deri në marrjen e vendimit nga ERE, OST-ja lejohet të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë ligj.

6. Procedura e rihapur e certifikimit zbatohet në përputhje me parashikimet e nenit 37 ose, sipas rastit, nenit 38 të këtij ligji.

7. Në rast të mospërmbushjes nga OST-ja të detyrimit për ndarjen, siç përcaktohet në nenin 36, të këtij ligji, ERE merr masa për heqjen e licencës së saj, dhe/ose vendosjen e masave administrative, sipas nenit 106 të këtij ligji. Në rast të heqjes së licencës për transmetimin e gazit natyror, ERE merr masa që transmetimi i gazit natyror të kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë, sipas kushteve të përcaktuara në rregulloren e licencimit, të miratuara nga ERE.

Neni 40

Certifikimi në raport me vendet e treta

1. Kur certifikimi kërkohet nga OST-ja, e cila kontrollohet nga një person ose persona, të cilët i përkasin një vendi të tretë apo vendeve të treta, ERE njofton Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. ERE njofton menjëherë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për marrjen e kontrollit të OST-së ose të sistemit të transmetimit nga një ose disa persona që vijnë nga vende të treta dhe që përfitojnë kontroll mbi OST-në.

2. Për qëllime të pikës 1 të këtij neni, OST-ja duhet të njoftojë ERE-n në lidhje me rrethanat që rezultojnë në marrjen e kontrollit të OST-së ose sistemit të transmetimit nga një person ose persona, të cilët vijnë nga një vend i tretë apo vende të treta që përfitojnë kontrollin mbi to.

3. Procedura e certifikimit, në lidhje me vendet e treta, zbatohet sipas kërkesave të nenit 37, të këtij ligji, dhe duke marrë parasysh kërkesat specifike të përcaktuara në këtë nen.

4. ERE refuzon kërkesën për certifikim në rast se:

a) Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk përmbush kërkesat për pavarësinë dhe ndarjen e përcaktuar në këtë ligj;

b) dhënia e certifikimit vë në rrezik sigurinë e furnizimit me energji të vendit apo vendeve anëtare të Komunitetit të Energjisë. Kur ERE gjykon mbi këtë bazë, merr parasysh:

i) të drejtat dhe detyrimet e Komunitetit të Energjisë në lidhje me atë vend të tretë, që rrjedhin sipas së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë të gjitha marrëveshjet e lidhura me një ose më shumë vende të treta, ku Komuniteti i Energjisë është palë dhe që adreson çështjet e sigurisë së furnizimit me energji;

ii) të drejtat dhe detyrimet e Shqipërisë, lidhur me atë vend të tretë, që rrjedhin nga marrëveshjet e lidhura me të, për aq sa ato janë në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë;

iii) të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga bashkimet apo marrëveshjet tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Europian;

iv) fakte të tjera specifike dhe rrethanat e rastit në lidhje me vendin e tretë në fjalë.

5. Ministria dhe/ose autoritetet e tjera kompetente shqiptare japin, me kërkesën e ERE-s, mendimin e tyre për çështjet e përmendura në pikën 4 të këtij neni.

6. Vendimi i ERE-s, në lidhje me certifikimin e OST-së ose refuzimin për të dhënë vërtetim, i njoftohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, pa vonesë, së bashku me të gjithë informacionin përkatës bashkëlidhur vendimit.

7. Vendimi përfundimtar mbi certifikimin e OST-së, në raport me vendet e treta, do të miratohet dhe do të publikohet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 37 të këtij ligji.

8. ERE, duke marrë në konsideratë mendimin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ka të drejtë të refuzojë certifikimin, në rast se vë në rrezik sigurinë e furnizimit në Shqipëri apo të çdo pale tjetër të Komunitetit të Energjisë ose kërcënon interesat e sigurisë publike në vend.

Neni 41

Përgjegjësitë e OST-së

1. OST-ja ka këto përgjegjësi kryesore:

a) ndërton, zotëron, operon, mirëmban dhe zhvillon në varësi të kushteve ekonomike një sistem të sigurt nga rreziqet dhe eficient të transmetimit të gazit natyror dhe siguron një treg konkurrent, si edhe kapacitete të mjaftueshme për të plotësuar kërkesën e arsyeshme për transmetim të gazit natyror në një territor të caktuar dhe mjete të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e shërbimit.

OST-ja, gjatë përmbushjes së detyrave të saj, respekton kërkesat e mbrojtjes në punë në sistemin e transportit, si dhe mbrojtjes së mjedisit, sipas legjislacionit në fuqi;

b) siguron shërbimin e transmetimit të gazit natyror, në përputhje me kushtet e licencës dhe me rregullat e ERE-s;

c) kryen balancimin e sistemit, mbështetur në parime objektive, transparente e jodiskriminuese, në përputhje me rregullat balancuese. Çmimet për ofrimin e shërbimeve të lidhura me balancimin do të përcaktohen në bazë të metodologjisë së miratuar nga ERE;

ç) siguron ofrimin e shërbimeve të sistemit në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese, në bazëtë parimit të kostos më të ulët dhe ndikimit mjedisor më të ulët;

d) ndërton kapacitete të mjaftueshme ndërkufitare për të integruar sistemin e transmetimit të gazit natyror të Shqipërisë me sistemin analog të vendeve anëtare të BE-së dhe palëve kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, duke përmbushur të gjitha kërkesat e nevojshme ekonomike dhe teknike të realizueshme për kapacitetin, si dhe duke marrë parasysh sigurinë e furnizimit me gaz;

dh) u siguron çdo operatori tjetër të sistemit të transmetimit, OSSH-së, operatorit të impiantit të depozitave, operatorit të impiantit të GNL-së, OST-së fqinje ose shoqërive të tjera të licencuara të gazit natyror informacion të mjaftueshëm, në mënyrë që transporti dhe depozitimi i gazit natyror të jenë në përputhje me mundësinë për të siguruar ndërveprimin e sigurt dhe eficient të sistemeve të ndërlidhura;

e) u siguron përdoruesve të sistemit informacion të hollësishëm, të kuptueshëm dhe të arritshëm për shërbimet e ofruara, kushtet e shërbimit dhe informacionin e nevojshëm teknik për përdoruesit errjetit, për t'u mundësuar një akses efektiv në rrjet, përfshirë, por pa kufizuar, kapacitetet teknike të kontraktuara dhe të disponueshme, në përputhje me informacionin konfidencial të përjashtimeve, të miratuar nga ERE;

ë) prokuron energji për kryerjen e funksioneve të tij, sipas procedurave transparente, jodiskriminuese dhe në përputhje me tregun;

f) ruan dhe vendos në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse të gjithë informacionin e përmendur në nenin 48, të këtij ligji, për një periudhë pesëvjeçare. Ky informacion duhet të vendoset në dispozicion edhe të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë;

g) ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm që të drejtat e kapaciteteve të jenë lirisht të tregtueshme, duke marrë masa që ky proces të kryhet në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese. OST-ja harton kontrata të harmonizuara të transportit dhe procedurat për tregun primar, me qëllim lehtësimin e tregut sekondar të kapaciteteve dhe pranimin e transferimit të të drejtave të kapaciteteve fillestare të njoftuara nga përdoruesit e sistemit. Këto kontrata të harmonizuara dhe procedura i njoftohen ERE-s;

gj) ruan konfidencialitetin e çdo informacioni të ndjeshëm tregtar.

2. OST-ja ushtron veprimtarinë në përputhje me standardet minimale teknike të miratuara nga ministria, për mirëmbajtjen, zhvillimin, inspektimin teknik të sistemit të transmetimit të gazit natyror dhe kapacitetin ndërlidhës.

Aksesi i palëve të treta në sistemin e transmetimit

1. OST-ja do të sigurojë akses të pakufizuar në sistemin e transmetimit, në përputhje me kushtete përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit. Në këtë drejtim OST-ja:

- a) ofron shërbimet e saj në mënyrë jodiskriminuese për të gjithë përdoruesit e rrjetit;
- b) siguron shërbime të qëndrueshme dhe të pandërprera në hyrje të palëve të treta. Çmimi i kapacitetit në ndërprerje pasqyrohet dhe mundësinë e ndërprerjes;
- c) u ofron përdoruesve të rrjetit shërbime afatgjata dhe afatshkurtra.

2. Në lidhje me shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, kur OST-ja u ofron të njëjtin shërbim klientëve të ndryshëm, atëherë duhet ta bëjë këtë sipas kriterëve dhe kushteve të njëjta kontraktuese, qoftë duke përdorur kontratat e harmonizuara të transportit dhe/ose në pajtim me Kodin e Rrjetit të Transmetimit, të miratuara nga ERE.

3. OST-ja publikon kushtet dhe detyrat e miratuara nga ERE, përfshirë rregullat dhe tarifën për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit. Këto kushte dhe detyrime zbatohen në mënyrë jodiskriminuese për të gjithë klientët.

4. Aksesi i shërbimeve të palëve të treta mund të jepet përkundërt garancive të përshtatshme nga përdoruesit e rrjetit, në lidhje me aftësinë kreditore të shfrytëzuesve. Të tilla garanci nuk duhet të përbëjnë pengesa të panevojshme për hyrjen në treg dhe do të jenë jodiskriminuese, transparente dhe proporcionale.

5. Kontratat e transportit të nënshkruara me data jostandarde fillimi ose me një kohëzgjatje më të shkurtër se një kontratë standarde vjetore e transportit, nuk do të rezultojnë në tarifa arbitrarisht më të larta apo më të ulëta dhe nuk do të pasqyrojnë vlerën e tregut të shërbimit, sipas parimeve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 33, të këtij ligji.

6. Lidhja e kontratave afatgjata lejohet për aq sa ato janë në përputhje me legjislacionin e konkurrencës, në përputhje me parashikimet e Traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë.

7. OST-ja me qëllim përmbushjen e funksioneve të saj, nëse është e nevojshme, hyn në marrëveshje dhe/ose kushte të tjera bashkëpunimi për pasjen e aksesit në sistemet e transmetimit të vendeve fqinje.

Refuzimi i të drejtave të aksesit

1. OST-ja mund të refuzojë aksesin në sistemin e transmetimit kur ka mungesë të kapaciteteve apo në rastet kur aksesin në sistem mund të pengojë kryerjen e detyrimeve të shërbimit publik, siç rregullohet me këtë ligj, ose në rast të vështirësive të mëdha ekonomike e financiare me kontratat “merr ose paguaj”, që kanë qenë efektive përpara kërkesës për akses në sistemin e transmetimit.

2. Çdo përdoruesi i rrjetit, të cilit i është refuzuar kërkesa për akses në sistemin e transmetimit, i jepen arsytet e një refuzimi të tillë nga OST-ja, në formë të shkruar, të cilat përgatiten dhe dorëzohen nga OST-ja pa ndonjë vonesë, pas marrjes së kërkesës për akses.

3. OST-ja, në rast të refuzimit të aksesit në sistemin e transmetimit, për arsye të mungesës së kapaciteteve apo mungesës së lidhjes, do të bëjë përmirësimet e nevojshme për aq sa është ekonomikisht e mundur nga ana e saj apo kur klienti potencial është i gatshëm për të paguar për përmirësime të tilla.

4. OST-ja nuk ka të drejtë të refuzojë lidhjen e një impianti të ri të depozitimit, impianti të rigazifikimit të GNL-së ose klienti industrial, në bazë të kufizimeve të mundshme që priten në të ardhmen për kapacitetet në dispozicion të rrjetit apo kostot shtesë të lidhura me rritjen e nevojshme të kapaciteteve. OST-ja do të sigurojë kapacitete të mjaftueshme për hyrje dhe dalje për lidhjet e reja.

5. Një përdorues i rrjetit, të cilit i është refuzuar aksesin në sistemin e transmetimit ose është i pakënaqur me kushtet e aksesit të tij në sistem, mund të paraqesë ankesë në ERE, sipas detyrimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin 98 të këtij ligji.

Kodi i Rrjetit të Transmetimit

1. Kodi i Rrjetit të Transmetimit miratohet nga ERE, me propozimin e OST-së, pas këshillimeve me pjesëtarët e tjerë të sektorit. OST-ja publikon kodin në një vend lehtësisht të arritshëm nga publiku dhe në faqen e saj elektronike.

2. Në Kodin e Rrjetit të Transmetimit duhet të përfshihen minimalisht:

a) kriteret, kushtet, hollësitë teknike dhe specifikimet minimale teknike për hyrjen e përdoruesvenë sistemin e transmetimit, përfshirë këtu shërbimet e aksesit të palës së tretë, të ofruara nga OST-ja, informacioni teknik i nevojshëm për përdoruesit e rrjetit për të fituar akses në sistemin e transmetimit, në caktimin e të gjitha pikave përkatëse, si dhe në publikimin e informacionit përkatës, në lidhje me kërkesat për transparencë dhe orarin e publikimit të informacionit;

b) metodat dhe kriteret për planifikimin dhe zhvillimin e sistemit;

c) kushtet dhe dokumentacioni i nevojshëm për aplikimin për akses në sistemin e transmetimit; ç) kushtete menaxhimit të pikave të hyrjes së gazit natyror në sistemin e transmetimit;

d) procesi i matjes dhe i përcaktimit të specifikimeve e të kushteve të cilësisë për pranimin e lëvrimin të gazit natyror;

dh) procedurat e alokimit të sasive të matura të gazit natyror për përdoruesit në pikat e hyrjes etë daljes së gazit natyror të sistemit;

e) planifikimin e mirëmbajtjen e sistemit të transmetimit dhe detyrimet përkatëse të OST-së e të përdoruesve të sistemit;

ë) procedurat për përgatitjen e planit të zhvillimit të sistemit të transmetimit dhe për monitorimin e kontrollin e zbatimit të tij, si dhe të gjitha hollësitë për zhvillimin e sistemit të transmetimit;

f) parimet e mekanizmave të shpërndarjes së kapaciteteve dhe procedurat e menaxhimit të kapacitetit të kufizuar që kanë të bëjnë me sistemin e transmetimit, si dhe afatet e kushtet për aplikimin e tyre në rast të kufizimit kontraktual;

g) kërkesat për sistemet e matjes dhe metodat e matjes së vëllimeve të gazit natyror të dorëzuar përmes sistemit të transmetimit, të cilat respektojnë rregullat e veçanta për sistemet e matjes dhe matjen, të miratuar nga ERE;

gj) kriteret, sipas të cilave furnizimi i klientëve mund të ndërpritet sipas prioritetit, për arsye të sigurisë së furnizimit;

h) procedurat për zgjidhjen jashtë sistemit gjyqësor të mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesvetë sistemit të transmetimit dhe OST-së;

i) rregullat për transaksionet e OST-së me përdoruesit e sistemit dhe, veçanërisht, llogaritë qëduhen mbajtur nga OST-ja për këtë qëllim;

j) të gjitha çështjet e tjera për menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit.

Neni 45

Parimet e mekanizmave të shpërndarjes së kapaciteteve dhe procedurat e menaxhimit të kapacitetit të kufizuar në OST

1. Kapaciteti maksimal në të gjitha pikat e sistemit, përfshirë edhe ato të hyrjeve e daljeve, vihen në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut, duke marrë parasysh integritetin e sistemit dhe funksionimin efikas të tij.

2. OST-ja zbaton dhe publikon mekanizma jodiskriminues dhe transparentë, në lidhje me shpërndarjen e kapaciteteve, të cilat:

a) japin sinjalet e duhura ekonomike për përdorimin efikas dhe maksimal të kapaciteteve teknike;

b) lehtësojnë investimet në infrastrukturën e re;

c) lehtësojnë procedurat e shkëmbimeve ndërkufitare me gaz natyror;

ç) janë në përputhje me mekanizmat e tregut, përfshirë tregjet e çastit dhe korridoret e tregimit, duke qenë fleksibël dhe të aftë për t'u përshtatur me rrethanat që lidhen me zhvillimet e tregut;

d) janë në përputhje me sistemet hyrëse në rrjetin e palëve të Komunitetit të Energjisë.

3. OST-ja zbaton dhe publikon procedurat e menaxhimit të kapacitetit të kufizuar, me qëllim lehtësimin e shkëmbimeve ndërkufitare të gazit natyror, që bazohen në parimet e mëposhtme:

a) në rast të kapacitetit të kufizuar, OST-ja ofron kapacitete të papërdorura në tregun primar, së paku ditën e mëpasshme, si dhe ofron furnizim të pandërprerë;

b) përdoruesit e rrjetit që dëshirojnë ta rishesin apo t'i nënkontraktojnë kapacitetet e papërdorura në tregun dytësor, në rast se janë të autorizuar, mund ta bëjnë këtë pasi të jenë njoftuar nga OST-ja për t'u furnizuar nga këta përdorues rrjeti dhe në përputhje me kushtet e detyrimet e përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

4. Në rast të kapacitetit të kufizuar aplikohen kushte jodiskriminuese, si dhe mekanizma transparentë të shpërndarjes së kapacitetit, që zbatohen nga OST-ja ose, sipas rastit, nga ERE.

5. OST-ja vlerëson në mënyrë të vazhdueshme kërkesën për kapacitete në treg lidhur me investime të reja. Kur planifikon investime të reja, OST-ja vlerëson kërkesat e tregut dhe merr në konsideratë sigurinë e furnizimit.

Neni 46

Zhvillimi i rrjetit dhe vendimet e investimeve

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, paraqet në ERE një plan dhjetëvjeçar zhvillimi të rrjetit të transmetimit, në bazë të kërkesës e të ofertës, icili rishikohet deri më 31 tetor të çdo viti, pasi të jetë konsultuar me të gjitha palët e interesuara dhe të jenë mbajtur parasysh parashikimi ekzistues dhe i planifikuar i kërkesë-ofertës. Plani i zhvillimit të rrjetit të transmetimit përmban masa efikase, në mënyrë që të garantojë përshtatshmërinë e rrjetit dhe sigurinë e furnizimit.

2. Plani i zhvillimit të rrjetit duhet:

a) të marrë në konsideratë informacionin për pjesëmarrësit e tregut të gazit natyror, si dhe informacionet për infrastrukturën kryesore të transmetimit që duhet të ndërtohet ose të përmirësohet gjatë 10 viteve të ardhshme;

b) të përmbajë të dhëna për të gjitha investimet e miratuara dhe të identifikojë investimet e reja, të cilat duhet të ekzekutohen në tri vitet e ardhshme;

c) të përcaktojë një afat kohor për të gjitha projektet e investimeve.

3. Në hartimin e planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit, OST-ja bën parashikime në lidhje me prodhimin, furnizimin, konsumin dhe shkëmbimin e gazit natyror me vendet e tjera, duke marrë parasysh planet e investimeve për rrjetet në vendet përreth, si dhe planet e investimeve për impiantet e depozitimit dhe rigasifikimit të GNL-së.

4. ERE konsultohet në mënyrë të hapur dhe transparente me të gjithë përdoruesit aktualë apo të mundshëm të sistemit lidhur me planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit. ERE boton rezultatin e procesit të konsultimit, veçanërisht nevojat e mundshme për investime.

5. ERE shqyrton planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit dhe, në rast se vëren se nuk janë përmbushur të gjitha nevojat e zhvillimit për investime të identifikuar gjatë procesit të konsultimit, kërkon nga Operatori i Sistemit të Transmetimit të plotësojë dhe/ose të ndryshojë planin e tij dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit.

6. ERE miraton, monitoron, si dhe vlerëson zbatimin e planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit.

7. Kur ERE konstaton se Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka realizuar për tri vite një investim të parashikuar, sipas planit dhjetëvjeçar, dhe gjykon se investimi është i nevojshëm e mundtë financohet pa penguar operimin normal të rrjetit, i kërkon atij të marrë një nga këto masa:

a) të realizojë investimin në fjalë;

b) të organizojë një procedurë konkurruese për realizimin e investimit në fjalë, të hapur ndaj çdo investitori;

c) të pranojë rritjen e kapitalit, me qëllim financimin e investimeve të nevojshme dhe të lejojë investitorët e pavarur për të marrë pjesë në kapitalin e shoqërisë.

8. Kur ERE merr masa, sipas shkronjës “b”, të pikës 7, të këtij neni, mund ta detyrojë Operatorin e Sistemit të Transmetimit të zbatojë një ose më shumë nga alternativat e mëposhtme:

a) të sigurojë financimin nga ndonjë palë e tretë;

b) të kërkojë ndërtimin nga ndonjë palë e tretë;

c) të ndërtojë vetë asetet e reja përkatëse brenda një afati të arsyeshëm; ç) t'i operojë asetet e reja pas ndërtimit.

9. OST-ja u siguron investitorëve të gjitha informacionet e nevojshme për të realizuar investimet dhe bën përpjekjet maksimale për të lehtësuar zbatimin e projektit të investimit. Marrëveshjet përkatëse financiare do t'i nënshtrohen miratimit nga ERE.

10. ERE, në ushtrimin e kompetencave të saj, sipas pikave 7 dhe 8, të këtij neni, merr mendimin nga ministria përgjegjëse për energjinë.

11. ERE merr masa që kostot e investimeve të mbulohen nga tarifat përkatëse dhe që investimet e përfunduara të merren në konsideratë gjatë miratimit të tarifave të vitit pasardhës.

12. ERE harton dhe miraton një rregullore për procedurat e paraqitjes e të miratimit të planeve të investimit.

Neni 47

Programet e përputshmërisë dhe zytari i përputshmërisë

1. OST-ja krijon një program të përputshmërisë, në të cilin përcaktohen masat e nevojshme përgarantimin e sjelljes jodiskriminuese, i cili miratohet nga ERE, si dhe metodën për monitorimin e përputshmërisë me këtë program. Programi i përputshmërisë përcakton detyrimet e veçanta për tëpunësuarit e OST-së, me qëllim plotësimin e këtyre objektivave. Përputshmëria me programin monitorohet në mënyrë të pavarur nga një zyrtar i përputshmërisë.

2. Zyrtari i përputshmërisë emërohet nga këshilli mbikëqyrës ose, nëse një organ i tillë nuk është formuar, nga organi kolektiv i menaxhimit të OST-së, pas miratimit paraprak nga ERE. ERE mund të refuzojë miratimin e zyrtarit të përputshmërisë vetëm për arsye të mungesës së pavarësisë apo kapaciteteve profesionale. Zyrtari i përputshmërisë mund të jetë një person fizik ose juridik, i pavarur në punën dhe veprimet e tij ose të saj.

3. ERE miraton kriteret dhe detyrat për pozicionin e zyrtarit të përputhshmërisë, si dhe afatin e qëndrimit në detyrë. Këto kriteret kanë qëllim të sigurojnë pavarësinë e zyrtarit të përputhshmërisë dhe burimet e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tij.

4. Gjatë ushtrimit të mandatit të tij, zyrtari i përputhshmërisë nuk mund të ketë asnjë detyrë tjetër profesionale dhe nuk lejohet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të kryejë ndonjë funksion apo të ketë pjesëmarrje në biznese ose të jetë partner biznesi me ndonjë pjesë të shoqërisë vertikalisht të integruar apo me shumicën e aksionarëve të saj.

5. Zyrtari i përputhshmërisë është përgjegjës për:

a) monitorimin e zbatimit të programit të përputhshmërisë;

b) përpunimin e një raporti vjetor, ku përcaktohen masat e marra për zbatimin e programit të përputhshmërisë dhe që dërgohet në ERE;

c) raportimin në organet përgjegjëse të OST-së dhe dhënien e rekomandimeve për programin e përputhshmërisë e zbatimin e tij;

ç) njoftimin e ERE-s për çfarëdo shkelje të konsiderueshme në lidhje me zbatimin e programit të përputhshmërisë;

d) raportimin në ERE-s për çdo marrëdhënie tregtare dhe financiare midis shoqërisë së integruar vertikalisht dhe OST-së.

6. Zyrtari i përputhshmërisë dorëzon në ERE propozimet për planin e investimeve apo të investimeve të veçanta në rrjet, pas miratimit nga OST-ja.

7. Zyrtari i përputhshmërisë raporton rregullisht në ERE dhe në organet përgjegjëse të OST-së me gojë ose me shkrim.

8. Zyrtari i përputhshmërisë mund të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e stafit menaxhues dhe organeve përgjegjëse të OST-së, duke përfshirë asamblenë e përgjithshme, organet mbikëqyrëse e menaxhuese, të cilat kanë detyrimin ta informojnë zyrtarin e përputhshmërisë për takimet e planifikuara dhe për t'i vënë në dispozicion të gjitha materialet e nevojshme. Zyrtari i përputhshmërisë merr pjesë në të gjitha takimet që adresojnë çështjet në vijim:

a) kushtet për hyrjen në rrjet dhe përdorimin e rrjetit të transmetimit, në veçanti në lidhje me çmimet për shfrytëzimin e rrjetit, shërbimet e lidhura të rrjetit për aksesin dhe përdorimin e rrjetit të transmetimit, e alokimin e kapaciteteve të transmetimit dhe menaxhimin e kapacitetit të kufizuar, transparencën, balancimin dhe tregjet dytësore;

b) projektet e ndërmarra për të menaxhuar sistemin e gazit natyror dhe për të mirëmbajtur e zhvilluar rrjetin e transmetimit, përfshirë investimet në linjat ndërkufitare të interkoneksionit dhe lidhjet;

c) blerjet ose shitjet e energjisë të nevojshme për operimin e sistemit të gazit natyror dhe të sistemit të transmetimit, përfshirë shërbimet ndihmëse dhe shërbimin ebalancimit.

9. Zyrtari i përputhshmërisë monitoron pajtueshmërinë e OST-së me dispozitat që rregullojnë konfidencialitetin e OST-së.

10. Zyrtari i përputhshmërisë ka akses, pa detyrim njoftimi paraprak, në të gjitha të dhënat përkatëse e në zyrat e OST-së dhe në të gjitha informacionet e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tij.

11. Këshilli mbikëqyrës ose, nëse ky organ nuk është krijuar ende, organi kolegjal imenaxhimit i OST-së mund të shkarkojë zyrtarin e përputhshmërisë, me miratimin paraprak të ERE-s. Zyrtari i përputhshmërisë mund të shkarkohet me kërkesë të ERE-s, për arsye të mungesës së pavarësisë apo kapaciteteve profesionale.

Neni 48

Kërkesat për transparencë

1. OST-ja publikon të gjithë informacionin e detajuar në lidhje me shërbimet që ofron dhe kushtet përkatëse për të aplikuar, së bashku me informacionin teknik të nevojshëm për përdoruesit e rrjetit për të fituar hyrjen efektive në rrjet.

2. OST-ja publikon në mënyrë të detajuar informacionin për llogaritjen e tarifave, metodologjinë dhe strukturën, me qëllim që këto tarifa të jenë transparente, objektive dhe jodiskriminuese.

3. Për shërbimet e ofruara, OST-ja bën publike informacionin mbi kapacitetet teknike, të kontraktuara dhe të disponueshme në vlera numerike për të gjitha pikat, përfshirë pikat e hyrjes e të daljes, në mënyrë lehtësisht të aksesueshme nga palët.

4. Pikat e sistemit të transmetimit, për të cilat informacioni bëhet publik, miratohen nga ERE paskonsultimit me përdoruesit e rrjetit.

5. OST-ja jep në çdo rast informacionin e kërkuar të parashikuar në këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore në mënyrë lehtësisht të aksesueshme nga palët.

6. OST-ja bën publike të dhënat rreth kërkesës dhe ofertës, sipas parashikimeve e prurjeve të realizuara brenda dhe jashtë sistemit. ERE monitoron përmbushjen e këtij detyrimi.

7. OST-ja bën publike masat e marra, si dhe shpenzimet e bëra e të ardhurat e krijuara për të balancuar sistemin.

8. Pjesëmarrësit e tregut i sigurojnë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të dhënat e përmendura në këtë nen, sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në rregulloren për dhënien e informacionit, të miratuar nga ERE.

Neni 49

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar i OST-së

1. OST-ja, në bashkëpunim me ERE-n, promovon dhe lehtëson, në veçanti, bashkëpunimin e operatorëve të sistemit të transmetimit në nivel rajonal, përfshirë edhe çështjet ndërkufitare, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues rajonal të gazit natyror, për nxitjen e qëndrueshmërisë, sipas kuadrit ligjor, rregullator e teknik, dhe lehtëson integrimin e sistemeve të izoluar, në formën e ishujve të gazit, integrim i cili duhet të jetë në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të marra përsipër nga Shqipëria.

2. OST-ja bashkëpunon me Bordin e Rregullatorit të Komunitetit të Energjisë dhe me autoritetet rregullatore e operatorët e sistemit të transmetimit të vendeve anëtare të BE-së dhe/ose të palëve të tjera të Komunitetit të Energjisë, sipas parashikimeve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi.

3. OST-ja, me miratimin paraprak të ERE-s, mund të marrë pjesë në veprimtarinë e një ose më shumë sistemeve të integruara, në nivelin e një ose më shumë rajoneve, që mbulon dy ose më shumë vende anëtare të BE-së dhe palë të Komunitetit të Energjisë për alokimin e kapaciteteve transmetuese dhe për kontrollin e sigurisë operative.

4. OST-ja nxit marrëveshjet operationale për të siguruar administrimin optimal të rrjetit në nivel rajonal dhe në kuadër të Komunitetit të Energjisë dhe zhvillimin e shkëmbimeve të gazit natyror, alokimin e koordinuar të kapacitetit ndërkufitar përmes zgjidhjes jodiskriminuese të bazuar në treg, duke i kushtuar vëmendjen e duhur ankandëve për alokimet afatshkurtra, si dhe integrimin e mekanizmave të balancimit e të rezervës.

SEKSIONI II

SHPËRNDARJA E GAZIT NATYROR

Neni 50

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)

1. Shpërndarja e gazit natyror kryhet nga operatorë të sistemit të shpërndarjes, të cilët janë persona juridikë, të licencuar nga ERE, sipas dispozitave të këtij ligji, për ushtrimin e veprimtarisë në një territor të caktuar.

2. Veprimtaria e OSSH-së është e pavarur nga veprimtaritë e tjera, që nuk lidhen me shpërndarjen, në drejtim të organizimit dhe vendimmarrjes.

3. OSSH-ja operon rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë ligj dhe me parimet e objektivitetit, të transparencës dhe mosdiskriminimit.

4. Asnjë shoqëri nuk ka të drejtë të zotërojë asete në fushën e shpërndarjes së gazit natyror në një territor të caktuar, pa marrë paraprakisht miratimin nga ERE.

Neni 51

Ndarja e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

1. Përveç kërkesave të pikës 2, të nenit 50, të këtij ligji, kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është pjesë e një shoqërie të integruar vertikalisht, ai është i pavarur, në aspektin e organizimit të tij dhe në marrjen e vendimeve, nga veprimtaritë e tjera që nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen.

2. Personat përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk do të marrin pjesë në strukturat e shoqërisë së integruar të gazit natyror përgjegjës, drejtpërdrejt apo tërthorazi, për operationet e zakonshme të prodhimit, transmetimit dhe furnizimit të gazit natyror.

3. OSSH-ja merr masat e duhura që interesat profesionalë të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të merren në konsideratë që të jenë të aftë për të vepruar në mënyrë të pavarur.

4. Nëse Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është pjesë e një shoqërie të integruar, me qëllim që të jetë i pavarur, në aspektin organizativ dhe të vendimmarrjes, nga aktivitetet e tjera që nuk lidhen me shpërndarjen e gazit natyror, ai duhet të ketë të drejta të plota vendimmarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar lidhur me asetet e nevojshme për funksionimin, mirëmbajtjen apo zhvillimin e

rrjetit të shpërndarjes. Për plotësimin e këtyre kushteve, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, përfshirë ato njerëzore, teknike, fizike dhe financiare. Shoqëria mëmë (kontrolluese), në përputhje me legjislacionin në fuqi, gëzon të drejta lidhur me mbikëqyrjen ekonomike, menaxhuese dhe vendimmarrëse për çështje, të cilat janë në kompetencën e saj. Shoqëria mëmë (kontrolluese) nuk mund të japë udhëzime për veprimtarinë e përditshme operacionale të sistemit të shpërndarjes së gazit natyror dhe as të marrë vendime të caktuara, lidhur me ndërtimin apo rikonstruksionin e linjave të shpërndarjes, vlera e investimit të cilave nuk tejkalon nivelet e planeve financiare të miratuara apo vlerat e përcaktuara në statutin e shoqërisë apo legjislacionin në fuqi; Operatori i Sistemit të Shpërndarjes harton programin e përputhshmërisë, ku parashikohen masat për të siguruar se sjellja diskriminuese është e përjashtuar dhe për të siguruar se respektimi i saj monitorohet në mënyrën e duhur. Programi i përputhshmërisë përcakton detyrimet e veçanta për të punësuarit për të përbushur këtë objektivi. Në raportin vjetor që publikohet përcaktohen masat e ndërmarra, të parashtruara nga personi apo organi përgjegjës për monitorimin e mbarëvajtjes së programit, zyrtari i përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe ERE. Zyrtari i përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes është plotësisht i pavarur dhe ka akses në të gjithë informacionin e nevojshëm të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe çdo shoqërie të lidhur për të përbushur detyrën e tij.

5. Veprimtaritë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes monitorohen nga ERE në mënyrë që operatori (OSSH) të mos përfitojë nga integrimi i tij vertikal dhe të shtrembërojë konkurrencën. Në veçanti, Operatori i Sistemit Shpërndarjes, i integruar vertikalisht, nuk mund të krijojë konfuzion në komunikimin dhe emrin tregtar, lidhur me identitetin e ndarë të degës së furnizimit të shoqërisë së integruar vertikalisht.

6. Kërkesat e përcaktuara në pikën 2, të nenit 50, të këtij ligji, nuk përbëjnë detyrim për ndarjen mbi pasuritë e sistemit të shpërndarjes nga shoqëria e integruar vertikalisht.

Neni 52

Përjashtimi nga përbushja e detyrimit të ndarjes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Në rastet kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ofron shërbim për më pak se 10 000 klientë, ai nuk i nënshtrohet përbushjes së detyrimeve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 50, dhe në nenin 51, të këtij ligji. Në këtë rast, në bazë të kërkesës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, pas marrjes së mendimit të ERE-s që konfirmon përbushjen e kushteve të përjashtimit, ministripërgjegjës i propozon Këshillit të Ministrave përjashtimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Neni 53

Detyrat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për të garantuar mundësinë afatgjatë të shpërndarjes në zonën e caktuar, si dhe është përgjegjës për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e një sistemi shpërndarjeje të sigurt, të qëndrueshëm, eficient, miqësor me mjedisin.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes siguron një shpërndarje të qëndrueshme dhe eficiente të gazit natyror, në përputhje me kushtet e licencës dhe me rregullat e ERE-s.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes lidh në rrjetin e shpërndarjes të gjithë klientët, bazuar në kushte jodiskriminuese, transparente, të parashikuara në rregulloret në fuqi, me kusht që sistemi i shpërndarjes të ketë kapacitet të mjaftueshëm dhe të plotësojë të gjitha kushtet e tjera teknike e tregtare.

4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes siguron akses jodiskriminues të të gjithë përdoruesve të sistemit në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, duke shmangur diskriminimin ndërmjet përdoruesve të sistemit ose kategorive të përdoruesve, sidomos në favor të shoqërive të lidhura me të.

5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes u siguron përdoruesve të sistemit informacion lehtësisht të aksesueshëm nga palët për shërbimet e ofruara, kushtet e shërbimit, si dhe një informacion të nevojshëm teknik për një akses efektiv në rrjet, në përputhje me përjashtimet nga informacioni konfidencial, të miratuar nga ERE.

6. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i siguron çdo operatori të sistemit informacionin e mjaftueshëm për të siguruar transportimin e depozitimin e gazit natyror dhe bërjen të mundur, në përputhje me operimin e sigurt dhe efikas të sistemit të interkoneksionit.

7. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes publikon kushtet dhe kriteret e miratuara nga ERE, përfshirë rregullat dhe tarifatat për sigurimin e shërbimeve të shpërndarjes.

8. Kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për balancimin e sistemit të shpërndarjes, rregullat e miratuara prej tij për këtë qëllim do të jenë objektive, transparente dhe jodiskriminuese, përfshirë këtu edhe rregullat për faturimin e përdoruesve për disbalancimin. Detyrimet dhe kushtet, përfshirë rregullat dhe tarifatat për sigurimin e

shërbimeve të tilla nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përcaktohen në bazë të një metodologjie të miratuar nga ERE në mënyrë jodiskriminuese dhe me kosto efektive, e cila publikohet.

9. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ruan konfidencialitetin e çdo informacioni tregtar në lidhje me përdoruesit, të marra këto gjatë veprimtarisë të tij, dhe parandalon përhapjen e informacionit sensitiv në mënyrë diskriminuese, që mund të krijojnë avantazhe tregtare në momentin që bëhen publike. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në shitjen ose blerjet e gazit natyror nga shoqëritë përgjegjëse, nuk duhet të abuzojë me informacionin tregtar të marrë nga palët e treta në dhënien apo negocimin e aksesit në sistem.

10. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për kryerjen e kontrollit teknik në objektet ku OSSH-ja bën shpërndarjen e gazit natyror, në mënyrë që të garantojë se ato operojnë në përputhje me rregullat teknike në fuqi.

Neni 54

Aksesi i palëve të treta në sistemin e shpërndarjes

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes siguron akses në sistemin e shpërndarjes, brenda kufijve të kapaciteteve të shpërndarjes dhe rregullave teknike, në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes, të miratuar nga ERE.

2. Kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes u ofron të njëjtin shërbim klientëve të ndryshëm, atëherë ky shërbim ofrohet sipas kriteve të njëjta dhe kushteve kontraktuese, qoftë duke përdorur kontratat e harmonizuara dhe/ose në pajtim me Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes publikon kushtet dhe kriteret e miratuara nga ERE, përfshirë rregullat, garancitë dhe tarifatat për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e shpërndarjes. Këto kushte dhe rregulla zbatohen në mënyrë objektive për të gjithë klientët dhe pa diskriminim ndërmjet përdoruesve të rrjetit.

4. Shërbimet e aksesit të palës së tretë jepen përkundrejt garancive nga përdoruesit e rrjetit për aftësinë financiare. Të tilla garanci nuk duhet të përbëjnë pengesa të panevojshme për hyrjen në treg dhe duhet të jenë jodiskriminuese, transparente dhe proporcionale.

5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të refuzojë aksesin në sistemin e shpërndarjes, në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në nenin 43 të këtij ligji.

Neni 55

Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes

1. Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes miratohet nga ERE, me propozimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, i cili bashkëpunon me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të gazit natyror dhe partnerët socialë, me qëllim hartimin, rishikimin apo përshtatjen e tij. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes publikon kodin në një vend lehtësisht të aksesueshëm dhe në faqen e tij elektronike.

2. Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes përmban rregullat për menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, si aplikimin për hyrje në rrjetin e shpërndarjes, parapagimin për hyrjen në rrjet, nëse ekziston, matjen, faturimin, si ndryshohet një furnizues, si përfundohet një kontratë, forca madhore, si dhe kërkesat për sistemet e matjes e metodat e matjes së vëllimeve të gazit natyror, të dorëzuara përmes sistemit të shpërndarjes, në zbatim të rregullave specifike për sistemet e matjes dhe matjen, të miratuara nga ERE, si dhe dispozitave të tjera përkatëse.

Neni 56

Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes dhe i planit të investimeve

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes harton planin e zhvillimit dhe investimeve të rrjetit, me qëllim garantimin e sigurisë, besueshmërisë, rregullsisë dhe cilësisë së furnizimit në sistemin e shpërndarjes. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në hartimin e planeve të zhvillimit dhe investimeve merr në konsideratë dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe të efikasitetit të energjisë.

2. Plani i zhvillimit dhe investimeve i rrjetit të shpërndarjes hartohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes për 10 vjet dhe do të përshtatet çdo vit për 10 vitet e ardhshme. Plani i zhvillimit dhe i investimeve do të përmbajë tregues afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Treguesit afatshkurtër dotë mbulojnë një periudhë prej 3 vjetësh, ato afatmesëm për një periudhë prej 6 vjetësh dhe ato afatgjatë një periudhë prej 10 vjetësh.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes paraqet për miratim planet e zhvillimit dhe të investimeve në ERE. ERE mund të konsultohet me autoritetet e përfshira, institucione të tjera shtetërore, shoqëritë gazit natyror dhe përdorues efektivë ose të mundshëm të rrjetit dhe, në rast të tillë, publikon rezultatin e procesit të konsultimit. ERE shqyrton veçanërisht, nëse

investimet që janë të parashikuara janë të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha nevojat që kanë dalë gjatë procesit të konsultimit.

4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes vë në zbatim planin e zhvillimit dhe të investimit brenda 30 ditëve nga data e miratimit të ERE-s. Në rast se ERE mendon se plani i zhvillimit dhe i investimeve nuk mundëson zbatimin e detyrimeve të saj ligjore nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, ajo do të kërkojë nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes që të rregullojë një situatë të tillë brenda një periudhë kohore të përcaktuar nga ERE.

5. Çdo vit Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, pas miratimit të planeve të zhvillimit dhe të investimeve, dërgon përmbledhëse të planit tek Operatori i Sistemit të Transmetimit, në mënyrë që ai të bëjë reflektimet e nevojshme në planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.

SEKSIONI III

PRODHIMI I GAZIT NATYROR

Neni 57

Prodhuesit

1. Çdo person i angazhuar në veprimtarinë e prodhimit të gazit natyror është subjekt i ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (Kërkim dhe prodhim)”, të ndryshuar. Këto subjekte i nënshtrohen parashikimeve të këtij ligji, në rast se kryejnë një veprimtari në sektorin e gazit natyror, të ndryshme nga prodhimi.

2. Prodhuesit, që kanë nënshkruar një marrëveshje hidrokarbure, sipas dispozitave të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (Kërkim dhe prodhim)”, të ndryshuar, mund të kërkojnë të lidhen me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes së gazit natyror, në përputhje me kushtet dhe standardet teknike, të përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Transmetimit ose në Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes së gazit natyror. Shpenzimet për këto lidhje përballohen nga prodhuesi.

3. Prodhuesit mund të ndërtojnë linja direkte për të përmbushur nevojat vetjake ose për të furnizuar një apo më shumë klientë.

Neni 58

Aksesi në rrjetet e gazsjellësve në zonat e kërkim - prodhimit të gazit natyror

1. Përdoruesit e gazit natyror, përfitojnë akses në rrjetet e gazsjellësve në zonat e kërkim - prodhimit të gazit natyror, si dhe në pajisjet që ofrojnë shërbime teknike të rastësishme për akses të tillë, përveç pjesëve të këtyre rrjeteve dhe objekteve, të cilat përdoren për operacionet e prodhimit vendas në vendet ku ndodhet vendburimi i prodhimit të gazit.

2. Kushtet e përgjithshme për akses në rrjetet e gazsjellësve të kërkim - prodhimit të gazit natyror përcaktohen sipas ligjit nr.7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (Kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar. Ministri miraton kushtet e përgjithshme për akses në rrjetet e gazsjellësve në veprimtaritë e kërkim - prodhimit. Në miratimin e këtyre kushteve të përgjithshme, ministri mban parasysh:

- a) mungesën e kapaciteteve;
- b) moskoordinimin e veçorive teknike të sistemit;
- c) nëse aksesit në sistem mund të rrezikojë prodhimin e naftës dhe gazit natyror;
- ç) nëse aksesit në sistem mund të rrezikojë të drejtat e përdoruesve të tjerë të sistemit.

Këto kushte, pas miratimit nga Ministri, i njoftohen Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

3. Aksesi në rrjetet e gazsjellësve të kërkim - prodhimit lejohet në përputhje me parimet e transparencës e të mosdiskriminimit dhe është një veprimtari e parregulluar.

SEKSIONI IV

DEPOZITIMI I GAZIT NATYROR

Neni 59

Operatori i Sistemit të Depozitimit

1. Operimi i impianteve të depozitimit të gazit natyror kryhet nga operatorët e sistemit të depozitimit, të cilët janë persona juridikë, të licencuar nga ERE, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Bazuar në kriterin e efikasitetit dhe leverdisë ekonomike, ERE mund të licencojë një ose më shumë operatorë të depozitimit.

Neni 60

Ndarja e Operatorit të Sistemit të Depozitimit

1. Operatori i Sistemi të Depozitimit, që është pjesë e një shoqërie të integruar vertikalisht, ushtron veprimtarinë i pavarur nga veprimtaritë e tjera që nuk lidhen me transmetimin, shpërndarjen dhe depozitimin, të paktën për sa i përket formës së tij juridike, organizimit dhe vendimmarrjes.

2. Për të siguruar pavarësinë e Operatorit të Sistemit të Depozitimit, të përmendur në pikën 1, të këtij neni, zbatohen kriteret minimale, si më poshtë:

a) personat përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Depozitimit nuk marrin pjesë në strukturat e shoqërisë së integruar të gazit natyror përgjegjëse, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, në funksionimin e përditshëm të prodhimit dhe furnizimit të gazit natyror;

b) marrjen e masave të duhura, që interesat profesionalë të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Depozitimit të merren në konsideratë, me qëllim që të jenë të aftë për të vepruar në mënyrë të pavarur;

c) operatori i rrjetit të depozitimit të ketë të drejta efektive të vendimmarrjes, të pavarura nga shoqëria e integruar e gazit natyror, në lidhje me asetet e domosdoshme për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e impianteve të depozitimit. Kjo nuk përjashton ekzistencën e mekanizmave të nevojshëm koordinues për të siguruar që të drejtat e mbikëqyrjes ekonomike dhe të menaxhimit të shoqërisë mëmë, në lidhje me kthimin mbi asetet e Operatorit të Sistemit të Depozitimit, janë të mbrojtura. Në veçanti kjo do t'i mundësojë shoqërisë mëmë që ta miratojë planin vjetor financiar apo ndonjë instrument tjetër të ngjashëm të Operatorit të Sistemit të Depozitimit dhe të përcaktojë kufijtë e përgjithshëm mbi nivelet e detyrimeve të degës së saj. Kjo nuk i lejon shoqërisë mëmë që të ofrojë udhëzime në lidhje me operacionet e përditshme dhe as në lidhje me vendimet individuale për ndërtimin apo përmirësimin e impianteve të depozitimit, të cilat nuk tejkalojnë kushtet e planit të miratuar financiar apo ndonjë instrument ekuivalent;

ç) Operatori i Sistemit të Depozitimit krijon programin e përputhshmërisë, që parashikon masat për përjashtimin e sjelljes diskriminuese dhe sigurimin se respektimi i saj monitorohet në mënyrë korrekte. Programi i përputhshmërisë përcakton detyrimet e veçanta të të punësuarve me qëllim përmbushjen e këtij objekti. Një raport vjetor, që përcakton masat e ndërmarra, dërgohet në ERE nga personi apo organi përgjegjës për monitorimin e programit të përputhshmërisë, i cili botohet.

3. Ky nen zbatohet vetëm për impiantet e depozitimit që janë teknikisht dhe/ose ekonomikisht të nevojshme për sigurimin e aksesit efektiv në sistem për furnizimin e klientëve, sipas nenit 63 të këtij ligji.

Neni 61

Detyrat e Operatorit të Sistemit të Depozitimit

Operatori i Sistemit të Depozitimit ka për detyrë:

a) të operojë, të monitorojë, të mirëmbajë dhe të zhvillojë, në kushte ekonomike, impiante të depozitimit të sigurta, të besueshme dhe efikase, për të siguruar një treg të hapur, duke marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit, si dhe të garantojë mjetet e mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e shërbimit;

b) të kufizojë diskriminimin midis përdoruesve apo kategorive të përdoruesve të sistemit, veçanërisht në favor të shoqërive të lidhura;

c) t'i sigurojë çdo operator të sistemit informacion të mjaftueshëm, për të garantuar që transportimi dhe depozitimi i gazit natyror të bëhet në përputhje me operimin e sigurt dhe eficient të sistemeve të ndërlidhura;

ç) të sigurojë informacionin e nevojshëm për akses efikas në impiantet e depozitimit për përdoruesit e sistemit;

d) të mbajë, në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse, të gjithë informacionin e referuar në nenin 58, të këtij ligji, për një periudhë prej 5 vjetësh. Ky informacion i vihet në dispozicion edhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë;

dh) të marrë masat e nevojshme për të lejuar që kapacitetet të jenë, lirisht, të tregtueshme dhe të lehtësojë tregtinë në një mënyrë transparente dhe jodiskriminuese;

e) të hartojë kontrata dhe procedura të harmonizuara të impianteve të depozitimit, në tregun primar, me qëllim lehtësimin e tregtisë sekondare të kapaciteteve, dhe të pranojë transferimin e të drejtave të kapaciteteve fillestare, kur është njoftuar nga përdoruesit e sistemit. Këto kontrata dhe procedura të harmonizuara i bëhen me dije ERE-s.

Veprimtaria e depozitimit

1. Operatori i Sistemit të Depozitimit ka në zotërim hapësira depozituese të gazit natyror, sipas marrëveshjes hidrokarbure, të lidhur në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (Kërkim dhe prodhim)”, të ndryshuar, ose çdo forme tjetër të parashikuar me ligj.

2. Operatori i Sistemit të Depozitimit administron këto hapësira depozituese në mënyrë të koordinuar dhe të integruar, për të garantuar funksionimin optimal të tyre dhe sigurinë e sistemit të gazit natyror.

Organizimi i aksesit në objektet e depozitimit dhe *linepack*

1. Për organizimin e aksesit në impiantet e depozitimit dhe *linepack*, kur është teknikisht dhe/ose ekonomikisht e nevojshme për sigurimin e aksesit efektiv në sistem, me qëllim furnizimin e klientëve, si dhe për organizimin e aksesit në shërbimet ndihmëse, zbatohet procedura e negociuar dhe/ose e rregulluar e aksesit.

2. ERE përcakton dhe publikon kriteret, sipas të cilave përcaktohet procedura e aplikueshme, për aksesin në hapësirat e depozitimit dhe *linepack*. Këto procedura zbatohen në përputhje me kriteret objektive, transparente dhe jodiskriminuese.

3. Operatori i Sistemit të Depozitimit njofton, publikisht, për impiantet ose pjesë të impianteve të depozitimit që janë objekt i aksesit. OST-ja, gjithashtu, publikon *linepack*-et që janë të ofrueshme, sipas procedurave të ndryshme të aksesit në to.

4. Dispozitat e mësipërme të këtij neni nuk zbatohen për shërbimet ndihmëse dhe depozitimet e përkohshme, të lidhura me impiantet e GNL-së, dhe që janë të nevojshme për procesin e rigazifikimit dhe dërgimin e mëtejshëm në sistemin e transmetimit.

5. Në rastin e aksesit të negociuar, ERE merr masat e nevojshme që shoqëritë e gazit natyror dhe klientët, brenda apo jashtë territorit që mbulon sistemi i ndërlidhur, të negociojnë akses në impiantet e depozitimit dhe *linepack*, kur teknikisht dhe/ose ekonomikisht është e nevojshme për të siguruar akses efikas në sistem, si dhe për organizimin e aksesit në shërbime të tjera ndihmëse. Palëtjanë të detyruara për të negociuar në mirëbesim aksesin në depozitim, *linepack* dhe shërbime të tjerandihmëse.

6. Kontratat për akses në depozitim, *linepack* dhe shërbime tjera ndihmëse negociohen me operatorin përkatës të sistemit të depozitimit ose shoqërinë përkatëse të gazit natyror. Operatori i Sistemit të Depozitimit dhe shoqëritë e gazit natyror publikojnë dhe përditësojnë vazhdimisht, së paku, një herë në vit, kushtet e tyre kryesore tregtare, për përdorimin e depozitimit, *linepack*-ut dhe shërbimeve të tjera ndihmëse. Në rast të përmirësimit të kushteve të tyre tregtare, të përmendura më sipër, Operatori i Sistemit të Depozitimit dhe shoqëritë e gazit natyror konsultohen me përdoruesit e sistemit.

7. Në rastin e aksesit të rregulluar, ERE merr masat e nevojshme për t'u dhënë shoqërive të gazit natyror dhe klientëve, brenda ose jashtë territorit që mbulon sistemi i ndërlidhur, të drejtën e aksesit në depozitim, *linepack* dhe shërbime të tjera ndihmëse, në bazë të tarifave të publikuara dhe/ose afateve e detyrimeve të tjera, për përdorimin e këtij depozitimi dhe *linepack*-u, kur është teknikisht dhe/ose ekonomikisht e nevojshme për sigurimin e aksesit efikas në sistem, si dhe për organizimin e aksesit në shërbime të tjera ndihmëse. ERE konsultohet me përdoruesit e sistemit për zhvillimin e metodologjisë për këto tarifa. E drejta e aksesit në klientët mund të jepet duke u mundësuar atyre hyrje në kontrata furnizimi me shoqëritë e gazit natyror, të ndryshme nga pronari dhe/ose operatorin e sistemit apo të një shoqërie të lidhur me to.

Aksesi i palës së tretë në lidhje me impiantet e depozitimit

1. Operatori i Sistemit të Depozitimit:

a) ofron shërbime në mënyrë jodiskriminuese për të gjithë përdoruesit e rrjetit që përmbushin kërkesat e tregut. Në veçanti, kur ky operator u ofron të njëjtin shërbim klientëve të ndryshëm, atëherë ai duhet ta bëjë këtë sipas kushteve kontraktuese të njëjta;

b) ofron shërbime që janë në përputhje me përdorimin e sistemeve të ndërlidhura të transportit të gazit dhe lehtëson aksesin nëpërmjet bashkëpunimit me OST-në;

c) bën publik informacionin përkatës, në veçanti të dhënat mbi përdorimin dhe disponueshmërinë e shërbimeve, sipas një afati, në përputhje me nevojat e arsyeshme tregtare të përdoruesve të impiantit të depozitimit dhe që janë subjekt

monitorimi nga ERE;

ç) u siguron akses, në mënyrë konstante dhe të pandërprerë, palëve të treta. Çmimi i kapacitetit të ndërprerjes pasqyron mundësinë e ndërprerjes;

d) ofron kontrata, për përdoruesit e impiantit të depozitimit, që mund të jenë afatgjata dhe afatshkurtra;

dh) ofron, për përdoruesit e impiantit të depozitimit, shërbime të ndara dhe të pandara të hapësirës së depozitimit, injektimit dhe shpërndarjes.

2. Kontratat e impiantit të depozitimit nuk duhet të rezultojnë me tarifa, arbitrarisht, më të larta nga ato që janë firmosur:

a) përtej një kontrate njëvjeçare të gazit natyror, pa datë të fiksuar të fillimit;

b) për një kohëzgjatje më të shkurtër se një kontratë njëvjeçare standarde GNL-je dhe impianti depozitimi.

3. Kur shihet e arsyeshme, shërbimet e aksesit të palës së tretë jepen përkundrejt garancive nga përdoruesit e rrjetit, duke dëshmuar aftësinë financiare. Këto garanci miratohen nga ERE dhe nuk duhet të përbëjnë pengesa të panevojshme për hyrjen në treg dhe duhet të jenë jodiskriminuese, transparente e proporcionale.

4. Operatori i Sistemit të Depozitimit mund të refuzojë aksesin në impiantin e depozitimit, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 43 të këtij ligji.

Neni 65

Parimet e mekanizmave të alokimit të kapaciteteve dhe procedurat e menaxhimit të kapacitetit të kufizuar, në lidhje me objektet e depozitimit

1. Kapaciteti maksimal i impiantit të depozitimit është në dispozicion për pjesëmarrësit e tregut, duke marrë në konsideratë integritetin e sistemit dhe operimin e tij.

2. Operatori i Sistemit të Depozitimit zbaton dhe publikon mekanizma të alokimit të kapaciteteve në mënyrë jodiskriminuese dhe transparente, të cilat:

a) japin sinjalet e duhura ekonomike për përdorimin efikas dhe maksimal të kapaciteteve dhe lehtësojnë investimet në infrastrukturën e re;

b) janë në përputhje me mekanizmin e tregut, duke përfshirë tregjet e çastit dhe korridoret e tregtimit, duke qenë fleksibël dhe të aftë për t'u përshtatur me rrethanat në zhvillim të tregut;

c) janë në përputhje me sistemet e lidhura të rrjetit të aksesit.

3. Kontratat me impiantet e depozitimit duhet të përfshijnë edhe masat për të parandaluar grumbullimin e kapaciteteve, me qëllim rishitjen në të ardhmen me një çmim abuziv, duke marrë parasysh parimet që zbatohen në rastet e menaxhimit të kapacitetit të kufizuar si më poshtë:

a) Operatori i Sistemit të Depozitimit ofron kapacitetin e papërdorur në tregun fillestar, pa vonesë;

b) përdoruesit e objektit të depozitimit, të cilët dëshirojnë të rishesin, në tregun dytësor, kapacitetin e kontraktuar, duhet, fillimisht, të kenë të drejtë për ta bërë këtë.

4. Për qëllime të shkronjës "a", të pikës 3, të këtij neni, oferta përkatëse nga Operatori i Sistemit të Depozitimit paraqitet, së paku, një ditë përpara dhe duhet të jetë e ndërprerë.

Neni 66

Kërkesat për transparencë në lidhje me impiantet e depozitimit

1. Operatori i Sistemit të Depozitimit bën publik informacionin e plotë, në lidhje me shërbimet që ofron dhe kushtet përkatëse që zbatohen, për përdoruesit e impiantit të depozitimit, në mënyrë që të sigurohet akses eficient në impiantet e depozitimit.

2. Operatori i Sistemit të Depozitimit bën publik informacionin lidhur me kapacitetet e kontraktuara dhe kapacitetet e disponueshme të depozitimit, i cili ofrohet në një formë të qartë dhe të kuptueshme për palët e interesuara.

3. Operatori i Sistemit të Depozitimit paraqet informacionin në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, në një mënyrë lehtësisht të aksesueshme nga palët.

4. Operatori i Sistemit të Depozitimit bën publik informacionin për sasinë e gazit në çdo impiant depozitimi, ose në grupet e impianteve të depozitimit, rrjedhat hyrëse dhe rrjedhat dalëse, si dhe kapacitetet e impiantit të depozitimit në dispozicion, përfshirë këtu edhe ato impiante të përfshijtura nga aksesit për palët e treta. Ky informacion i njoftohet, gjithashtu, edhe OST-së, e cila publikon informacionin, në mënyrë të përmblodhur për sistemin apo nënsistemin, të përcaktuara nga pikat përkatëse. Ky informacion rifreskohet periodikisht.

5. Në rastet kur Operatori i Sistemit të Depozitimit është i vetmi përdorues i impiantit të depozitimit, ai mund të paraqesë një kërkesë të arsyetuar në ERE për trajtim konfidencial të të dhënave të përmendura në pikën 4 të këtij neni.

Kur ERE arrin në përfundimin se një kërkesë e tillë është e justifikuar, mund të lejojë që Operatori i Sistemit të Depozitimit të mos bëjë publike të dhënat e përmendura në pikën 4, të këtij neni, për një kohëzgjatje deri në 1 vit nga miratimi i kërkesës.

6. Pika 5, e këtij neni, zbatohet pa paragjykuar detyrimet e publikimit të informacionit nga ana e OST-së, siç përmendet në pikën 4, përveçse kur të dhënat e përmbledhura janë identike me të dhënat individuale të sistemit të depozitimit, për të cilat ERE ka vendosur të mos jenë objekt publikimi.

7. Për të siguruar tarifa transparente, objektive e jodiskriminuese dhe për të lehtësuar përdorimin efikas të infrastrukturës, Operatori i Sistemit të Depozitimit bën publik, në mënyrë të mjaftueshme, informacionin e detajuar, në lidhje me përlogaritjen e tarifave, metodologjitë dhe strukturën e tarifave për infrastrukturën, sipas aksesit të rregulluar të palëve të treta.

Neni 67

Rregullat e përdorimit të sistemit të depozitimit të gazit

1. Rregullat e përdorimit të sistemit të depozitimit të gazit përcaktojnë zhvillimin, menaxhimin dhe përdorimin e këtij sistemi.

2. Rregullat e përdorimit të sistemit të depozitimit të gazit, në veçanti, parashikojnë:

- a) përshkrimin e sistemit të depozitimit të gazit;
- b) zhvillimin, ndërtimin e mirëmbajtjen e sistemit të depozitimit të gazit;
- c) menaxhimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të depozitimit të gazit;
- ç) marrëdhëniet kontraktuale dhe kushtet e përgjithshme për përdorimin e sistemit të depozitimit të gazit;
- d) rezervimin dhe përdorimin e kapaciteteve në sistemin e depozitimit të gazit; dh) tregtimin e kapaciteteve të sistemit të depozitimit të gazit;
- e) të drejtat dhe detyrimet e operatorit e përdoruesit të sistemit të depozitimit të gazit; ë) rregullat e matjes dhe rregullat e shpërndarjes;
- f) publikimin e të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit;
- g) lidhjen me pjesët e tjera të sistemit të gazit; gj) kompensimin e dëmeve.

3. Në procesin e hartimit të rregullave të përdorimit të sistemit të depozitimit të gazit, Operatori i Sistemit të Depozitimit siguron pjesëmarrje të të gjitha palëve të interesuara dhe kryen njëkonsultim publik, për një periudhë jo më pak se 15 ditë. Rregullat e përdorimit të sistemit të depozitimit të gazit zbatohen nga Operatori i Sistemit të Depozitimit pas miratimit të ERE-s, dhe publikohen në faqet e internetit të ERE-s dhe të operatorit të sistemit të depozitimit të gazit.

SEKSIONI V

OPERIMI I IMPIANTEVE TË GNL-së

Neni 68

Operatori i Sistemit të Impiantit të GNL-së

1. Operimi i sistemeve të GNL-së kryhet nga operatorët e sistemit të GNL-së, të cilët janë persona juridikë, të licencuar nga ERE, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Nisur nga kriteri i efikasitetit dhe bilancit ekonomik, mund të ketë një ose më shumë operatorë të GNL-së.

Neni 69

Detyrat e Operatorit të Sistemit të Impiantit të GNL-së

Operatori i Sistemit të Impiantit të GNL-së ka këto detyra:

- a) operon, mirëmban e zhvillon një impiant GNL-je të sigurt, të qëndrueshëm dhe eficient, për të siguruar një treg të hapur, duke marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit, si dhe garanton mjete të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e shërbimit;
- b) merr miratimin për përdorimin e impianteve ekzistuese të sistemit, në përputhje me nenin 11 të këtij ligji;
- c) lidh impiantin e GNL-së me sistemin e transmetimit, në përputhje me rregullat teknike të sistemit të transmetimit dhe me rregullat për përdorimin e impianteve të GNL-së;
- ç) vendos një sistem matës të rrjedhave hyrëse dhe dalëse, si dhe të parametrave të cilësisë së gazit;

- d) shkarkon dhe rigazifikon GNL-në, sipas kontratave të nënshkruara;
- dh) siguron kushte objektive, të njëjta dhe jodiskriminuese, për akses në impiantin e GNL-së, sipas dispozitave të këtij ligji dhe kushteve të përgjithshme të furnizimit me gaz natyror, të miratuara nga ERE, sipas neneve 16 e 75 të këtij ligji;
- e) kufizon diskriminimin ndërmjet përdoruesve ose grupeve të përdoruesve të sistemit, sidomos kur ky diskriminim favorizon shoqëritë e lidhura;
- ë) përgatit një plan pesëvjeçar për zhvillimin e impiantit të GNL-së, të cilin e publikon, e përditëson çdo vit dhe e paraqet për miratim në ERE;
- f) i siguron çdo operatori tjetër të sistemit informacion të mjaftueshëm, për të garantuar që transportimi dhe depozitimi i gazit natyror të bëhen në përputhje me operimin e sigurt dhe eficient të sistemeve të ndërlidhura;
- g) siguron, paraprakisht, brenda një afati të arsyeshëm, informacion të rregullt për pjesëmarrësit e tregut të gazit, për vëllimin dhe datën e mbylljes së operimit të impiantit të GNL-së dhe reduktimin e pritshëm të kapaciteteve të impiantit të GNL-së;
- gj) mbron informacionin konfidencial, me natyrë tregtare, të marrë gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
- h) vë në dispozicion të gjithë informacionin, në përputhje me nenin 73, të këtij ligji, për një periudhë prej 5 vjetësh, për ERE-n, ministrinë, Autoritetin e Konkurrencës, si dhe çdo autoritet tjetër përgjegjës. Ky informacion i vihet në dispozicion Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë;
- i) merr masa të arsyeshme për të lejuar që të drejtat e kapaciteteve të jenë lirisht të tregtueshme, për të lehtësuar që ky proces të kryhet në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese;
- j) nxit lidhjen e kontratave dhe procedurave të harmonizuara me impiante GNL-je për tregun primar, për të lehtësuar tregun sekondar të kapaciteteve, dhe lejon njohjen e transferimit të të drejtave të kapacitetit fillestar, kur kjo është njoftuar nga përdoruesit e sistemit. Këto kontrata dhe procedura të harmonizuara i bëhen me dije ERE-s.

Neni 70

Të drejtat e Operatorit të Sistemit të Impiantit të GNL-së

Operatori i Sistemit të Impiantit të GNL-së ka të drejtë:

- a) të refuzojë aksesin në impiant, në rastet e parashikuara në nenet 43 e 79;
- b) të blejë gaz natyror për konsumin e vet dhe për mbulimin e humbjeve të gazit në impiantin e GNL-së;
- c) të kufizojë ose të ndalojë, përkohësisht, shkarkimin dhe rigazifikimin e GNL-së, në rast të:
 - i) një kërcënimi të drejtpërdrejtë të jetës së njerëzve, shëndetit dhe pasurisë, me qëllimeliminimin e kërcënimeve të tilla;
 - ii) një situatë krize dhe me qëllim parandalimin e saj;
 - iii) punimeve të planifikuara të mirëmbajtjes dhe të rindërtimit të impianteve të GNL-së;
 - iv) mosrespektimit, nga një përdorues, të detyrimeve të tij kontraktuale.

Neni 71

Shërbimet e aksesit të palës së tretë në lidhje me impiantet e GNL-së

1. Operatori i Sistemit të Impiantit të GNL-së:

- a) ofron shërbime në baza jodiskriminuese për të gjithë përdoruesit e rrjetit që respektojnë kërkesat e tregut. Kur ky operator u ofron të njëjtin shërbim klientëve të ndryshëm, atëherë ky shërbim ofrohet sipas kritereve dhe kushteve kontraktore të njëjta;
- b) ofron shërbime që janë në përputhje me përdorimin e sistemeve të ndërlidhura të transportit të gazit dhe lehtëson aksesin, nëpërmjet bashkëpunimit me OST-në;
- c) bën publik, sipas një afati të arsyeshëm, në përputhje me nevojat e përdoruesve të impiantit të GNL-së, gjithë informacionin përkatës, në veçanti të dhënat për përdorimin dhe disponueshmërinë e shërbimeve. Ky informacion do të jetë objekt monitorimi nga ERE.

2. Kontratat e përdorimit të impiantit të GNL-së nuk duhet të rezultojnë me tarifa arbitrarisht më të larta se në rastet kur ato janë lidhur:

- a) jashtë afatit standard, njëvjeçar, të përdorimit, me datë të papërcaktuar të fillimit;
- b) për një kohëzgjatje më të shkurtër se një kontratë standarde përdorimi të impiantit GNL me bazë vjetore.

3. Kur shihet e arsyeshme, shërbimet e aksesit të palës së tretë jepen përkundërt garancive, nga përdoruesit e rrjetit, duke dëshmuar aftësinë financiare. Të tilla garanci nuk duhet të përbëjnë pengesa të panevojshme për hyrjen në treg dhe

duhet të jenë jodiskriminuese, transparente eproporcionale.

4. Operatori i Sistemit të Impiantit të GNL-së mund të refuzojë aksesin në instalimet e GNL-së, sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në nenin 43 të këtij ligji.

Neni 72

Parimet e mekanizmit të alokimit të kapacitetit dhe procedurat e menaxhimit të kapacitetit tëkufizuar në impiantet e GNL-ve

1. Kapaciteti maksimal i impiantit të GNL-së duhet t'u bëhet i ditur pjesëmarrësve të tregut, duke marrë në konsideratë qëndrueshmërinë e sistemit dhe operimin eficient të rrjetit.

2. Operatori i Sistemit të Impiantit të GNL-së zbaton dhe publikon, në mënyrë jodiskriminuese e transparente, mekanizmat e shpërndarjes së kapacitetit, të cilat:

a) ofrojnë treguesit e duhur ekonomikë për përdorimin efikas e maksimal të kapaciteteve dhe lehtësojnë investimet në infrastrukturën e re;

b) janë në përputhje me mekanizmin e tregut, duke përfshirë tregjet e çastit dhe korridoret etregtimit, në mënyrë që t'i përshtaten zhvillimeve të tregut;

c) janë në përputhje me aksesin në rrjet të sistemeve të lidhura.

3. Kontratat e impianteve të GNL-ve përfshijnë masat për të parandaluar grumbullimin, me qëllim shitjen më vonë të kapaciteteve, duke marrë parasysh parimet e mëposhtme, të cilat zbatoheshin rastet e kufizimit kontraktor të kapaciteteve:

a) Operatori i Sistemit të Impiantit të GNL-së ofron, pa vonesë, në tregun primar, kapacitete të papërdorura në impiantet e GNL-së;

b) përdoruesit e impiantit GNL, që duan të rishesin kapacitetin e tyre të kontraktuar në tregun sekondar, duhet të kenë të drejtën për rishitje.

Neni 73

Kërkesat e transparencës për impiantet e GNL-ve

1. Operatori i Sistemit të Impiantit të GNL-së bën publik informacionin e detajuar, në lidhje me shërbimet që ofron, kushtet përkatëse të aplikueshme dhe informacionin teknik të nevojshëm për përdoruesit e impiantit GNL, për të fituar akses efektiv në impiantet e GNL-së.

2. Për shërbimet e ofruara, Operatori i Sistemit të Impiantit të GNL-së bën publik informacionin për kapacitetet e kontraktuara dhe të disponueshme në impiantin GNL, informacion që ofrohet në formë numerike, lehtësisht të aksesueshëm nga palët.

3. Operatori i Sistemit të Impiantit të GNL-së është i detyruar të japë informacionin e përcaktuar me këtë ligj dhe aktet e tjera ligjore të zbatueshme, në një mënyrë lehtësisht të aksesueshme nga palët.

4. Operatori i Sistemit të Impiantit të GNL-së bën publike të dhënat mbi sasinë e gazit në çdo impiant të GNL-së, ose grup impiantesh të GNL-së, rrjedhave hyrëse e dalëse si dhe kapaciteteve në dispozicion në impiantin GNL, duke përfshirë edhe impiantet ku është përjashtuar aksesin në palës së tretë, në qoftë se ky detyrim korrespondon me mënyrën me të cilën është ofruar aksesin për përdoruesit e sistemit. Ky informacion i komunikohet OST-së, e cila e bën publik, në mënyrë të përmbledhur, për sistemin apo nënsistemin. Informacioni përditësohet, të paktën, çdo ditë.

5. Operatori i Sistemit të Impiantit të GNL-së, në mënyrë që të lehtësojë përdorimin efikas të infrastrukturës dhe të sigurojë tarifa transparente, objektive dhe jodiskriminuese, bën publik informacion të detajuar për metodologjinë dhe strukturën për llogaritjen e tarifave të infrastrukturës, nën aksesin e rregulluar të palëve të treta.

Neni 74

Rregullat e përdorimit për terminalin e GNL-së

1. Rregullat e përdorimit për terminalin e GNL-së përcaktojnë zhvillimin, përdorimin dhe menaxhimin e tij.

2. Rregullat e përdorimit për terminalin e GNL-së, veçanërisht, përfshijnë:

a) përshkrimin e terminalit;

b) zhvillimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e terminalit;

c) menaxhimin dhe mbikëqyrjen e terminalit;

ç) marrëdhëniet kontraktuale dhe kushtet e përgjithshme për përdorimin e terminalit;

d) rezervimet dhe përdorimin e kapaciteteve në terminal;

- dh) të drejtat e detyrimit e operatorit dhe përdoruesit të terminalit;e)rregullat e matjes dhe rregullat e shpërndarjes;
- ë) publikimin e të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit;
- f) mbulimin e humbjeve të terminalit.

3. Në procesin e hartimit të rregullave të përdorimit për terminalin e GNL-së, operatori siguron pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara dhe kryen një konsultim publik, për jo më pak se 15 ditë. Rregullat e përdorimit për terminalin e GNL-së zbatohen nga operatori, pasi të jenë miratuar nga ERE, dhe publikohen në faqet e internetit të ERE-s dhe operatorit të terminalit GNL-së.

SEKSIONI VI

FURNIZIMI I GAZIT NATYROR

Neni 75

Veprimtaritë e furnizimit

1. Çdo person që kryen veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror pajiset me licencë nga ERE.
2. Furnizimi i gazit natyror te klienti fundor ofrohet me çmime tregu, jo të rregulluara, sipas njëkontrate të negociuar mes furnizuesit dhe klientit.
3. Si përjashtim nga pika 2, e këtij neni, klientët familjarë dhe shoqëritë e vogla kanë të drejtët furnizohen me gaz natyror nga furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, sipas kritereve dhe kushteve të përcaktuara në nenet 92 e 93 të këtij ligji.
4. Klientët fundorë, duke përfshirë edhe ata të përmendur në pikën 3, të këtij neni, mund të furnizohen nga çdo furnizues i licencuar nga ERE dhe i zgjedhur prej tyre.
5. Të gjithë furnizuesit, përfshirë edhe ata që kanë, sipas licencës, detyrimin e ofrimit të shërbimit publik, blejnë gaz natyror për furnizimin e klientëve fundorë, sipas kontratave dypalëshe, tregjeve të organizuara të gazit natyror ose nëpërmjet importeve, me çmime jo të rregulluara.
6. Furnizuesit, që janë ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik me çmime të rregulluara, kanë të drejtë të shesin gaz natyror në kushtet e tregut dhe me çmime jo të rregulluara dhe pa kufizim territorial, me kusht që të kenë llogari të ndara për të dyja veprimtaritë.
7. ERE miraton kushtet e përgjithshme për furnizim me gaz natyror, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë furnizuesit që kryejnë veprimtari në vend. Kushtet e përgjithshme për furnizim me gaz natyror përcaktojnë kërkesa objektive, transparente dhe jodiskriminuese, që zbatohen në mënyrë të barabartë ndaj të gjitha shoqërive të gazit natyror, në varësi të veprimtarisë së tyre në treg. Kushtet e përgjithshme të furnizimit publikohen në faqet e internetit të ERE-s dhe të furnizuesit.

Neni 76

Rregullat për të ndryshuar furnizues

1. ERE garanton zbatimin e një procedure që mundëson ndryshimin e furnizuesit, nga ana e klientit fundor, në mënyrë të thjeshtë, brenda një periudhe kohore jo më të gjatë se 3 javë, nga momenti i njoftimit të furnizuesit të mëparshëm.
2. ERE harton dhe miraton rregullat për ndryshimin e furnizuesit. Këto rregulla përcaktojnë kushtet dhe procedurat për ndryshimin e furnizuesit dhe, në mënyrë të veçantë, përmbajnë:
 - a) procedurat për ndryshimin e furnizuesit, të cilat përfshijnë:
 - i) procedurën për ndryshimin e furnizuesit, në kushtet e furnizimit, si detyrim i shërbimit publik dhe atij të mundësisë së fundit;
 - ii) procedurën për kalimin nga një furnizues te tjetri, në rastin e ndryshimit të pronësisë së ndërtesës;
 - iii) procedurën për ndryshimin e marrëdhënieve kontraktuale, në rastin e një transferimi të përkohshëm të kontratës për furnizimin me gaz natyror për klientët fundorë si dhe të kontratës për klientët fundorë për përdorimin e rrjetit, përkundrejt një pale të tretë;
 - b) kushtet që duhet të përmbushen nga furnizuesi i ri, veçanërisht kushtet që lidhen me balancimin;
 - c) detyrimet e një furnizuesi, kontrata e të cilit për furnizimin me gaz natyror të klientëve fundorë është duke përfunduar;
 - ç) detyrimet e operatorit përgjegjës të sistemit, te pajisjet e të cilit janë të lidhur klientët fundorë;

d) të drejtat e furnizuesit të ri, në lidhje me aksesin e rrjetit dhe përdorimin e rrjeteve të transmetimit ose të shpërndarjes, me qëllim furnizimin e një klienti të ri fundor;

dh) shlyerjen e detyrimeve financiare të mëparshme të klientëve fundorë.

3. Ndryshimi i furnizuesit, sipas rregullave për ndryshimin e furnizuesit për klientët fundorë është pa pagesë. Kalimi te furnizuesi i ri bëhet në bazë të një kërkesë të paraqitur nga ana e klientit fundor, përveçse kur është një rast i furnizimit si një detyrim i shërbimit publik apo furnizimit të mundësisë së fundit, sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

4. Nëse kontrata për furnizim me gaz natyror të klientëve fundorë është drejt përfundimit, furnizuesi nuk mund të vendosë kushte shtesë për ndërprerjen e saj, duke përfshirë detyrimet e papaguara, dhe duhet ta furnizojë klientin fundor deri në përfundimin e procedurës së kalimit te furnizuesi i ri. Furnizuesi i mëparshëm mund të vendosë kushte shtesë vetëm nëse klienti fundor nuk ka shlyer detyrimet, pasi të jetë njoftuar më parë dhe pasi t'i jetë kërkuar nënshkrimi i një marrëveshjeje për zgjidhjen e detyrimeve, e cila duhet të arrihet brenda një periudhe kohore jo më të shkurtër se 8 ditë, nga marrja e njoftimit të detyrimeve të papaguara.

5. ERE monitoron zbatimin e rregullave të ndryshimit të furnizuesit.

6. Mosmarrëveshjet, që kanë të bëjnë me këtë procedurë dhe që dalin nga ankesat e paraqitura nga klienti ose furnizuesit, zgjidhen nga ERE. Në çdo rast, palët e interesuara kanë të drejtë që t'i drejtohen, drejtpërdrejt, gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

7. Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve nuk pezullojnë vazhdimin e procedurës së ndryshimit të furnizuesit.

Neni 77

Mbajtja e të dhënave

1. Shoqëritë e gazit natyror, të përfshira në furnizimin ose tregtimin e tij, vënë në dispozicion të ERE-s, ministrisë, Autoritetit të Konkurrencës dhe autoriteteve të tjera përgjegjëse të dhënat përkatëse, për një periudhë, të paktën, 5 vjet, në lidhje me të gjitha transaksionet, në kontratat e furnizimit me gaz dhe derivativëve të tij, me klientët me shumicë, OST-në, operatorët e sistemit të depozitimit dhe të sistemit të GNL-së. Këto të dhëna vihen në dispozicion edhe të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë po për të njëjtën periudhë.

2. Të dhënat duhet të përfshijnë detaje për karakteristikat e transaksioneve përkatëse, si kohëzgjatja, rregullat e ofertës dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, sasinë, datat, kohën e ekzekutimit të kontratës, çmimet e transaksionit, mjetet e identifikimit të klientëve me shumicë të përfshirë, si dhe detaje për të gjitha kontratat e papaguara, për furnizim me gaz dhe derivativëve të tij.

3. ERE mund të vërë në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut të dhëna të caktuara, të deklaruara nga operatorët më sipër, me kusht që të mos publikohet informacioni që përbën sekret tregtar.

SEKSIONI VII

INFRASTRUKTURA TË TJERA TË GAZIT NATYROR

Neni 78

Përfshirjet për infrastrukturën e re

1. Infrastrukturat e reja kryesore të gazit natyror përfshirë linjat e interkoneksionit, impiantet e GNL-së dhe impiantet e depozitimit, me kërkesë të tyre, mund të përjashtohen nga zbatimi i parashikimeve të pikës 1, të nenit 16; pikës 5, të nenit 33; shkronjave “dh” dhe “e”, të pikës 1, të nenit 17; dhe të neneve 36, 42, 63, 64 e 71, të këtij ligji, me miratim të ERE-s, me kusht që:

a) investimet të përmirësojnë konkurrencën në furnizimin me gaz dhe të rritin sigurinë e furnizimit;

b) niveli i riskut, lidhur me këto investime, të jetë i tillë që ato nuk do të bëhen nëse nuk jepet një përjashtim;

c) infrastruktura të zotërohet nga një person, i cili është i ndarë, të paktën nga forma ligjore, nga operatorët e sistemit, në ato sisteme ku do të ndërtohet kjo infrastrukturë;

ç) shpenzimet t'i ngarkohen përdoruesve të kësaj infrastrukture;

d) përjashtimi të mos dëmtojë konkurrencën, funksionimin efektiv të tregut të brendshëm të gazit natyror ose funksionimin eficient të sistemit të rregulluar, me të cilën është lidhur kjo infrastrukturë.

2. Pika 1, e këtij neni, mund zbatohet edhe në rastin e rritjes së konsiderueshme të kapacitetit dhe modifikimit të infrastrukturës ekzistuese, për të mundësuar zhvillimin e burimeve të reja të furnizimit me gaz natyror.

3. ERE vendos, rast pas rasti, për përjashtimin, sipas pikave 1 e 2, të këtij neni, duke marrë parasysh kriteret e

parashikuara në këtë ligj.

4. Kur infrastruktura në fjalë është e vendosur në territorin e më shumë se një pale kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, ose të një shteti anëtar të BE-së, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë mund të paraqesë një mendim këshillues për ERE-n dhe autoritetin rregullator të një shteti anëtar të BE-së ose një palë tjetër kontraktuese të Komunitetit të Energjisë në fjalë, mendim që mund të përdoret si bazë për vendimin e autoriteteve rregullatore për përjashtim, brenda 2 muajve nga data në të cilën kërkesa për përjashtim i është njoftuar autoritetit të fundit rregullator.

5. Kur të gjitha autoritetet rregullatore të përfshira bien dakord për kërkesën për përjashtim, brenda 6 muajve nga data në të cilën kërkesa është marrë nga autoriteti i fundit rregullator, ata informojnë Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë për vendimin e tyre.

6. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ushtron detyrat që i janë dhënë autoriteteve rregullatore të një shteti anëtar të BE-së dhe/ose një pale tjetër kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, të përfshira në këtë nen, në rastet kur:

a) të gjitha autoritetet rregullatore përkatëse nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë një marrëveshje, brenda afatit prej 6 muajsh, nga data në të cilën kërkesa për përjashtim është marrë nga autoriteti i fundit rregullator;

b) autoritetet rregullatore përkatëse bëjnë kërkesë të përbashkët.

7. Të gjitha autoritetet rregullatore të përfshira mundet, së bashku, të kërkojnë që periudha e përmendur në shkronjën “a”, të pikës 6, të këtij neni, të shtyhet deri në 3 muaj.

8. Para se të marrë një vendim, ERE konsultohet me autoritetet përkatëse rregullatore dhe aplikuesit.

9. Përjashtimi mund të mbulojë të gjithë ose një pjesë të infrastrukturës së re, ose të asaj ekzistuese, me kapacite të zgjeruara ose me modifikimin e infrastrukturës ekzistuese.

10. Në marrjen e vendimit për dhënien e një përjashtimi, rast pas rasti, duhet të merret parasysh nevoja për të vendosur kushte për kohëzgjatjen e përjashtimit dhe të aksesitjodiskriminues në linjën e interkoneksionit. Kur merret një vendim, sipas kushteve të kësaj pike, llogaritet, në veçanti, dhe merret parasysh kohëzgjatja e kontratave, kapaciteti shtesë për t'u ndërtuar apo modifikimi i kapaciteteve ekzistuese, koha e projektit dhe rrethanat kombëtare.

11. ERE, kur miraton një përjashtim, vendos për rregullat dhe mekanizmat për menaxhimin dhe shpërndarjen e kapacitetit. Rregullat parashikojnë që të gjithë përdoruesit e mundshëm të infrastrukturës të ftohen për të paraqitur interesin e tyre në kapacitetin e kontraktuar, para shpërndarjes së kapacitetit në infrastrukturën e re, përfshirë këtu edhe përdorimin vetjak të tij. ERE kërkon që rregullat e menaxhimit të kapacitetit të kufizuar të përfshijnë detyrimin për të ofruar kapacitete të papërdorura në treg dhe u kërkon përdoruesve të infrastrukturës të tregtojnë kapacitetet e tyre të kontraktuara në tregun sekondar. Në vlerësimin e kriterëve të përmendura në shkronjat “a”, “b” e “d”, të pikës 1, të këtij neni, ERE merr parasysh rezultatet e procedurës së shpërndarjes së kapaciteteve.

12. Vendimi për përjashtim, parashikuar në pikën 11, të këtij neni, përfshirë edhe çdo kusht që mund të vendoset, arsyetohet dhe publikohet në Fletoren Zyrtare. Pa publikuar informacionin e ndjeshëm tregtar, ky vendim përmban:

a) arsyet e hollësishme, në bazë të të cilave ERE ka dhënë përjashtimin ose e ka refuzuar atë, duke iu referuar pikës 1, të këtij neni, si dhe dispozitave përkatëse, mbi të cilat bazohet vendimi, duke përfshirë në vendim, gjithashtu, informacionin financiar që justifikon nevojën për përjashtim;

b) analizën e bërë rreth efektit mbi konkurrencën dhe funksionimin efektiv të tregut të brendshëm të gazit natyror, që mund të rezultojë nga dhënia e përjashtimit;

c) arsyet për periudhën kohore dhe pjesën e kapacitetit total të infrastrukturës së gazit natyror në fjalë, për të cilën është dhënë përjashtimi;

ç) kur përjashtimi lidhet me një linjë interkoneksioni, rezultatit e këshillimit me vendet ose autoritetet rregullatore përkatëse;

d) kontributin e infrastrukturës në diversifikimin e furnizimit me gaz.

13. Pavarësisht nga pika 3, e këtij neni, ERE mund të aplikojë pranë Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe të paraqesë, për qëllim të vendimmarrjes, opinionin e saj për kërkesën për një përjashtim. Ky opinion publikohet së bashku me vendimin.

14. ERE i përcjell, pa vonesë, Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe, sipas rastit, edhe Komisionit Europian, nëse ka të përfshirë një vend anëtar të BE-së, një kopje të çdo kërkesë për përjashtim, që nga momenti i marrjes së saj. ERE i njofton vendimin, pa vonesë, Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë së bashku me të gjithë informacionin e duhur, në lidhje me vendimin. Ky informacion mund t'i paraqitet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në formë të përmbledhur, në mënyrë që ai të marrë vendimin përkatës.

15. Brenda një afati 2-mujor nga dita pas marrjes së njoftimit, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë mund të japë një opinionin, duke i kërkuar ERE-s të ndryshojë ose të tërheqë vendimin e dhënies së një përjashtimi. Ky afat mund të zgjatet me 2 muaj, kur Sekretariati i Komunitetit të Energjisë kërkon informacion të mëtejshëm. Ky afat kohor shtesë do të fillojë të përlllogaritet në ditën pas marrjes së informacionit të plotë. Afati i parë dymujor mund të zgjatet, gjithashtu, me pëlqimin e të dyja palëve, Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe ERE-s.

16. Kur informacioni, i kërkuar sipas pikës 15, nuk është dhënë brenda afatit të përcaktuar në kërkesë, do të konsiderohet se ERE po rishikon vendimin e përjashtimit dhe njoftimi i dërguar, sipas pikës 14, do të konsiderohet

si i tërhequr nga ana e tij përveç rastit kur ERE, përpara kalimit të afateve të përcaktuara në pikën 15, ka informuar Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë nëpërmjet një deklarate të arsyetuar se njoftimin e bërë e konsideron të plotë.

17. ERE duhet të bëjë përpjekjet maksimale për të marrë në konsideratë opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, që rekomandon ndryshimin ose tërheqjen nga vendimi i përjashtimit. Kur vendimi përfundimtar ndryshon thelbësisht nga opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ERE publikon argumentimin e vendimit të marrë, së bashku me opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

18. Opinioni miratues i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për një vendim përjashtimi e humbet fuqinë 2 vjet nga miratimi i tij, në rast se ndërtimi i infrastrukturës nuk ka filluar ende, dhe 5 vjet nga miratimi i tij, në rast se infrastruktura nuk është bërë operationale, përveç se, nëse Sekretariati i Komunitetit të Energjisë vendos se çdo vonesë është për shkak të pengesave të mëdha, jashtë kontrollit të personit, të cilit i është dhënë përjashtimi.

Neni 79

Përjashtimet në lidhje me detyrimin “merr ose paguaj”

1. Nëse një shoqëri e gazit natyror përballet, ose vlerëson se do të përballet me vështirësi serioze ekonomike dhe financiare, për shkak të detyrimit të saj “merr ose paguaj”, të përfshira në kontrata blerjeje të gazit natyror, ajo ka të drejtë të aplikojë në ERE për një përjashtim të përkohshëm nga detyrimi për të siguruar aksesin e palëve të treta. Aplikimi paraqitet, rast pas rasti, si para edhe pas refuzimit të hyrjes në sistem, sipas zgjedhjes së shoqërisë së gazit natyror. Aplikimi shoqërohet me një informacion për natyrën dhe përmasat e vështirësisë, me të cilën përballet shoqëria dhe masat e marra për ta eliminuar atë.

2. ERE vendos të miratojë përjashtimin, sipas parashikimit të pikës 1, të këtij neni, me kusht që të mos ekzistojnë mundësi të tjera për shmangien e kësaj situatë. Në vendimin për miratimin e përjashtimit, ERE merr parasysh:

- a) objektivin e arritjes së një tregu gazi jodiskriminues, transparent dhe konkurrues;
- b) nevojën e përmbushjes së detyrimeve të shërbimit publik dhe të garantimit të sigurisë së furnizimit;
- c) pozicionin e shoqërisë së gazit natyror në treg dhe gjendjen aktuale të konkurrencës;
- ç) vështirësitë ekonomike dhe financiare, me të cilat përballet shoqëritë e gazit natyror, OST-ja ose klientët;
- d) datën e nënshkrimit dhe kushtet e kontratës ose të kontratave në fjalë, përfshirë masën në të cilën ato lejojnë devijimin nga detyrimet e tyre;
- dh) përpjekjet e bëra për të gjetur mundësi të tjera për shmangien apo zgjidhjen e kësaj situatë;
- e) masën e efekteve negative, të shkaktuara shoqërisë, si rezultat i zbatimit të detyrimit “merr ose paguaj”, efekte, të cilat janë marrë në konsideratë ose, sipas rrethanave, që duhet të ishin marrë në konsideratë nga shoqëria që pranon detyrimin “merr ose paguaj”;
- ë) nivelin e lidhjes së sistemit me sistemet e tjera dhe shkallën e tyre të ndërveprimit;
- f) efektet që mund të shkaktojnë miratimi i përjashtimit në zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj, lidhur me funksionimin normal të tregut të brendshëm.

3. ERE njofton, pa vonesë, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për vendimin e saj për të dhënë përjashtimin nga detyrimi për akses, shoqëruar me të gjithë informacionin e nevojshëm, lidhur me përjashtimin, për t'i bërë të mundur përgatitjen e një opinionin të bazuar. Brenda 2 muajve, nga marrja e njoftimit, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë jep një opinion, duke kërkuar, sipas rastit, lënien në fuqi, ndryshimin apo prishjen e vendimit për të dhënë një përjashtim.

4. ERE duhet të bëjë përpjekjet maksimale për të marrë në konsideratë opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, që rekomandon ndryshimin ose tërheqjen nga vendimi i përjashtimit. Kur vendimi përfundimtar ndryshon thelbësisht nga opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ERE publikon argumentimin e vendimit të marrë, së bashku me opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

5. Në rast se ERE refuzon dhënien e përjashtimit, sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, shoqëria e gazit natyror nuk mund të refuzojë aksesin në sistem të palës së tretë, për shkak të detyrimit “merr ose paguaj”, të pranuar në një kontratë blerjeje të gazit natyror.

6. Çdo përjashtim i miratuar nga ERE, sipas këtij neni, arsyetohet dhe publikohet.

Neni 80

Operatori i kombinuar

1. Parashikimet e neneve 36 e 50, pika 2, të këtij ligji, nuk përjashtojnë operimin e kombinuar të sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes, të impianteve të GNL-ve dhe të impianteve të depozitimit nga një operator i vetëm, i cili duhet të jetë i pavarur nga pikëpamja ligjore, organizative dhe e vendimarrjes, nga veprimtari të tjera, që nuk lidhen me operimin e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes, të impianteve të GNL-së dhe impianteve të depozitimit. Sistemi i transmetimit të operatorit të kombinuar duhet të certifikohet në përputhje me parashikimet e këtij

ligji.

2. Operator i kombinuar konsiderohet kur e njëjta shoqëri e gazit natyror mund të licencohet për të kryer veprimtarinë e transmetimit, shpërndarjes, operatorit të impianteve të GNL-së dhe/ose të impianteve të depozitimit, me kusht që të respektojë kërkesat për ndarjen për çdo operator sistemi, sikurse parashikohet nga ky ligj, dhe të jetë i pavarur nga shoqëritë që kryejnë ndonjë nga funksionet e prodhimit, furnizimit apo tregtimit.

3. Operatori i kombinuar i sistemit, që përfaqëson një pjesë të një shoqërie vertikalisht të integruar, organizon veprimtaritë e tij si person juridik i pavarur, i ndarë nga veprimtaritë e prodhimit, tregtimit dhe furnizimit me gaz.

4. Në përputhje me pikën 3, të këtij neni, pavarësia e operatorit të kombinuar të sistemit sigurohet si më poshtë:

a) personat përgjegjës për menaxhimin e operatorit të kombinuar të sistemit, i cili përfaqëson një pjesë të shoqërisë vertikalisht të integruar, nuk marrin pjesë në menaxhimin dhe veprimtaritë e prodhimit, tregtimit e furnizimit me gaz;

b) personat përgjegjës për menaxhimin e operatorit të kombinuar të sistemit janë të aftë profesionalisht dhe veprojnë në mënyrë të pavarur për përmbushjen e detyrave dhe objektivave të shoqërisë. Trajtimi financiar i personave përgjegjës për menaxhimin dhe personave përgjegjës për organet mbikëqyrëse të operatorit të kombinuar të sistemit, që kontrollohet nga shteti, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) operatori i kombinuar i sistemit vendos në mënyrë të pavarur nga shoqëria e integruar rreth burimeve të nevojshme për operimin, menaxhimin dhe zhvillimin e sistemit që ai administron. Operatori duhet të zotërojë burimet e nevojshme për të përmbushur këto detyrime, përfshirë burimet njerëzore, teknike, financiare dhe materiale. Kjo nuk do të ndryshojë të drejtën e shoqërisë mëmë, në përbërje të sistemit të një shoqërie të integruar, për të miratuar planin vjetor financiar për operatorin e kombinuar të sistemit dhe për të vendosur kufijtë e borxhit të tij. Shoqëria mëmë nuk do të japë udhëzime të operatorit të sistemit të kombinuar, në lidhje me operimin e tij të përditshëm, përfshirë udhëzimet për vendimet individuale në ndërtimin apo modernizimin e pjesëve të sistemit, të menaxhuara nga operatori i kombinuar i sistemit, nëse ky vendim rrjedh nga plani vjetor financiar miratuar.

5. ERE siguron që operatorit i kombinuar i sistemit zotëron aftësitë teknike e menaxhuese për të operuar në mënyrë të pavarur dhe jep licenca të veçanta për secilën nga veprimtaritë që ushtrohen nga një operatori kombinuar, sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

6. Një operator i kombinuar i sistemit mban llogari të ndara për secilën nga veprimtaritë e tij, në përputhje me nenin 30 të këtij ligji.

7. Operatori i kombinuar i sistemit harton dhe zbaton programin e përputhshmërisë, në përputhje me nenin 47 të këtij ligji.

8. ERE monitoron veprimtaritë e një operatori të kombinuar, pjesë e një shoqërie vertikalisht të integruar, në mënyrë që ai të mos përfitojë nga ky pozicion për të ndikuar në kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës në treg.

Neni 81

Linja direkte

1. Nëse një shoqëri e gazit natyror planifikon të lidhë një kontratë furnizimi me gaz natyror me një klient të caktuar, por nuk ka akses në sistemin e transmetimit ose të shpërndarjes, ajo mund të ndërtojë një linjë direkte, me miratimin e Këshillit të Ministrave, mbi bazën e propozimit të ministrit, sipas kriterëve dhe procedurave të nenit 11 të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave miraton kriteret për dhënien e miratimit për ndërtimin dhe operimin e linjave direkte, pas marrjes së opinionit të ERE-s, ku konfirmohet pamundësia e shoqërisë së gazit natyror për të lidhur një kontratë për furnizimin me gaz natyror, për shkak të mungesës së aksesit në sistemin e transmetimit ose të shpërndarjes.

3. Mundësia për të furnizuar me gaz natyror, nëpërmjet një linje direkte, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk do të ndikojë në të drejtën e kontraktimit të gazit natyror në bazë të kontratave dypalëshe, ose në tregun e organizuar të gazit natyror, sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

4. Këshilli i Ministrave mund të japë miratim për të ndërtuar një linjë direkte, si rezultat i refuzimit të aksesit në sistemin e transmetimit ose shpërndarjes, sipas rasteve të neneve 43 ose 54, pika 5, të këtij ligji, ose i hapjes së një procedure të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, sipas nenit 98, të këtij ligji, kur përbën shkak për mungesë aksesit në sistemin e transmetimit ose të shpërndarjes.

5. Këshilli i Ministrave mund të refuzojë dhënien e miratimit për të ndërtuar një linjë direkte, në qoftë se ndërtimi i linjës pengon zbatimin e parashikimeve për detyrimet e shërbimit publik, përfshirë mbrojtjen e klientëve fundorë. Në çdo rast, ky refuzim duhet të bazohet në opinionin e argumentuar të ERE-s.

6. Ndaj vendimit që refuzon miratimin për ndërtimin e një linje direkte mund të bëhet ankim në gjykatën administrative, në përputhje me afatet e përgjithshme, të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

7. Ndërtimi dhe rikonstruksioni i linjave direkte bëhet në përputhje me procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

8. Shpenzimet e kryera për ndërtimin e një linje direkte, në përputhje me pikat 1 e 2, të këtij neni, mbulohen nga

shoqëria e gazit natyror, duke u rimbursuar, në mënyrë të drejtë, nga klienti që do të furnizohet nga kjo linjë. Në çdo rast, kostoja për ndërtimin e linjës direkte nuk do të përfshihet në metodologjinë për përllogaritjen e tarifave të sistemit, në të cilin është lidhur linja direkte.

KREU V

TREGU I GAZIT NATYROR

Neni 82

Hapja e tregut dhe marrëdhënia e reciprocitetit

1. Tregu i gazit është i hapur, ku të gjithë klientët kanë të drejtë të zgjedhin, lirisht, furnizuesin etyre.
2. Një klient ka të drejtë të furnizohet nga një operator që ushtron veprimtarinë në sistemin e një vendi anëtar të BE-së ose të një pale kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, me kusht që të mos krijohen disbalanca në sistem, si rezultat i furnizimit.

Neni 83

Tregtimi i gazit natyror

1. Tregtimi i gazit natyror kryhet nga një person juridik, në bazë të një licence të dhënë nga ERE, sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe rregullave të licencimit, të miratuara nga ERE.
2. Shoqëria e gazit natyror, që është licencuar për veprimtarinë e furnizimit me gaz natyror, katë drejtë të kryejë edhe veprimtarinë e tregimit të gazit natyror, me kusht që të mbajë llogari të ndara për secilën veprimtari. Pas marrjes së licencës së furnizimit nga ERE, shoqëria e gazit natyror, që do të kryejë edhe veprimtarinë e tregimit të gazit natyror, duhet ta përfshijë këtë objekt veprimtarie në regjistrin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), duke depozituar atje edhe kopje të licencës së lëshuar nga ERE.
3. ERE siguron, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë, se procedura për dhënien e licencës për tregtimin e gazit natyror dhe kërkesat e përcaktuara në licencat përkatëse nuk krijojnë kushte diskriminuese për shoqëritë e gazit natyror nga çdo vend anëtar i BE-së ose palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë.

Neni 84

Tregu i gazit natyror

1. Tregu i gazit natyror përfshin tregun me pakicë dhe tregun me shumicë të tij.
2. Marrëdhëniet ndërmjet klientëve fundorë dhe furnizuesve të tyre organizohen në tregun me pakicë të gazit natyror.
3. Tregu me shumicë i gazit natyror përfshin:
 - a) marrëveshjet dypalëshe të gazit natyror, me përjashtim të marrëveshjeve të lidhura ndërmjet palëve, sipas pikës 2, të këtij neni;
 - b) tregun e ditës së nesërme, për lëvrimin e gazit natyror;
 - c) balancimin e tregut të gazit natyror.
4. Shitjet dhe blerjet në tregun me shumicë të gazit natyror kontrahohen, sipas marrëveshjeve dypalëshe, si edhe në tregjet e organizuara të gazit natyror, që janë tregje të gazit natyror të ditës së nesërme, për dorëzimin e sasisë së gazit natyror dhe të balancimit të tregut të tij.
5. OST-ja siguron shërbimet balancuese, në përputhje me rregullat e balancimit, të cilat miratohen nga ERE.
6. Rregullat e balancimit përcaktojnë detyrimet dhe kushtet në lidhje me balancimin, përfshirë rregullat për ofruesit e shërbimeve të balancimit, prokurimin e shërbimeve balancuese dhe përcaktimin e sasive e kriterëve financiarë të rakorduara me ofruesit e shërbimeve të balancimit.
7. OST-ja bashkëpunon me operatorët e sistemit të transmetimit të vendeve të tjera për lehtësimin e tregut balancues në nivel rajonal, për të garantuar sigurinë operationale dhe funksionimin efikas të balancimit të tregut, bazuar në konkurrencën efektive, mosdiskriminimin dhe transparencën.

Neni 85

Organizimi i tregut të gazit natyror

1. Operatori i tregut të gazit natyror është personi juridik, i licencuar nga ERE, përgjegjës për organizimin e tregut të gazit natyror, në përputhje me rregullat e tregut, të hartuara nga operatori i tregut dhe të miratuara nga ERE.
2. Operatori i tregut të gazit natyror është përgjegjës për funksionimin e organizuar të tregtimit fizik të gazit natyror në vend, si dhe për lidhjen e tij me tregjet e tjera të organizuara të gazit.
3. Krijimi i mundësisë së shkëmbimit të aksioneve në bursë të derivativëve të gazit natyror nuk do të kufizohet vetëm për operatorin e tregut të gazit natyror.
4. Operatori i tregut të gazit natyror është një shoqëri që, funksionalisht, vepron e pavarur nga OST-ja.
5. Operatori i tregut të gazit natyror përmbush detyrat e tij, duke respektuar parimet etransparencës, objektivitetit dhe mosdiskriminimit, nën mbikëqyrjen e ERE-s.
6. Tarifat, që aplikohen nga operatori i tregut të gazit për organizimin e këtij tregu, miratohen, paraprakisht, nga ERE.
7. Operatori i tregut të gazit natyror mban llogari të ndara për transaksionet, në lidhje me blerjen dhe shitjen e gazit natyror.

Neni 86

Masat për nxitjen e hapjes së tregut

1. ERE, në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës, kryen hetim për funksionimin e tregut të gazit natyror, të paktën, çdo 2 vjet, duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. ERE, me nismën e vet, ose me kërkesë të arsyetuar të ministrit apo të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, harton dhe miraton masat e nevojshme për nxitjen e konkurrencës efikase në treg, me qëllim që të garantohet funksionimi i rregullt i tregut të gazit natyror. Këto masa duhet të jenë proporcionale, jodiskriminuese dhe transparente.

Neni 87

Monitorimi dhe mbikëqyrja e tregut të gazit natyror

1. ERE kryen monitorimin dhe mbikëqyrjen e tregut të gazit natyror, sipas detyrimeve dhe kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe në rregullat e tregut.
2. ERE, në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës, merr masa për të siguruar kushtet për konkurrencë efektive në tregun e gazit natyror dhe për evidentimin, me kohë, e kontrollin e rasteve të abuzimit të tregut.
3. Në raportin vjetor, të parashikuar në nenin 21 të këtij ligji, ERE përfshin edhe informacion për organizimin dhe funksionimin e tregut, analizën e veprimtarive të pjesëmarrësve të tregut të gazit natyror dhe zhvillimet në këtë treg.
4. Operatori i tregut të gazit natyror dhe OST-ja, në përputhje me kompetencat e tyre, analizojnë organizimin e tregut të gazit natyror dhe i propozojnë ERE-s masa për përmirësimin e tij, si dhe informojnë atë për çdo shkelje të evidentuar ose të pritshme të kërkesave, në lidhje me veprimtaritë në tregun e gazit natyror.

Neni 88

Rregullat e tregut të gazit

1. Organizimi dhe funksionimi i tregut të gazit bazohet në modelin e tregut dhe rregullat e tij. Ministri përgjegjës për energjinë, në bashkëpunim me palët e interesuara në sektorin e gazit, ERE-n dhe Autoritetin e Konkurrencës, harton modelin e tregut të gazit, i cili miratohet nga Këshilli i Ministrave.
2. Rregullat e tregut bazohen në modelin e tregut të gazit dhe, veçanërisht, përcaktojnë:
 - a) procedurat, parimet dhe standardet për organizimin e funksionimin e tregut të gazit, në përputhje me modelin e tregut;
 - b) rregullat për organizimin e grupeve të balancimit dhe mbajtjen e një regjistri të këtyre grupeve dhe të anëtarëve të tyre;
 - c) rregullat për pikën virtuale të tregtimit;
 - ç) marrëdhëniet kontraktuale të operatorit të tregut të gazit me grupin e balancimit;
 - d) përgjegjësitë e pjesëmarrësve të tregut të gazit për devijimet e tyre; dh) rregullat për llogaritjen e energjisë balancuese;
 - e) rregulla të tjera të nevojshme për organizimin dhe funksionimin e tregut të gazit.
3. Rregullat e tregut hartohen nga operatori i tregut të gazit dhe miratohen nga ERE. Këto rregulla publikohen në faqet e internetit të ERE-s dhe operatorit të tregut të gazit.

4. Në procesin e hartimit të rregullave të tregut, për organizimin e tregut të gazit, operatori i tregut të gazit siguron pjesëmarrje të mjaftueshme të të gjithave palëve të interesuara dhe organizon një konsultim me publikun, që do të zgjasë jo më pak se 15 ditë.

KREU VI

DETYRIMET E SHËRBIMIT PUBLIK

Neni 89

Detyrimet e shërbimit publik

1. Veprimtaritë e transmetimit, shpërndarjes dhe të furnizimit me gaz natyror të klientëve të vegjël, përfshirë klientët familjarë, realizohen si shërbime publike.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit. ERE, bazuar në kushtet e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave, sipas interesit të përgjithshëm ekonomik, mund të vendosë mbi shoqëritë e gazit natyror detyrime të shërbimit publik, të cilat kanë lidhje me:

- a) sigurinë, përfshirë sigurinë e furnizimit;
- b) rregullsinë, cilësinë dhe çmimet e furnizimit;
- c) përdorimin e burimeve vendase të gazit natyror;
- ç) mbrojtjen e mjedisit, përfshirë efikasitetin e energjisë, të energjinë nga burimet e rinovueshme dhe mbrojtjen e klimës;
- d) mbrojtjen e shëndetit, jetës dhe pronës së njerëzve.

3. Pavarësisht përcaktimeve në pikën 2, të këtij neni, shoqëritë e gazit natyror veprojnë në përputhje me parimet e këtij ligji, me qëllim arritjen e një tregu konkurrues të gazit natyror, të sigurt dhe të qëndrueshëm, nga pikëpamja mjedisore, pa qenë të diskriminuar në të drejtat dhe detyrimet e tyre.

4. Çdo detyrim i shërbimit publik, i vendosur nga ERE, përfshihet, pa vonesë, në licencën përkatëse të shoqërisë së gazit natyror, brenda 1 muaji pas procedurës për lëshimin e një licence të re ose të një modifikimi të një licence ekzistuese, siç përcaktohet në nenin 22 të këtij ligji.

5. Detyrimet e shërbimit publik duhet të përcaktohen qartë, në mënyrë jodiskriminuese, transparente e lehtësisht të verifikueshme dhe të garantojnë barazinë e aksesit për shoqëritë e gazit natyror të vendeve anëtare të BE-së ose palë kontraktuese të Komunitetit të Energjisë për klientët vendas.

6. Në mënyrë që të përmbushen kërkesat e transparencës, ERE, nëpërmjet vendimit përkatës, miraton masa të posaçme, që vendosin detyrime të shërbimit publik, të cilat ajo i përfshin në licencën e shoqërisë së gazit natyror në fjalë.

7. Vendimet, që përcaktojnë detyrim të shërbimit publik, duhet:

a) të përcaktojnë, në mënyrë të qartë, një detyrim të tillë, llojin e rregullimit, por pa kufizuar detyrimin për të furnizuar të gjithë klientët familjarë dhe shoqëritë e vogla në të gjithë territorin, duke siguruar vazhdimësinë e furnizimit, trajtimin e barabartë të klientëve, funksionimin, me koston më të ulët të mundshme, të sistemit kombëtar të furnizimit me gaz etj.;

b) të përcaktojnë shoqëritë e gazit që ngarkohen të ofrojnë shërbimet publike;

c) të specifikojnë natyrën e të drejtave ekskluzive ose të veçanta, të caktuara për shoqëritë e gazit;

ç) të përcaktojnë territorin dhe periudhën për të cilën është vendosur detyrimi i shërbimit publik;

d) të bëjnë të qartë financimin dhe kriteret për llogaritjen e mbulimit financiar që do të përfitojnë shoqëritë e përfshira në këtë shërbim publik.

8. ERE, kur vendos detyrimin e shërbimit publik, nëpërmjet një publikimi, duhet të provojë vlerësimin e ndikimit, që masa është më pak kufizuese, proporcionale dhe e nevojshme për sigurimin e ofrimit të shërbimit publik në fjalë.

9. Pagesat për mbulim financiar, format e tjera të rimbursimit dhe të drejtat ekskluzive, të bëra për shoqëritë e gazit, për ofrimin e detyrimeve të shërbimit publik, bëhen në një mënyrë jodiskriminuese dhe transparente. Kostot e realizuara nga çdo i licencuar, për ofrimin e detyrimeve të shërbimit publik, pranohen si të justifikueshme kur tarifatat për shërbimet e ofruara janë miratuar nga ERE, në përputhje me nenin 33 të këtij ligji.

10. ERE do të vendosë për shpërndarjen e kostove të detyrimeve të shërbimit publik, të vëna në bazë të këtij neni, për klientët fundorë në një mënyrë jodiskriminuese dhe transparente. Kompensimi për këto kosto nuk duhet të kalojë shumë e shpenzuar për kryerjen e detyrimeve të shërbimit publik, të zbritura nga të ardhurat e fituara për ofrimin e shërbimit. Kompensimi mund të përfshijë një fitim të arsyeshëm. Çdo kompensim për të licencuarin për përmbushjen e detyrimit të ofrimit të shërbimit publik duhet të njoftohet dhe të marrë miratimin paraprak nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

11. Asnjë i licencuar nuk do të ngarkohet me detyrimin e shërbimit publik për të siguruar shërbim me gaz në një zonë të caktuar, në të cilën, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk ofrohet ky shërbim, përveçse kur kërkohet nga rregulloret e miratuara nga ERE, sipas këtij ligji. Këto rregullore garantojnë një ndarje të drejtë të kostove shtesë, për të siguruar këtë shërbim, ndërmjet klientëve që kërkojnë shërbimin dhe klientëve ekzistues të të licencuarit.

12. Asnjë të licencuari nuk do t'i kërkohet të ndërtojë një rrjet në një zonë ku nuk ka rrjet në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kjo bëhet pa paragjykuar detyrimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për të lidhur klientët fundorë të rrjetit të tyre, sipas detyrimeve dhe kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe me aktet e tjera ligjore në fuqi.

13. Në kuadër të realizimit të veprimtarive të tyre, të licencuarit, subjekte të detyrimeve të shërbimit publik, deklarojnë ofrimin e shërbimeve të tilla, të cilat do të monitorohen nga ERE.

14. Këshilli i Ministrave miraton dokumentin për planifikimin afatgjatë, duke marrë parasysh mundësinë e palëve të treta që kërkojnë aksesin në sistem, në lidhje me sigurinë e furnizimit, efikasitetin e energjisë, menaxhimin të kërkesës për gaz, mbrojtjes së mjedisit dhe përmbushjes së qëllimeve për energji nga burimet e ripërtëritshme.

15. Ministria, në bashkëpunim me ERE-n, informon Sekretariatit të Energjisë për çdo masë të miratuar, sipas këtij ligji, ku vendosen detyrime të shërbimeve publike, duke përfshirë, gjithashtu, dhe masat për mbrojtjen e klientit dhe mjedisit, si dhe për efektet e mundshme në konkurrencë, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë informohet çdo 2 vjet, nëse kanë ndryshuar apo jo këto masa.

Neni 90

Furnizuesi me gaz natyror i mundësisë së fundit

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit, bazuar në konkurrencën efektive, mosdiskriminimin dhe transparencën.

2. Ministri përgjegjës për energjinë, bazuar në kushtet e përcaktuara, sipas pikës 1, të këtij neni, përzgjedh furnizuesin e mundësisë së fundit, të cilin ia propozon, për miratim, Këshillit të Ministrave.

3. Furnizuesi i mundësisë së fundit caktohet për një periudhë 3-vjeçare. Vendimi i caktimit përmban kushtet e shërbimit të furnizimit të mundësisë së fundit, informacionin, në lidhje me përcaktimin e çmimeve dhe ndryshimet e tij, si dhe kushtet kontraktore.

4. Furnizuesi i mundësisë së fundit i ofron furnizim me gaz natyror klientit fundor nëse furnizuesi i tij ka dalë nga tregu i gazit natyror, për shkak të rrethanave që janë jashtë kontrollit të tijose për shkak të ndonjë shkeljeje të kryer nga ana e tij, me kusht që klienti i sipërpërmendur të ketë humbur furnizimin me gaz natyror dhe ndaj tij të mos jenë aplikuar masa mbrojtëse nga furnizuesi i mëparshëm.

5. Furnizuesi, i cili nuk është i aftë të furnizojë me gaz klientin fundor, për rastet e përmendura në pikën 4, të këtij neni, është i detyruar të njoftojë, pa vonesë, furnizuesin e mundësisë së fundit, klientin fundor, ERE-n, OST-në dhe OSSH-në përgjegjëse për datën e pezullimit të furnizimit. Në një rast të tillë, klienti furnizohet automatikisht nga furnizuesi i mundësisë së fundit, me kusht që, nga ana e tij, të jetë depozituar një aplikim paraprak pranë furnizuesit të mundësisë së fundit.

6. Në rastin kur furnizuesi i klientit ndërpret veprimtarinë, për shkak të heqjes së licencës, ERE informon furnizuesin e mundësisë së fundit, klientin fundor, OST-në dhe OSSH-në përgjegjëse për heqjen e licencës, jo më vonë se 15 ditë nga data që licenca në fjalë nuk është më e vlefshme ose nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të ERE-s për heqjen e licencës.

7. OST-ja dhe OSSH-ja paraqesin informacion për furnizuesit e mundësisë së fundit, për klientët që janë transferuar te furnizuesi i mundësisë së fundit brenda 5 ditëve nga njoftimi, sipas pikave 5 e 6 të këtij neni.

8. Procedura për daljen e një furnizuesi nga tregu i gazit natyror përcaktohet nga rregullat e tregut.

9. Furnizuesi i mundësisë së fundit mund të furnizojë klientin fundor për një periudhë kohore jo më të gjatë se 2 muaj. Në rast se klienti fundor nuk arrin të lidhë marrëveshje me një furnizues të ri, pas kalimit të afatit të sipërpërmendur, operatori i sistemit, në rrjetin e të cilit është lidhur klienti, ndërpret shpërndarjen e gazit natyror.

10. ERE harton dhe miraton rregullat operationale për furnizuesin e mundësisë së fundit.

11. ERE miraton metodologjinë për përcaktimin e tarifave të furnizimit që realizohet nga furnizuesi i mundësisë së fundit. Furnizuesi i mundësisë së fundit do të zbatojë tarifën e miratuara nga ERE, për gazin natyror, në përputhje me metodologjinë e miratuar.

12. Tarifën e furnizimit të gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit duhet të jenë më të larta se tarifën mesatare të tij për furnizimin e klientëve të ngjashëm, të cilët furnizohen në tregun e gazit natyror, ose më të larta se çmimi i furnizimit të klientëve të ngjashëm që furnizohen në treg, me kusht që gazi natyror i kontraktuar nga furnizuesi i mundësisë së fundit të sigurohet mbi bazën e një procedure konkurruese dhe me çmimin e ofertës më të ulët në treg, përveçse në raste kur ekziston vetëm një ofertë, si furnizuesi i mundësisë së fundit. Në këtë rast, ERE e bazon vendosjen e çmimit sipas metodës krahasimore, referuar furnizuesve të ngjashëm në vendet fqinje.

Detyrimet e furnizuesit të mundësisë së fundit

1. Furnizuesi i mundësisë së fundit duhet të organizohet si person juridik, të funksionojë i ndarë nga veprimtaritë e tjera të sektorit të gazit natyror, të mbajë të ndara llogaritë financiare, si dhe të përgatisë raporte financiare, në lidhje me përmbushjen e detyrimit të mundësisë së fundit.
2. Kontratat për furnizimin me gaz natyror të klientëve fundorë, që furnizohen nga furnizuesi i mundësisë së fundit, konsiderohen si të lidhura që nga dita që ka filluar furnizimi fizik i klientit fundor, pavarësisht nëse është kërkuar apo jo nga këta klientë fundorë, në përputhje me rregullat dhe kushtet e parashikuara në rregullat e tregut, rregulloren për ndryshimin e furnizuesit, si dhe/ose rregullat operationale në fuqi.
3. Furnizuesi i mundësisë së fundit i dorëzon klientit të fundor një kontratë për furnizimin e gazit natyror, brenda 8 ditëve pas fillimit të furnizimit sipas mundësisë së fundit.
4. Furnizuesi i mundësisë së fundit mund të kërkojë ndërprerjen e përkohshme të furnizimit, për shkak të detyrimeve të papaguara nga klienti fundor, duke dorëzuar një kërkesë te operatori i sistemit përgjegjës.
5. Furnizuesi i mundësisë së fundit përgatit dhe publikon, të paktën një herë në vit, raportin, i cili përmban numrin e klientëve fundorë të furnizuar, sasinë e përgjithshme të gazit natyror të furnizuar dhe kohëzgjatjen mesatare të furnizimit të mundësisë së fundit. Ky raport duhet të vihet në dispozicion të ministrisë, ERE-s dhe të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Furnizimi i gazit natyror si detyrim i shërbimit publik

1. Klientët familjarë dhe klientët e vegjël jofamiljarë kanë të drejtë të furnizohen me gaz natyror nga furnizuesi që është ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.
2. Klientët e përmendur në pikën 1, të këtij neni, të cilët ndodhen në territorin e një zone të caktuar, mund të furnizohen nga një ose më shumë furnizues, ndaj të cilëve është vendosur një detyrim i shërbimit publik, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave dhe/ose të ERE-s.
3. ERE përcakton dhe miraton rregullat operationale për furnizuesit që kryejnë furnizimin e gazit natyror si një detyrim të shërbimit publik. Këto rregulla, mbi bazën e të cilave realizohet veprimtaria e furnizimit si detyrim i shërbimit publik, duhet të përfshijnë, ndër të tjera, të drejtat dhe detyrimet e tyre, afatin e furnizimit, përfundimin e detyrimeve të tyre dhe çështje të tjera, që konsiderohen të rëndësishme nga ERE. Jo më vonë se data 31 mars e çdo viti, këta furnizues, me aprovimin paraprak të ERE-s, nxjerrin një raport vjetor, lidhur me veprimtaritë e ofrimit të furnizimit të shërbimit publik gjatë vitit paraardhës. Ky raport u vihet në dispozicion Këshillit të Ministrave dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
4. Në rast se objektivat e shërbimit publik për klientët familjarë dhe klientët e vegjël nuk mund të arrihen ndryshe, nën kushtet e tregut, ERE mund të rregullojë çmimet e përdoruesve fundorë, me kusht që këto çmime të përputhen me detyrimet dhe kushtet e përcaktuara në këtë ligj.
5. Në rastet kur ERE rregullon çmimet përfundimtare të gazit natyror për përdoruesit fundorë, jep një shpjegim të detajuar dhe të arsyetuar të këtyre rregullimeve dhe rrethanave përjashtimore në tregun e gazit, dhe justifikimin rreth domosdoshmërisë për caktimin e çmimeve rregulluese për përdoruesit fundorë, si një detyrim i shërbimit publik, që përputhet me kushtet e këtij neni.
6. ERE garanton se kategori të ndryshme klientësh nuk përfitojnë nga aplikimi i trajtimit dhe mbrojtjes së njëjtë dhe se rregullimi i çmimit të përdoruesve fundorë është në dispozicion vetëm për të garantuar ofrimin e shërbimit publik te klientët familjarë dhe të vegjël.
7. ERE garanton se çmimet e gazit, që janë objekt i rregullimit të çmimeve, me qëllim sigurim të ofrimit të shërbimit publik, duhet të reflektojnë kostot. Reflektimi i kostos duhet të shtrihet në kostot reale të furnizimit me gaz, duke përfshirë investimet e nevojshme, një normë të përshtatshme të kthimit të investimit, kostot e importeve, kostot e shërbimeve të furnizimit dhe të borxheve të këqija.
8. Furnizuesi, i cili ka detyrimin e shërbimit publik, duhet:
 - a) të sigurojë furnizim si një shërbim publik për të gjithë ata klientë fundorë që gëzojnë të drejtën nga ky lloj furnizimi;
 - b) të kryejë furnizimin në kuadër të shërbimit publik, ekskluzivisht, sipas tarifave të përcaktuara nga ERE, të cilat bazohen në kushte të rregulluara;
 - c) të ndërmarrë masa që të realizojë një furnizim të sigurt, të besueshëm dhe cilësor të këtyre klientëve fundorë, sipas kuadrit të shërbimit publik;

ç) të ndërmarrë masa për aplikimin e tarifave më të pranueshme të gazit natyror për furnizimin e klientëve fundorë, në kuadër të shërbimit publik, të cilat janë pjesë përbërëse e tarifave në bazë të kushteve të rregulluara.

9. Klientët familjarë, shoqëritë e vogla dhe, kur është e zbatueshme, klientët në nevojë, në vend që të transferohen te furnizuesit e mundësisë së fundit, në bazë të nenit 90, të këtij ligji, furnizohen nga furnizuesi, sipas detyrimit të shërbimit publik, pa qenë nevoja e paraqitjes së ndonjë aplikimi të veçantë prej tyre, nëse furnizuesi i tyre ka dalë nga tregu i gazit natyror për shkak të rrethanave, jashtë kontrollit të tyre, dhe se klientët e sipërpërmendur kanë humbur furnizimin me gaz natyror pandojnë formë mbrojtjeje, pavarësisht faktit nëse klientët në fjalë janë përballur me një dalje të paplanifikuar, të planifikuar apo për shkelje të rënda, nga ana e furnizuesit, në mospërbushje të detyrimeve të tij.

10. Kontrata për furnizimin me gaz natyror për klientët fundorë, në kuadër të ofrimit të shërbimit të furnizimit publik, konsiderohet e lidhur në datën në të cilën furnizimi është bërë fizikisht, ku klientët në fjalë janë furnizuar, pavarësisht faktit nëse kanë bërë kërkesë apo jo, në përputhje me rregullat e zbatueshme dhe kushtet e parashikuara në rregulloren për ndryshimin e furnizuesit dhe/ose rregullat operationale të aplikuara.

11. Furnizuesi, i cili ka detyrimin e ofrimit të shërbimit publik, duhet t'i dorëzojë klientit fundor kontratën e lidhur me shkrim, brenda 8 ditëve nga dita në të cilën ka filluar furnizimi.

12. ERE përcakton datën kur përfundon aplikimi i çmimit të rregulluar për klientët familjarë dhe shoqëritë e vogla, si dhe planin përkatës, duke treguar qartë natyrën e përkohshme të një rregullimi të tillë të çmimit.

13. ERE kryen rishikime të metodologjive dhe nivelit të çmimeve të miratuara. Këto rishikime, pas konsultimit paraprak me ministrinë, i paraqiten Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, i cili, bazuar në një analizë të tregut rajonal, mund të propozojë masa të mëtejshme për ndërprerjen e aplikimit të çmimeve të rregulluara për disa kategori të caktuara.

14. Furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik harton një raport vjetor për veprimtarinë e furnizimit të realizuar si detyrim i shërbimit publik për vitin paraardhës. Ky raport duhet të miratohet nga ERE, jo më vonë se data 31 mars e çdo viti, dhe vihet në dispozicion të Këshillit të Ministrave dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Neni 93

Kontrata standarde e furnizimit

1. ERE miraton një kontratë standarde të furnizimit, që lidhet ndërmjet klientëve të përcaktuarnë pikën 1, të nenit 92, të këtij ligji, dhe furnizuesit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

2. Furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik është i detyruar të nënshkruajë një kontratë standarde furnizimi me çdo klient familjar dhe klientë të vegjël jofamiljarë, të cilët kërkojnë të furnizohen me gaz natyror.

3. Furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik mund të refuzojë furnizimin ose të kërkojë ndërprerjen e furnizimit me gaz natyror të një klienti, nëse:

a) tubacioni i lidhjes ose pajisjet e klientit fundor përbëjnë rrezik për jetën, shëndetin e njerëzve, mjedisin ose sigurinë e pronës;

b) klienti nuk ka përmbushur detyrimet e tij, të përcaktuara në kontratën standarde të furnizimit, pavarësisht njoftimit të dërguar nga furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

4. Furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik ka të drejtë të refuzojë furnizimin e një klienti, për aq kohë sa vërtetohen rrethanat e parashikuara në pikën 3 të këtij neni.

5. Furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik mund të ndërpresë furnizimin eklientëve fundorë në kushtet e forcës madhore.

KREU VII

MBROJTJA E KLIENTIT FUNDOR DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 94

Klienti fundor

1. Klienti fundor gëzon mbrojtje, sipas këtij ligji, akteve të tjera nënligjore të miratuara në bazë të tij dhe legjislacionit në fuqi, që rregullojnë mbrojtjen e klientit. Të gjithë klientët kanë të drejtë të zgjedhin furnizuesin e tyre, vendas ose të huaj, me çmime të parregulluara, sipas një marrëveshjeje furnizimi, e cila është në përputhje me rregullat e tregut dhe kushtet e përgjithshme për furnizim, të miratuara nga ERE.

2. Klienti fundor është i detyruar të paguajë detyrimet për gazin natyror të konsumuar, në përputhje me kushtet e përgjithshme dhe kushtet e tjera kontraktore. Kushtet dhe procedurat për faturimin, arkëtimin dhe pagesën e detyrimeve do të përcaktohen në kushtet e përgjithshme të furnizimit, të miratuara nga ERE, sipas nenit 95 të këtij ligji.

3. Çdo klient fundor ka të drejtë të informohet periodikisht dhe pa pagesë, për të dhënat në lidhje me sasinë e konsumuar dhe koston përkatëse të gazit natyror, me të cilin është furnizuar. ERE përcakton procedurën dhe formatin për vënien në dispozicion të klientit fundor të të dhënave të matjes dhe faturimit.

4. Klientët e mëdhenj jofamiljarë kanë të drejtë të kontraktojnë disa furnizues në të njëjtën kohë. ERE harton dhe miraton rregullat përkatëse për furnizimin nga disa furnizues.

5. Në rast të problemeve teknike në lëvrimin e gazit natyror, të cilat nuk janë shkaktuar nga objektet e klientëve fundorë, këta të fundit kanë të drejtë të kërkojnë ndreqjen e tyre brenda periudhës kohore më të shkurtër të mundshme, sipas detyrimeve dhe kushteve të përcaktuara në Kodin e Rrjetit.

6. Ndërprerjet e furnizimit me gaz natyror, për shkak të zbatimit të masave ndaj kufizimit apo shtrembërimit të konkurrencës në treg, nuk konsiderohen si probleme teknike, sipas pikës 5 të këtij neni.

7. Klientët fundorë do të përdorin gaz natyror sipas kushteve, mënyrave dhe qëllimeve të përcaktuara në këtë ligj, në Kodin e Rrjetit të Transmetimit, në Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes, në akte të tjera në fuqi dhe në përputhje me detyrimet kontraktuale përkatëse.

8. Mbrojtja e të drejtave të klientëve fundorë sigurohet nga ERE, ministria përgjegjëse për energjinë dhe ministria përgjegjëse për tregtinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 95

Kontrata e furnizimit me gaz natyror

1. Të drejtat dhe detyrimet e çdo furnizuesi dhe klienti fundor rregullohen sipas kontratës së furnizimit me gaz natyror.

2. Kushtet e kontratës për furnizimin me gaz natyror janë në përputhje me kushtet epërgjithshme të miratuara nga ERE, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

3. Kushtet e përgjithshme të furnizimit me gaz natyror duhet, në veçanti, të përmbajnë:

a) mënyrën për ndryshimin e kushteve të kontraktuara të furnizimit;

b) të drejtën e klientit fundor për zgjidhjen e kontratës;

c) mënyrën e njoftimit të rritjes të tarifave para hyrjes në fuqi të tyre;

ç) mënyrën e njoftimit të tarifave të vlefshme, afateve standarde dhe kushteve, në veçanti për ato që lidhen me aksesin dhe përdorimin e shërbimeve;

d) kushtet që duhet të respektojë klienti fundor, lidhur me konfidencialitetin e mbajtjes të të dhënave të caktuara të kontratës, si të dhënat e matjes, tarifave dhe mënyrën e ndryshimit të tyre, përlllogaritjet dhe faturat.

4. Çdo furnizues siguron që kushtet, të cilat rrjedhin nga kontrata për furnizimin me gaz natyror, që ai ofron, janë në përputhje me kushtet e përgjithshme. Kushtet e kontratës duhet të jenë të hartuara në mënyrë të qartë e të kuptueshme dhe nuk duhet të përfshijnë kushte të tilla që pengojnë ushtrimin e të drejtave të klientëve. Furnizuesi siguron që klientët fundorë janë të mbrojtur nga mënyrat e pandershme dhe mashtruese të shitjes.

5. Çdo furnizues përgatit dhe publikon kushtet standarde për përfundimin e kontratës përfurnizimin e gazit natyror, të cilat përmbajnë kushtet e vendosura paraprakisht. Furnizuesi, gjithashtu, publikon, në mënyrë të përshtatshme, çmimet e aplikueshme apo tarifave të rregulluara.

6. Në bazë të kushteve të përgjithshme, të gjithë klientëve duhet t'u garantohej që:

a) u është dhënë e drejta e një kontrate me furnizuesit e tyre, e cila specifikon:

i) identitetin dhe adresën e furnizuesit;

ii) shërbimet e ofruara, nivelet e cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe kohën për fillimin e lidhjes;

iii) llojet e shërbimit të mirëmbajtjes së ofruar, nëse ofrohet;

iv) mënyrat se si mund të merret informacioni i përditësuar për të gjitha tarifave dhe pagesat e mirëmbajtjes;

v) kohëzgjatjen e kontratës, kushtet për rinovimin dhe përfundimin e shërbimeve të kontratës, mundësinë e ndonjë të drejte për t'u tërhequr;

vi) çdo kompensim dhe rimbursim të arritur, që zbatohet nëse nuk plotësohen nivelet e shërbimit të kontraktuar;

vii) mënyrën për fillimin e procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në përputhje me nenin 98 të këtij ligji;

b) u është dhënë njoftimi i duhur për çdo nismë për ndryshimin e kushteve kontraktuale dhe janë informuar për të drejtën e tyre për t'u tërhequr, kur jepet njoftimi;

Furnizuesi ngarkohet me detyrimin që të njoftojë, drejtpërdrejt, klientët e tij për çdo rritje të detyrimeve financiare, përpara se rritja të bëhet efektive;

c) kanë marrë informacion, në mënyrë transparente, për çmimet, tarifave e aplikueshme, afatet dhe kushtet standarde, veçanërisht për aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të gazit natyror;

ç) do të përfitojnë nga procedurat transparente dhe të thjeshta për të trajtuar ankesat e tyre, të cilat sigurojnë zgjidhjen e tyre në një kohë të arsyeshme dhe rimbursimin e klientëve, kur është e mundur;

d) janë të informuar rreth të drejtave të tyre për t'u furnizuar, sipas këtij ligji, me gaz natyror, menjë cilësi të caktuar dhe çmime të publikuara ose tarifa të rregulluara.

7. Dispozitat e kontratës për furnizimin me gaz natyror janë të drejta, proporcionale, të shprehura në mënyrë të qartë e të kuptueshme dhe i njoftohen, paraprakisht, klientit fundor.

8. Kontrata për furnizimin me gaz natyror nuk përmban kushte që pengojnë apo vështirësojnë drejtën e klientit për ndërprerjen e njëanshme të kontratës, të drejtën e tij për ndryshimin e furnizuesit dhe ngarkimin e tij me detyrime financiare për këtë ndryshim.

9. ERE, në miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës, konsultohet paraprakisht me ministrinë, ministrinë përgjegjëse për tregtinë dhe çdo institucion apo palë të interesuar.

Neni 96

Detyrimet e furnizuesit ndaj klientëve fundorë

1. Çdo furnizues siguron informacionin e nevojshëm për klientët fundorë, lidhur me të drejtat e tyre dhe mjetet në dispozicion për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Ky informacion u siguron klientëve fundorë:

a) njoftimin, në mënyrë transparente, për tarifën e aplikueshme, detyrimet dhe kushtet standarde të aksesit dhe përdorimit të shërbimeve;

b) ofrimin e disa mundësive për kryerjen e pagesës së detyrimeve, pa diskriminuar klientët fundorë;

c) ofrimin e sistemit të parapagimit, i cili duhet të jetë i drejtë dhe të reflektojë konsumin në vlera reale;

ç) marrjen e informacionit, për mundësinë e ndryshimit lirisht të furnizuesit;

d) marrjen e udhëzimeve për zbatimin e procedurave transparente, të thjeshta dhe ekonomike, në lidhje me trajtimin e ankesave të klientëve, veçanërisht, nivelin e cilësisë së shërbimit;

dh) marrjen e informacionit për konsumin dhe koston e gazit natyror. Ky informacion ofrohet duke e vënë në dispozicion, brenda një afati kohor të arsyeshëm, i cili merr parasysh sistemin matëse të klientit fundor, dhe pa kosto shtesë për klientin fundor;

e) marrjen e raportit përfundimtar të mbylljes, jo më vonë se 6 javë nga momenti i ndryshimit të furnizuesit.

2. Furnizuesi duhet, gjithashtu:

a) të ngrejë qendrat e kujdesit të klientit, të cilat japin informacion për ankesat dhe pyetjet e tyre;

b) të krijojë struktura të posaçme për shqyrtimin e ankesave të klientëve fundorë, në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë mbrojtjen e klientëve;

c) të trajtojë ankesat e klientëve, në lidhje me shërbimet e rregulluara sipas kontratës për përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes.

3. Çdo furnizues njofton klientin fundor, paraprakisht, brenda një afati të arsyeshëm, për ndryshimin e kushteve të kontratës. Klientët fundorë janë të lirë të zgjidhin kontratat e tyre nëse ata nuk pranojnë kushtet e reja që u janë njoftuar.

4. Çdo furnizues mund të furnizojë klientët fundorë vetëm nëse operatori i sistemit përgjegjës, me të cilin klienti fundor ka të lidhur instalimet, i konfirmon furnizuesit që klienti plotëson kushtet për furnizim të sigurt me gaz natyror.

5. Çdo furnizues përgatit dhe publikon programin e tij të veprimit për:

a) dhënien e ndihmës ndaj klientëve fundorë, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata dhe kanë për qëllim të parandalojnë pezullimin e furnizimit;

b) garantimin e shërbimit të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë që jetojnë në zonat e thella;

c) marrjen e masave për nxitjen e prodhimit të gazit natyror nga burimet e ripërtëritshme të energjisë.

6. Çdo furnizues njofton rregullisht klientët e vet fundorë rreth masave për përmirësimin e efikasitetit në konsumin final të energjisë.

7. Çdo furnizues, në bazë të kontratave të lidhura, ka të drejtë të lëshojë fatura dhe të mbledhë pagesat për:

a) përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe/ose të shpërndarjes;

b) sigurimin e shërbimeve ndihmëse;

c) tarifa të tjera, të përcaktuara me aktet ligjore në fuqi.

8. Çdo furnizues lëshon një faturë, mbi bazën e sasisë së gazit të konsumuar dhe periudhës së faturimit, e cila duhet të jetë e qartë dhe e kuptueshme.

9. Çdo furnizues informon rregullisht klientët e vet fundorë, në lidhje me furnizimin me gaz natyror, përfshirë edhe çështjet për mjedisin. Informacioni i ofruar nga furnizuesi për klientët fundorë duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga ERE.

10. ERE siguron që njoftimet e dhëna nga furnizuesit e klientëve fundorë janë të qarta dhe të krahasueshme. ERE mund të vendosë që elemente të këtyre njoftimeve të vihen në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut të gazit natyror, duke siguruar që informacioni konfidencial tregtar, rreth disa pjesëmarrësve ose transaksioneve të caktuara të mos publikohet.

11. ERE mbikëqyr mënyrën e trajtimit të ankesave të klientëve fundorë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 97

Mbrojtja e klientëve në nevojë

1. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energjinë, Ministrinë e Financave, si dhe në konsultim me ERE-n, grupet e interesit apo subjektet e tjera, harton kriteret dhe procedurat për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Kriteret për përfitimin e statusit të klientit në nevojë marrin në konsideratë:

a) klientët me të ardhura më të ulëta, të cilët e përdorin gazin natyror për furnizimin e përhershëm të banesës së tyre;

b) konsumin maksimal të gazit për person, që përlllogaritet mbi bazën e periudhave sezonale dhekonsumit mesatar deri në 30 m³/muaj për një familje deri në katër anëtarë;

c) mënyrën e përkrahjes së drejtpërdrejtë nga Buxheti i Shtetit.

3. Klientët familjarë, të cilët përfitojnë mbështetje financiare nga Këshilli i Ministrave për të paguar shërbimin e furnizimit me gaz, nuk duhet të lejohen të përdorin këto fonde të tilla për qëllime të tjera.

4. Klientët familjarë, që kanë të drejtën e furnizimit të shërbimit publik dhe që gëzojnë statusin e klientit në nevojë, kanë të drejtë për mbrojtje të veçantë, në përputhje me këtë ligj dhe çdo rregull tjetër, hartuar në bazë të pikës 1 të këtij neni.

5. Nëse, për shkak të ndryshimit të rrethanave, klienti humb statusin e klientit në nevojë, ky klient hiqet nga regjistri, por të dhënat e tij ruhen për një periudhë prej 5 vjetësh, nga momenti i regjistrimit. Operatori përgjegjës i sistemit të shpërndarjes, brenda 8 ditëve, duhet të njoftojë me shkrim klientin në nevojë dhe furnizuesit e tij për heqjen e këtij klienti nga regjistri përkatës.

6. Furnizimi i klientëve në nevojë kryhet nga furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

7. Furnizuesi, i cili është i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, lidh, brenda 5 ditëve nga dita e regjistrimit të klientit në nevojë, te operatori i sistemit të shpërndarjes, kontratën për furnizimin me gaz natyror.

8. Operatorët e sistemit të shpërndarjes mbajnë regjistrin e klientëve në nevojë, i cili përmban emrin dhe mbiemrin e klientit në nevojë, numrin e identifikimit personal të tij, adresën në të cilën ai është furnizuar me gaz, numrin rendor, në të cilin është radhitur në listë, llojin e trajtimit specifik që gëzon dhe përfitimet që i janë dhënë atij nëpërmjet statusit të klientit në nevojë.

9. Të drejtat dhe detyrimet e klientëve në nevojë, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen nga operatori i sistemit të shpërndarjes. Furnizuesi i paraqet klientit në nevojë kontratën dhe e informon rreth të drejtave dhe kushteve të furnizimit, sipas shërbimit universal të furnizimit.

10. Klienti në nevojë furnizohet me gaz natyror sipas tarifave të miratuara nga ERE dhe në përputhje me nenin 92 të këtij ligji.

11. Furnizuesi, që furnizon me gaz natyror klientin në nevojë, mund të ndërpresë shërbimin, bazuar në kushtet specifike për këtë kategori klientësh, të miratuara nga ERE.

12. Kontrata e furnizimit të klientëve në nevojë përfundon në fund të muajit të dytë, nga momenti i çregjistrimit të klientit, si klient në nevojë, prej Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. OSSH-ja dërgon informacion te furnizuesi, për klientët e çregjistruar, sipas njoftimit për daljen nga kategoria e klientit në nevojë, në fund të çdo muaji.

Neni 98

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. ERE zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet të licencuarve në sektorin e gazit natyror si dhe ndërmjet tyre dhe klientëve. Ky përcaktim nuk përjashton të drejtën e klientit për të paraqitur ankesën te organet e tjera kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

2. ERE miraton rregulloren për procedurat dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Vendimi i ERE-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është i detyrueshëm për palët, deri në marrjen e një vendimi pezullimi ose të formës së prerë nga një gjykatë kompetente.

4. ERE miraton standardet e përgjithshme për trajtimin e ankesave nga ana e të licencuarve.

5. Për ankesat e palëve të interesuara ndaj një operatori sistemi, që kanë të bëjnë me aksesin në hapësirat e depozitimit, ERE merr vendim brenda 2 muajve, pas marrjes së ankesës. Kjo periudhë dymujore mund të zgjatet edhe me 2 muaj të tjerë, kur nga ERE kërkohet informacion shtesë ose kur ankuesi bie dakord.

KREU VIII

INSPEKTIMI, MBIKËQYRJA, KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONET

Neni 99

Organi përgjegjës për mbikëqyrjen dhe inspektimin

1. Ministria është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të miratuara në bazë të tij, me përjashtim të akteve dhe kompetencave rregullatore të Entit Rregullator të Energjisë.

2. Ministria mbikëqyr zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, përsa i përket aktivitetit për ndërtimin dhe përdorimin e infrastrukturës së sektorit të gazit dhe rregullave teknike të shfrytëzimit të saj nga shoqëritë që kryejnë veprimtari në sektorin e gazit natyror.

3. Ministria dhe ERE, brenda fushës së kompetencave të tyre, mbikëqyrin zbatimin e detyrimevetë marra përsipër për shërbimin publik, sikurse përcaktohet në kreun VI, të këtij ligji, “Detyrimet e shërbimit publik”.

4. Ministria mbikëqyr zbatimin e planeve dhe programeve, miratimi i të cilave është përcaktuar në këtë ligj dhe në aktet përkatëse ligjore në fuqi.

Neni 100

Mbikëqyrja dhe inspektimi

1. Në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj, ministria ushtron funksionet e saj mbikëqyrëse, nëpërmjet strukturave të saj dhe inspektoratit shtetëror përgjegjës për gazin. Ushtrimi i funksioneve mbikëqyrëse të ministrisë kryhet mbi bazën e rregullave dhe procedurave të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

2. Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, ministria dhe inspektorati shtetëror përgjegjës për gazin njoftojnë subjektet që i nënshtrohen mbikëqyrjes për parregullsitë e mangësitë e identifikuar dhe përcaktojnë një afat kohor për riparimin e tyre.

3. Nëse subjektet, që i nënshtrohen mbikëqyrjes, nuk përmbushin detyrimin për riparimin e parregullsive dhe mangësive, brenda afatit të përcaktuar, ministria ndërmerr masat përkatëse organizative për riparimin e tyre.

4. Në rastet kur parregullsitë dhe mangësitë e identifikuar cenojnë jetën, shëndetin dhe pronën qytetarëve ose ndikojnë në realizimin e funksioneve të ministrisë, sipas këtij ligji, ministria, menjëherë, informon Këshillin e Ministrave dhe autoritetet e tjera përgjegjëse dhe propozon masat për riparimin e tyre.

5. Në rastet kur parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara, të përmendura në pikën 2, të këtij neni, janë identifikuar gjatë mbikëqyrjes së shoqërive që kryejnë veprimtari gazi të rregulluara dhe nuk janë eliminuar brenda afatit të përcaktuar, ministria i kërkon Entit Rregullator të Energjisë që të fillojë procedurën për heqjen e licencës, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 101

Inspektorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit

1. Inspektorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit kryen inspektimin e objekteve përtransportin, depozitimin dhe shpërndarjen e gazit natyror, si dhe të objekteve të tjera të gazit, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe rregulloren përkatëse, të miratuar nga ministri.

2. Objekti i këtij inspektimi përfshin zbatimin e dispozitave të parashikuara në këtë ligj, akteve nënligjore, rregulloreve, rregullat, standardet, specifikimet teknike dhe normat e cilësisë, në lidhje me performancën e veprimtarive të gazit nga ana e subjekteve që kryejnë veprimtari gazi, subjekteve të sektorit publik dhe shfrytëzuesve të sistemit të gazit.

3. Gjatë kryerjes së inspektimit, inspektorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit, mund të angazhojë ekspertë nga organet dhe institucionet apo subjekte të tjera, për kryerjen e detyrave të caktuara.

Neni 102

Organizimi i inspektimeve të kombinuara

Ministri, në bashkëpunim me ministrat e tjerë, urdhëron kryerjen e inspektimeve të kombinuara, në rastet kur:

- a) është e nevojshme për të eliminuar një rrezik të menjëhershëm për jetën, shëndetin dhe pronën e qytetarëve;
- b) është e nevojshme të merren masa urgjente, që nuk mund të shtyhen;
- c) është e nevojshme, për shkak të kompleksitetit të mbikëqyrjes apo për rëndësinë e eliminimit të defekteve;
- ç) është e nevojshme për të kryer auditimin e shoqërive të gazit të rëndësisë së veçantë;

d) konsiderohet se mbikëqyrja e kombinuar mund të kryhet më shpejt dhe me kosto më të ulët për të dyja palët që janë subjekt i mbikëqyrjes dhe kontrollit të inspektorëve;

dh) është e nevojshme që të rishqyrtohen përfundimet e një inspektimi apo çdo nisme apo ankese të bërë për çështje që janë në kompetencë të autoriteteve të inspektimit.

Neni 103

Detyrat e subjekteve që kryejnë veprimtari të gazit, subjekteve të sektorit publik dhe përdoruesve të sistemit të gazit

Subjektet që kryejnë veprimtari të gazit dhe përdoruesit e sistemit të gazit janë të detyruar të veprojnë sipas kërkesës apo urdhrat të lëshuar nga autoriteti inspektues, i përcaktuar në nenin 101, të këtij ligji, dhe, në veçanti, duhet:

- a) të mundësojnë kryerjen e inspektimit;
- b) të sigurojnë informacion për dokumentet dhe të dhënat e nevojshme për mbikëqyrjen;
- c) të sigurojnë kushtet e nevojshme për përcaktim të gjendjes faktike;

ç) të mundësojnë, në afatin e përcaktuar, aksesin në objektet, produktet ose çfarëdo dokumentesh të tjera, që janë objekt i inspektimit;

d) të ndërpresin veprimtarinë gjatë inspektimit, në bazë të kërkesës me shkrim nga autoriteti inspektues, kur shihet e nevojshme, me qëllim kryerjen e inspektimit dhe përcaktimin e gjendjes faktike;

dh) t'i paraqesin inspektorit, ose të përgatitin të dhëna të sakta dhe të plota, raporte, materiale apo dokumente të tjera të nevojshme, me qëllim kryerjen e inspektimit, mbi bazën e kërkesës me shkrim dhe brenda një afati të përcaktuar në kërkesën e organit të inspektimit.

Neni 104

Matja e gazit natyror

1. Operatorët e sistemit të transmetimit, të sistemit të shpërndarjes, të hapësirave të depozitimit dhe të terminaleve të GNL-së, si dhe linjat direkte, janë përgjegjës për veprimtarinë matëse dhe shërbimin e leximit të matësve, sipas regjistrimeve të aparateve matëse në instalimet e tyre përkatëse të gazit natyror. Sistemi i matjes së instaluar pranë klientëve është pronë e operatorëve respektivë. ERE miraton Kodin e Matjes për sistemet e matjes dhe matjen e gazit natyror, të hartuar nga operatorët e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.

2. Me miratimin e ERE-s, operatorët e sistemit të transmetimit, të sistemit të shpërndarjes, të hapësirave të depozitimit dhe të terminaleve të GNL-së mund të kontraktojnë operatorë të pavarur për kryerjen e veprimtarisë së matjes dhe/ose shërbimeve të leximit të matësve në rrjetet e tyre përkatëse.

3. Sasia e gazit natyror e transportuar, e depozituar, e furnizuar apo e shpërndarë te klientët fundorë, nëpërmjet instalimeve dhe impianteve të operatorëve të sistemit të transmetimit, të sistemit të shpërndarjes, të hapësirave të depozitimit, të terminaleve të GNL-së, si dhe në linjat direkte, matet nëpërmjet pajisjeve matëse, në përputhje me rregullat specifike matëse, të përcaktuara në Kodin e Rrjetit, rregullat e përdorimit për sistemin e depozitimit të gazit, rregullat e përdorimit për terminalin e GNL-së, sikurse përcaktohet në nenet 44, 55, 67 dhe 74, të këtij ligji, si dhe në legjislacionin në fuqi, lidhur me fushën e metrologjisë.

Operatorët e sistemit të transmetimit, të sistemit të shpërndarjes, të hapësirave të depozitimit dhe të terminaleve të GNL-së janë të detyruar t'i mundësojnë në çdo kohë klientit leximin e aparateve matëse të gazit natyror. Ky shërbim do të sigurohet pa pagesë.

4. Instalimi, mirëmbajtja dhe verifikimi i saktësisë së matësit bëhen nga operatorët e sistemit të transmetimit, të sistemit të shpërndarjes, të hapësirave të depozitimit, të terminaleve të GNL-së dhe në linjat direkte, me shpenzimet e vet operatorëve.

Matësi dhe/ose sistemi matës i gazit natyror, pas instalimit, duhet të vulozet nga operatori i sistemit me vulë të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë. Matësit e gazit natyror duhet të jenë në përputhje me legjislacionin për instrumentet matëse.

Klasa e saktësisë së matësve të gazit natyror përcaktohet në Kodin e Matjes, të miratuar nga ERE.

5. Në rast kur në veprimtarinë e matjes implementohen sisteme matëse inteligjente te klientët fundorë, implementimi

i tyre është subjekt i një vlerësimi paraprak të kryer nga operatorët e sistemit, që duhet të marrë në konsideratë kostot, përfitimet që do të ketë tregu dhe klientët, sigurinë teknike, mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të qytetarëve. Ky vlerësim miratohet nga ERE.

Në bazë të vlerësimit të realizuar, operatori i sistemit përgatit një kalendar për implementimin e sistemeve inteligjente të matjes, brenda një periudhe 10-vjeçare, i cili miratohet nga ministri përgjegjës për energjinë.

6. ERE kërkon prej operatorëve të sistemit të transmetimit, operatorëve të sistemit të shpërndarjes, të hapësirave depozituese dhe të terminaleve të GNL-së të kryejnë, në mënyrë periodike, kontrolle të aparateve matëse për çdo instalim të gazit natyror, si dhe për çdo kategori klientësh.

Periodiciteti i verifikimeve të matësve të instaluar te klienti përcaktohet në Kodin e Matjes. Gjatë përcaktimit të periodicitetit të verifikimit të matësve, ERE merr edhe mendimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

7. Verifikimi i matësve të gazit natyror kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) ose nga një person juridik, i autorizuar për këtë qëllim, sipas ligjeve në fuqi.

8. Aparatet matëse verifikohen përpara vënies në përdorim, nëpërmjet metodës së kampionit, në bazë të përzgjedhjes rastësore dhe në mënyrë periodike. Verifikimi i matësve mund të realizohet me kërkesë të operatorit të sistemit të transmetimit, të sistemit të shpërndarjes, të hapësirave të depozitimit dhe të terminaleve të GNL-së. Verifikimi mund të realizohet në terren, aty ku matësi është i instaluar, pranë laboratorit të DPM-së apo personit juridik të autorizuar.

9. Gjatë procesit të verifikimit të matësve të gazit natyror nga DPM-ja ose nga personi juridik i autorizuar duhet të jetë i pranishëm përfaqësuesi i operatorit të sistemit përkatës dhe klienti fundor.

DPM miraton procedurat e verifikimit të matësve të gazit natyror.

10. Kostot financiare për verifikimin, përpara vënies në përdorim, verifikimin periodik apo verifikime të matësit, të iniciuara nga operatori i sistemit përkatës, përballohen nga ky i fundit.

ERE, gjatë miratimit të tarifave përkatëse, merr në konsideratë këto kosto të shkaktuara operatorit.

11. Tarifat për shërbimet e kryera nga DPM-ja apo personi juridik i autorizuar, sipas këtij neni, janë të liberalizuara, me kusht që të mos tejkalojnë tarifën tavan, të miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për ekonominë.

12. ERE miraton kontratën tip ndërmjet operatorit të sistemit dhe DPM-së ose subjektit të autorizuar nga ana e saj, për verifikimin e matësve.

13. Çdo ndërhyrje në sistemin e matjes dhe matësit e gazit natyror, nga persona të paautorizuar, është e ndaluar dhe ndëshkohet sipas akteve ligjore në fuqi.

14. Kur klienti dyshon në saktësinë e aparatit matës, paraqet një kërkesë me shkrim pranë operatorit rrjetit, si dhe çdo institucioni tjetër përgjegjës për mbrojtjen e klientëve. Matësi i gazit natyror verifikohet nga DPM-ja ose një person juridik i autorizuar/licencuar, me kusht që ky i fundit të mos jetë përfshirë më parë në verifikimin e tij.

15. Kur, pas verifikimit, konstatohen pasaktësi në matës dhe nuk ka prova të dëmtimeve me dashje, të bëra nga klienti fundor, shpenzimet për verifikimin, riparimin ose zëvendësimin e matësit mbulohen nga operatori i sistemit përkatës. Në këtë rast bëhen përllogaritjet përkatëse të sasisë së gazit të faturuar më shumë ose më pak, si rezultat i pasaktësisë në matës, duke përcaktuar edhe mënyrën e rimbursimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Matjes.

Kur verifikimi i matësit është bërë me kërkesë të klientit dhe gjatë verifikimit të tij nuk konstatohen pasaktësi, shpenzimet e verifikimit paguhen nga klienti që ka paraqitur ankesën.

16. Nëse ka prova se matësi është dëmtuar ose në të është ndërhyrë nga ana e klientit fundor, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi.

17. Procedura për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimi i saj dhe afatet e njoftimit të kërkuarit miratohen me vendim të ERE-s.

Neni 105

Procedimi në rast moszbatimi të kërkesave ligjore

1. Nëse inspektori nga inspektorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit, gjatë kryerjes së inspektimit, identifikon se dispozitat e këtij ligji, rregulloret e tjera, rregullat, standardet, specifikimet teknike dhe normat e cilësisë nuk kanë qenë siç kërkohet, ose janë zbatuar në mënyrë të papërshtatshme, miraton një vendim, me anë të të cilit:

a) urdhëron riparimin e mangësive të identifikuara, të cilat ndikojnë negativisht në funksionimin e impianteve e pajisjeve, dhe përcakton afatin për këtë riparim;

b) ndalon përdorimin e objektit, impiantit, pajisjes ose instalimit, kur subjekti nuk ka arritur të riparojë parregullsitë e identifikuara brenda afatit të caktuar;

c) ndalon përdorimin ose ndërtimin e objektit, impiantit, pajisjes ose instalimit, derisa parregullsitë e identifikuara të jenë riparuar.

2. Në rast të përsëritjes së shkeljeve, sipas pikës 1, të këtij neni, inspektori propozon vendosjen e sanksioneve, sipas përcaktimeve të nenit 106 të këtij ligji.

3. Inspektorati njofton ministrinë për shkeljet, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, si dhe informon Entin Rregullator të Energjisë për vendimin e marrë dhe, në rast mosrespektimi të masave të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, kërkon heqjen e licencës së veprimtarisë së gazit.

Neni 106

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme të dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen nga institucioni përgjegjës si më poshtë:

a) dënohen nga ERE me gjobë nga 0,1 për qind deri në 0,5 për qind të të ardhurave vjetore të vitit paraardhës të të licencuarit shkeljet e kryera nga subjektet e licencuara:

i) kryerja e një veprimtarie në sektorin e gazit natyror pa licencën përkatëse, të lëshuar nga ERE, sikurse parashikohet në pikën 1, të nenit 22, të këtij ligji. Gjithashtu, do të konsiderohen kundërvajtje administrative veprimet e kryera nga subjektet që i nënshtrohen zbatimit të këtij ligji, të realizuara në kundërshtim me kushtet e parashikuara në licencë, sipas parashikimeve të neneve 50, pika 4, 75, 85, pika 4, si dhe veprimet në kundërshtim me shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “gj”, të pikës 1, të nenit 41, të këtij ligji;

ii) refuzimi i paraqitjes së të dhënave, informacioneve, raporteve periodike apo dërgimi me vonesë i tyre, ose dërgimi i të dhënave të pasakta nga i licencuari, në kundërshtim me nenet 17, pika 1/a, 37, pika 6, 39, pika 2, 40, pika 2, 53, pikat 5 e 6, 63, pika 6, 66, 73, 87, pika 4, 92, pika 3, 95, pika 5, dhe 97, pikat 1, 2, 5, 7 e 9, të këtij ligji;

iii) moszbatimi i detyrimeve, lidhur me llogaritjen dhe aplikimin e kostove dhe tarifave, sikurse kërkohet në nenet 17, pika 1, shkronja “dh”, 33, pikat 1-7, 90, pikat 10 e 11, dhe 56, pika 4, të këtij ligji;

iv) moszbatimi i detyrimeve të shërbimit publik, të vendosura sipas kërkesave të neneve 92, pika 11, dhe 93, pikat 2 e 4, të këtij ligji;

v) moszbatimi i detyrimeve për mbajtjen e llogarive të ndara, sipas neneve 30, 75, 80, pika 6, dhe 85, pika 6, të këtij ligji;

vi) moszbatimi i detyrimeve që lidhen me aksesin e palëve të treta në rrjet, siç përcaktohet në nenet 42, pikat 1-3, 54, 64 dhe 71, të këtij ligji;

vii) moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në kontratat e rregulluara si dhe vendosja e kushteshesës në kontratën e furnizimit apo mosnjoftimi, në kundërshtim me nenet 76, pika 5, dhe 90, pika 4, të këtij ligji;

viii) mospublikimi i informacionit për tarifën dhe kushtet e përgjithshme të aksesit në rrjet, sidhe përdorimi i shërbimeve të rrjetit, sikurse përcaktohet në nenin 33, pika 8, të këtij ligji;

ix) mosparaqitja e programeve të investimeve dhe/ose moskryerja e investimeve të planifikuara, sipas kërkesave të neneve 46 dhe 56, të këtij ligji, si dhe rregullores përkatëse të ERE-s.

x) shkelja e kushteve dhe kërkesave të cilësisë së furnizimit, të miratuara nga ERE, parashikuar në nenin 89, pika 4, të këtij ligji;

xi) moszbatimi i vendimeve të ERE-s;

xii) mosrespektimi i kërkesave të neneve 39, pikat 4 e 6, dhe 60, shkronja “ç”, të këtij ligji;

xiii) mosmarrja e masave për hartimin e programit të përputhshmërisë dhe emërimin e zyrtarit të përputhshmërisë, sipas kërkesave të neneve 47, pika 1, 51, pika 5, dhe 80, pika 7, të këtij ligji;

xiv) mosrespektimi i përgjegjësisë të ngarkuara për operatorin e sistemit të depozitës dhe GNL- së, sipas parashikimeve të neneve 61 dhe 69, të këtij ligji;

xv) aplikimi i kushteve shtesë në kontratat që janë drejt përfundimit, në kundërshtim me nenin 76, pika 5, të këtij ligji;

xvi) mosnjoftimi i klientëve nga furnizuesi i mundësisë së fundit, sipas kërkesave të nenit 90, pika 4, të këtij ligji;

xvii) mosrespektimi i kërkesave të nenit 77, të këtij ligji, në lidhje me ruajtjen e të dhënave;

xviii) mosrespektimi i detyrimit për të lidhur kontratë, sipas nenit 96, pika 8, të këtij ligji, për klientët që plotësojnë kushtet, sipas pikës 1, të këtij neni;

b) dënohen nga inspektorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit me gjobë nga 0,1 për qind deri në 0,5 për qind të të ardhurave vjetore të vitit paraardhës të të licencuarit shkeljet e kryera nga subjektet e pajisura me miratim, sipas kushteve të nenit 11, të këtij ligji, si dhe në rastin e linjave direkte;

i) çdo shkelje e rregullave të sigurimit teknik, të vendosura nga Këshilli i Ministrave, sipas pikës 1, të nenit 10, të këtij ligji, dënohet nga Inspektorati Qendror Teknik me sanksionet e parashikuara në legjislacionin në fuqi;

ii) mosrespektimi i kërkesave të sigurisë teknike, sipas pikës 1, të nenit 10, të këtij ligji;

iii) mosrespektimi i kërkesave teknike të sigurisë dhe kryerja e veprimtarive, të parashikuara në këtë ligj, në kundërshtim me rregullat për mbrojtjen e mjedisit, sipas pikës 6, të nenit 10, të këtij ligji, gjohet sipas legjislacionit në

fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

iv) ndërtimi dhe përdorimi, në kundërshtim me nenin 11, të këtij ligji, dhe kriteret e caktuara për aplikim për pajisje me miratim;

v) tejkalimi i parashikimeve të kontratës së lidhur sipas kushteve të nenit 11, të këtij ligji, përbën shkelje administrative;

vi) mosrespektimi i nenit 11, pika 7, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga ministria përgjegjëse për energjinë;

vii) mosrespektimi i nenit 12, pikat 3 dhe 8, të këtij ligji;

c) inspektorati merr një vendim dhe e njofton atë brenda 60 ditëve nga njoftimi i procesverbalit të inspektimit;

ç) ERE dhe/ose inspektorati shtetëror përgjegjës aplikojnë gjobë progresive për çdo ditë shkeljendaj subjekteve të këtij ligji, për rastet e mëposhtme:

i) kur i licencuari nuk përmbush vendimin e ERE-s për korrigjimin e një shkeljeje, brenda afateve të përcaktuara prej saj. Në këtë rast, i licencuari dënohet me gjobë, në masën 0,1 për qind të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, për çdo ditë vonese nga dita e afatit të përcaktuar në vendimin përkatës të ERE-s;

ii) kur i licencuari nuk përmbush detyrimin e pagesës së taksës rregullatore ndaj ERE-s, dënohet me gjobë, në masën 0,2 për qind të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, për çdo ditë vonesë nga dita e përcaktuar për pagesën.

2. Bordi i Komisionerëve të ERE-s harton dhe miraton një rregullore të posaçme lidhur me kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje, e cila konsultohet, paraprakisht, me të licencuarit në sektorin e gazit.

3. Ministri, me propozimin e inspektoratit shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit, miraton një rregullore të posaçme lidhur me kushtet dhe procedurat për vendosjen gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje, e cila konsultohet, paraprakisht, me të licencuarit në sektorin e gazit.

4. Procedurat e vendosjes dhe ekzekutimit të gjobave bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative".

5. Ankimi ndaj vendimit të ERE-s apo vendimit të inspektoratit shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit, për heqjen e licencës apo miratimit, për shkak të kryerjes së një kundërvajtjeje administrative, bëhet sipas ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative".

6. Vendimi i ERE-s apo inspektoratit shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit, për vendosjen e gjobës ndaj të licencuarve/të pajisurve me miratim, është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nëpërputhje me Kodin e Procedurës Civile.

7. Zbatimi i kundërvajtjeve administrative nuk e shmang subjektin përkatës nga detyrime të tjera, të përcaktuara në këtë ligj dhe në ligje të tjera, si dhe nga përgjegjësia civile për dëmin e shkaktuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 107

Detyrimet për konfidencialitet

1. ERE, ministria dhe autoritetet e tjera kompetente shtetërore kanë për detyrë t'i përdorin të dhënat tregtare, të marra nga shoqëritë e gazit natyror, vetëm për qëllimet e treguara në kërkesën e tyre për marrje informacioni, duke ruajtur konfidencialitetin rreth tij. Informacioni konfidencial tregtar mund të bëhet publik vetëm sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

2. Gjatë kryerjes së veprimtarive të tyre, në përputhje me këtë ligj, operatori i sistemit të transmetimit, operatori i sistemit të shpërndarjes, operatori i sistemit të depozitimit të gazit, operatori i terminalit të GNL-së, operatori i tregut të gazit, furnizuesi, tregtari dhe prodhuesi, si dhe ERE ruajnë konfidencialitetin rreth informacionit tregtar konfidencial të marrë prej tyre, si dhe parandalojnë informimin rreth veprimtarive të tyre, i cili mund të krijojë avantazhe tregtare në mënyrë të padrejtë. Një informacion i tillë mund të përhapet vetëm sipas kushteve të përcaktuara nga ligjet apo në rastin kur palët, shprehimisht, kanë rënë dakord.

Neni 108

Udhëzimet e Bashkimit European dhe kodet e rrjetit

Ministria dhe ERE bashkëpunojnë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe autoritetet kompetente rregullatore të palëve të tjera të Komunitetit të Energjisë për transpozimin, në legjislacionin shqiptar, të akteve komunitare për sektorin e gazit natyror.

KREU IX

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 109

Dispozitat kalimtare në lidhje me ndarjen e OST-së

Kushtet për pavarësinë dhe ndarjen e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, siç kërkohet me këtë ligj, zbatohen deri më 1 qershor 2016.

Neni 110

Dispozitat kalimtare për certifikimin, në lidhje me vendet e treta

1. Neni 40, i këtij ligji, hyn në fuqi më 1 janar 2017.

2. OST-ja i jep ERE-s gjithë të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për zbatimin e duhur të kërkesave e detyrimeve, sipas nenit 40, të këtij ligji, brenda 3 muajvenga data e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 111

Dispozitat kalimtare në lidhje me ndarjen e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

1. OSSH-ja dhe, sipas rastit, shoqëria e integruar vertikalisht, subjektet private ose organet publike që lidhen me këtë ligj duhet të harmonizojnë organizimin e tyre të brendshëm, strukturën e shoqërisë, marrëveshjet kontraktuale dhe veprimtaritë e shoqërisë, sipas dispozitave të këtij ligji dhe rregullave që kanë të bëjnë me ndarjen e sistemit të operatorit të shpërndarjes, brenda 18 muajvenga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Pika 1, e këtij neni, nuk do të zbatohet në rast përjashtimi për ndarjen e operatorit të sistemit të shpërndarjes, sipas nenit 52 të këtij ligji.

Neni 112

Dispozitat kalimtare në lidhje me miratimin e listës së dokumenteve të klientit

1. Nëse është vendosur nga autoritetet kompetente, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, ERE garanton që furnizuesit e gazit natyror të marrin të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar që klientët e tyre të pajisen me një kopje të listës së dokumenteve, e cila duhet të bëhet publike brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Nëse lista e dokumenteve nuk është hartuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, furnizuesi është i detyruar të përmbushë detyrimet, sipas pikës 1, të këtij neni, brenda 2 muajve nga kërkesa e klientit, për miratimin e kësaj liste dokumentesh.

Neni 113

Trajtimi i licencave, lejeve autorizimeve, miratimeve dhe kërkesave ekzistuese për ndërtimin e gazsjellësve dhe të instalimeve të tjera të infrastrukturës së gazit

1. Lejet e koncesionit për ndërtimin dhe përdorimin e gazsjellësve dhe të instalimeve të tjera të infrastrukturës së gazit, të dhëna nga Këshilli i Ministrave, sipas dispozitave të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, janë të vlefshme deri në afatin për të cilin janë dhënë.

2. Personat e pajisur me leje koncesioni për ndërtimin dhe përdorimin e gazsjellësve dhe të instalimeve të tjera të infrastrukturës së gazit, sikurse përcaktohet në pikën 1, të këtij neni, pajisen nga ERE me licencën përkatëse për kryerjen e një ose më shumë veprimtarive në sektorin e gazit natyror, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Të gjitha shoqëritë e gazit natyror, të pajisura me licencë, leje, autorizim apo miratim për veprimtaritë në sektorin e gazit natyror, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë këto veprimtari në bazë të kushteve të vendosura nga licenca, leja ose autorizimi i dhënë. Kur një licencë ose leje e dhënë ka përfunduar, shoqëritë e gazit natyror duhet të procedojnë menjëherë me paraqitjen e kërkesës për t'u pajisur me licencë të re dhe, kur është nevoja, me leje, autorizim ose miratim, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj.

4. Procedurat e filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe rregullative, të cilat kanë qenë në fuqi në datën e fillimit të procedurave të tilla.

Licencat ekzistuese dhe trajtimi i licencave të dhëna nga ERE

1. Vendimi i përjashtimit për infrastrukturën e mëdha të gazit, i dhënë nga ERE, në bazë të nenit 40, të ligjit nr. 9446, datë 30.6.2008, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, konsiderohet i vlefshëm dhe i dhënë në përputhje me pikat 1-17, të nenit 78, të këtij ligji, dhe për aq sa vendimi i përjashtimit nga ERE nuk e ka humbur efektin juridik, sipas pikës 18, të nenit 78, të ligjit.
2. Parashikimet, sipas neneve 11, pika 3, 22, pika 5, dhe 44, nuk i shtrijnë efektet juridike të përjashtimeve të dhëna sipas nenit 40, të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.
3. Për aq sa shpenzimet për kryerjen e detyrimit të shërbimit publik, sipas pikave 14 e 15, të nenit 89, nuk mund të përfshihen në përlllogaritjen e tarifave për projektet e përjashtuara, sipas nenit 40, të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, atëherë këto detyrime të shërbimit publik nuk mund të aplikohen dhe ERE nuk mund të vendosë kushte të tilla për licencat e transmetimit, të dhëna për projekte të tilla të përjashtuara.
4. Licencat e dhëna nga ERE për veprimtaritë e gazit natyror, sipas ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, janë të zbatueshme, në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e dhëna në këto licenca.

Vlefshmëria e akteve nënligjore ekzistuese

1. Vendimi nr. 713, datë 25.8.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për kushtet e procedurave për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të gazit natyror”, miratuar në zbatim të nenit 8, të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, mbetet në fuqi për aq sa nuk bie ndesh me parashikimet e këtij ligji dhe do të referohet si në zbatim të nenit 11 të këtij ligji.
2. Vendimi nr. 1030, datë 27.11.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, pjesa e parë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”, miratuar në zbatim të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, mbetet në fuqi për aq sa nuk bie ndesh me parashikimet e këtij ligji dhe do të referohet si në zbatim të pikës 1, të nenit 10, të këtij ligji.
3. Vendimi nr. 104, datë 4.2.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave teknike të kriterëve të sigurisë, pjesa e dytë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”, miratuar në zbatim të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, mbetet në fuqi për aq sa nuk bie ndesh me parashikimet e këtij ligji dhe do të referohet si në zbatim të pikës 1, të nenit 10, të këtij ligji.
4. Vendimi nr. 551, datë 18.6.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure”, mbetet në fuqi për aq sa nuk bie ndesh me parashikimet e këtij ligji dhe do të referohet si në zbatim të nenit 5 të këtij ligji.
5. Urdhri nr. 666, datë 3.8.2009, i Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, “Për miratimin e rregullave teknike dhe kriterëve të sigurisë, të përkohshme, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”, në mbështetje të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, mbetet në fuqi për aq sa nuk bie ndesh me parashikimet e këtij ligji dhe do të referohet si në zbatim të pikës 2, të nenit 10, të këtij ligji.

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 5; 6, pika 1; 11, pika 2; 27, pika 5; 88, pika 1; 89 pika 2; 90, pika 1; 97, pika 1, dhe 100, pika 1, të tij.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë rregullat teknike, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 10, të tij.

3. Ngarkohet ministria përgjegjëse për energjinë që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10, pika 2; 23, pika 4; 58, pika 2; 101, pika 1 dhe 106, pika 3, të tij.

4. Ngarkohet ERE që, brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 14; 16, pikat 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, 2, 10, 13, 14, 16, 17, 18, 24 dhe 27; 18, pika 2; 20; 23, pika 1; 24, pika 1; 29, pika 2; 32, pika 1; 38, pika 2; 44, pika 1, e 2, shkronja “g”; 46, pika 12; 47, pika 3; 48, pika 8; 53, pikat 3, 7 e 8; 54, pika 1; 55, pika 2; 63, pika 2; 67, pika 3; 74, pika 3; 76, pika 2; 84, pika 5; 85, pika 1; 88, pika 3; 89, pika 11; 90, pikat 10 e 11; 92, pika 3; 93, pika 1; 94, pikat 3 e 4; 95, pika 2; 96, pika 9, 97, pika 11; 98, pikat 2 e 4; 104, pikat 1 e 12; dhe 106, pika 2, të tij.

Neni 117

Shfuqizime

Ligji nr. 9946, datë 30.6.2008, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 118

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE

Valentina LESKAJ

Miraturar në datën 23.9.2015